



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përmbledhës “Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në vitin 2022”.

**RAPORT PËRMBLEDHËS I AUDITIMIT
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT
2022”**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT

DHJETOR 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqja
I	Përmbledhje ekzekutive	3-4
1	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Konkluzioni i përgjithshëm	3-4
II	Hyrje	4-6
1	Objektivat e auditimit	4-5
2	Qëllimi i auditimit	5-5
3	Identifikimi i çështjeve	5-5
4	Kriteret e vlerësimit	5-6
5	Metodat dhe teknikat e auditimit	6-6
6	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	6-6
7	Përgjegjësitë e audituesve	6-6
8	Dokumentimi i auditimit	6-6
III	Përshkrimi i auditimit sipas subjekteve	6-132
1	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Auditim Financiar dhe Auditim Përputhshmërie (periudha 2018-2020)	7-28
2	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Auditim Financiar dhe Auditim Përputhshmërie (periudha 2021)	28-41
3	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie	41-53
4	Dega e Doganës Durrës, Auditim Përputhshmërie	54-66
5	Dega e Doganës Tiranë, Auditim Përputhshmërie	66-84
6	Shoqëria “Agrokredit” SHA, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie	84-100
7	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Auditim Përputhshmërie	100-110
8	Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politik, Auditim përputhshmërie	110-117
9	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, Auditim Përputhshmërie	117-123
IV	Rekomandime	124-131
V	Anekse	132-137

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 886/8 prot. datë 09.10.2023, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna në 9 (nëntë) auditime të ushtruara gjatë vitit 2022, në 8 subjekte. Në përfundim të auditimit, janë hartuar projektraportet e auditimit për secilin subjekt, bazuar në Letrat e punës, Akt konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjektet. Projekt raportet e auditimit janë dërguar në 8 (tetë) subjektet përkatëse si dhe janë marrë përgjigjet konfirmuese si më poshtë:

- Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, dërguar PRA me shkresë nr. 886/29, datë 10.11.2023, kthyer përgjigje nga subjekti me shkresë nr. 78102/1 prot., datë 22.11.2023, protokolluar në KLSH me nr.886/32, datë 30.11.2023;
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, dërguar PRA me shkresë nr. 886/30, datë 10.11.2023;
- Dega e Doganës Durrës, dërguar PRA me shkresë nr. 886/31, datë 10.11.2023, kthyer përgjigje nga subjekti me shkresë nr.16691/20, datë 07.12.2023, protokolluar në KLSH me nr.886/34, datë 12.12.2023;
- Dega e Doganës Tiranë, dërguar PRA me shkresë nr. 886/28, datë 10.11.2023;
- Shoqëria “A.” SHA, dërguar PRA me shkresë nr. 886/26, datë 10.11.2023;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, dërguar PRA me shkresë nr. 886/25, datë 10.11.2023;
- Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politik; dërguar PRA me shkresë nr. 886/24, datë 10.11.2023, kthyer përgjigje nga subjekti me shkresë nr. 716/1 prot., datë 24.11.2023, protokolluar në KLSH me nr.886/33, datë 01.12.2023;
- Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, dërguar PRA me shkresë nr. 886/27, datë 10.11.2023.

Bazuar në projektraportet e secilit subjekt të audituar dhe Projektraportin Përmbledhës është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

2. Konkluzion i përgjithshëm:

Në përfundim të auditimit të ushtruar në 8 subjekte, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik” dhe Manualin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, bazuar në Programin e Auditimit nr. 886/8 prot. datë 09.10.2023, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, KLSH ka arritur në konkluzionin se, nga ana e subjekteve të audituara përgjithësisht është treguar përgjegjshmëri menaxheriale në shqyrtimin, pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e kryera gjatë vitit 2022.

Nga 9 auditime të kryera është raportuar në KLSH, Plan veprimi nga 6 prej tyre, ose 67 %, si dhe është raportuar mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga 3 prej tyre, ose 33 %.

Nga auditimi ka rezultuar nivel i lartë i pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve në masën 93 %.

Për 8 subjektet e audituara janë lënë gjithsej për zbatim 202 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 187, ose 93 % e tyre, si dhe nuk janë pranuar 15 rekomandime, ose 7 % e tyre.

- Rekomandime “Përmirësim ligjor”, janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe zbatuar në masën 100 %;

- Rekomandimet “Masa organizative” janë lënë 131, janë pranuar 126 rekomandime, ose 96 % e tyre. Nga 126 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 84 rekomandime, ose 67 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 14 rekomandime, ose 11 % e tyre, janë në proces 21 rekomandime, ose 17 % e tyre, si dhe nuk janë zbatuar 7 rekomandime, ose 5 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi”, janë lënë 54, janë pranuar 44 rekomandime, ose 82 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 20 rekomandime, ose 46 % e tyre; janë në proces zbatimi 23 rekomandime, ose 52 % e tyre, si dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim, ose 2 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa për përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike (3-E)”, janë lënë 4, janë pranuar 4 rekomandime, ose 100 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, ose 75 % e tyre, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 25 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa administrative”, është lënë 1 rekomandim, i cili është zbatuar plotësisht, ose në masën 100 %.
- Rekomandimet “Masa disiplinore”, janë lënë 10 masa, të cilat janë pranuar në masën 100 %. Nga 10 masat e rekomanduara janë zbatuar plotësisht 6 masa, ose 60 % e tyre, janë në proces zbatimi 3 rekomandime, ose 30 % e tyre, si dhe 1 rekomandim rezulton i pa zbatuar, ose 10 % e tyre.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme” të subjekteve të cilësuara më poshtë, mbështetur në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 886/8 prot. datë 09.10.2023, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale”, nga data 07.10.2023 deri më datë 31.10.2023, u krye auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e kryer në vitin 2022” nga Grupi i auditimit më përbërje:

1. B. Z.
2. E. B.
3. Xh. N.

Subjektet e audituara:

1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Auditim Financiar dhe Auditim Përputhshmërie (periudha 2018-2020) dhe (periudha 2021);
2. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie;
3. Dega e Doganës Durrës, Auditim Përputhshmërie;
4. Dega e Doganës Tiranë, Auditim Përputhshmërie;
5. Shoqëria “Agrokredit” SHA, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie;
6. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Auditim Përputhshmërie;
7. Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politik;
8. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, Auditim Përputhshmërie.

Objektivat, fushëveprimi dhe metodologjia:

1. Objektivat e auditimit:

- Vlerësimi i shkallës së zbatimit të masave të rekomanduara nga subjekti.

- Evidentimi i rëndësisë që i është kushtuar nga subjekti peshës së masave të rekomanduara dhe impaktit që ato japin në përmirësimin e punës në të ardhmen.
- Evidentimi i rasteve kur nuk janë zbatuar masat e rekomanduara, analizimi i shkaqeve përmes evidencës së mbledhur dhe ballafaqimit me Drejtuesit e Institucioneve.
- Krahësimi i masave të raportuara me urdhrat përkatës dhe evidencën kontabile.
- Administrimi i të dhënave statistikore sipas pasqyrave bashkëlidhur akt verifikimit dhe analiza e tyre.
- Evidentimi i konkluzioneve për çdo subjekt dhe në tërësi për të krijuar një bazë reale mbi vendimin për të ri kërkuar nga subjektet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht ose që janë në proces.

2. Qëllimi i auditimit:

Dhënia e konkluzionit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të lëna nga auditimi i mëparshëm, në lidhje me respektimin e afateve të raportimit në KLSH mbi, Plan veprimin dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve; statusin e zbatimit të rekomandimeve; koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, duke ju referuar Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) të cilat përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësive të subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave: “..., *përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara dhe përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme*”.

3. Identifikimi i çështjeve:

Në zbatim të procedurave të përcaktuara në Manualin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrat elektronik institucional”, si dhe kërkesave që duhet të plotësojnë subjektet e audituara, në lidhje me rekomandimet e lëna nga KLSH, të cilësuar në raportet e auditimit, janë identifikuar si çështje për t’u audituar:

- Hartimi i programit (Planit të veprimit) dhe respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.
- Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.
- Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.
- Zbatimi i rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.
- Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

4. Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 dhe 30;
- Manuali “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional”, miratuar nga Kretari i KLSH më Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020.
- Planet e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuara nga titullarët e institucioneve objekt i këtij auditimi;

5. Metodat dhe teknikat e auditimit

Duke pasur në fokus përmbushjen e objektivave të auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, bazuar në:

- *Intervistimi me shkrim*, si një metodë e marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet;
- *Intervistimi verbal*, si një metodë e marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve direkte nga të intervistuarit;
- *Verifikimi i transaksioneve*, për shkak se dy metodat e mësipërme mbartin rrezikun e subjektivitetit, nga grupi i auditimit u kërkua dokumentacioni mbështetës, si dhe kryen teste analitike, nëse evidenca e vënë në dispozicion nga subjekti ishte e saktë, e plotë dhe e mjaftueshme për të dhënë konkluzionin e duhur.

6. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara, duke ju referuar Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) të cilat përcaktojnë qartë rolin dhe përgjegjësinë e subjekteve të audituara si dhe Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbajnë përgjegjësi, *për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe në mënyrë efektive, si dhe për informimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi masat e marra dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në afatet e përcaktuara në ligjin nr. 154/2014.*

7. Përgjegjësitë e audituesve

KLSH, duke ju referuar Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) roli dhe përgjegjësia e KLSH-së, kanë përgjegjësi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme. KLSH ka përgjegjësi për konsolidimin e një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, të informojë Kuvendin, por jo vetëm, si dhe të sigurojë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara.

8. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrat elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020 dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit (planifikim, auditim në terren dhe raportim). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.886/8, datë 09.10.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”, Grupi i auditimit ka ushtuar auditim, sipas njoftimeve për fillim auditimi dhe programeve përkatëse në subjektet e mëposhtme:

1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Auditim Financiar dhe Auditim Përputhshmërie (periudha 2018-2020), sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023;
2. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, Auditim Financiar dhe Auditim Përputhshmërie (periudha 2021) sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023;
3. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/3, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/16, datë 09.10.2023;
4. Dega e Doganës Durrës, Auditim Përputhshmërie, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/6, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/11, datë 09.10.2023;
5. Dega e Doganës Tiranë, Auditim Përputhshmërie sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/4, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/14, datë 09.10.2023;
6. Agrokredit SHA, Auditim Financiar dhe Përputhshmërie sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/7, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/13, datë 09.10.2023;
7. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Auditim Përputhshmërie sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/5, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/12, datë 09.10.2023;
8. Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politik, Auditim Përputhshmërie, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/2, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/9, datë 09.10.2023;
9. Instituti i Studimeve për Krimet dhe pasojat e komunizmit, Auditim Përputhshmërie, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 886/1, datë 09.10.2023 dhe Programit të Auditimit nr. 886/10, datë 09.10.2023.

Rezultatet e auditimit sipas subjekteve të audituara.

1. DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANË

1.1. Konkluzioni i auditimit:

Në përfundim të auditimit të ushtuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre.

a. Periudha e audituar 01.01.2018-31.12.2020

Nga DRT Tiranë, nuk janë përcjellë në KLSH dy raportimet, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15 dhe neni 30. Nga 46 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 42 rekomandime, ose 91 % e tyre. Nga 42 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, ose 62 % e tyre; janë

zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, ose 5 % e tyre; janë në proces zbatimi 14 rekomandime, ose 33 % e tyre.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 17 rekomandime, janë pranuar 16 rekomandime, ose 94 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 11 rekomandime, ose 69 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, ose 13 % e tyre si dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime, ose 8 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi ekonomik”, janë lënë 28 rekomandime, janë pranuar 25 rekomandime, ose 89 % e tyre, janë zbatuar plotësisht 14 rekomandime, ose 56 % e tyre, si dhe janë në proces zbatimi 11 rekomandime, ose 44 % e tyre;
- Rekomandimi “Masa disiplinore”, është lënë për 8 punonjës të DRT Tiranë dhe është zbatuar plotësisht.

b. Periudha e audituar 01.01.2021-31.12.2021

Nga DRT Tiranë, nuk është përcjellë në KLSH raportimi, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30. Nga 22 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 20 rekomandime, ose 91 % e tyre. Nga 20 rekomandimet e pranura, janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, ose 65 % e tyre; është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 5 % e tyre dhe janë në proces zbatimi 6 rekomandime, ose 30 % e tyre.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 17 rekomandime, janë pranuar 16 rekomandime, ose 94 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 12 rekomandime, ose 75 % e tyre; është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 6 % e tyre, si dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime, ose 19 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi ekonomik”, janë lënë 4 rekomandime dhe janë pranuar 3 rekomandime, ose 75 % e tyre, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- Rekomandimi “Masa disiplinore”, është lënë për 16 punonjës të DRT Tiranë dhe është zbatuar plotësisht.

1.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886 datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/15 prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajtën Akt konstatimi nr. 5, protokolluar në subjekt me nr. 67972/5, datë 31.10.2023, si dhe Akt konstatimi nr. 6, protokolluar në subjekt me nr. 67972/6, datë 31.10.2023, mbi bazën e të cilëve u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/29 prot., datë 10.11.2023 dhe konfirmuar nga subjekti me shkresën nr. 78102/1 prot., datë 22.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 886/32, datë 30.11.2023.

Auditimi u krye nga:

- E. B.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 31.10.2023.

1.3. Përshkrimi i auditimit

1.3.a. Zbatimi i rekomandimeve për periudhën e audituar 01.01.2018-31.12.2020

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 1247/130 prot., datë 20.02.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2018-31.12.2020, protokolluar në subjekt me nr. 6802 prot., datë 22.02.2023, janë rekomanduar për zbatim 17 rekomandime “Masa organizative”, 28 rekomandime “Shpërblim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe “Masa disiplinore” për 8 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar **nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditë** nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”.
- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*, **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë z. R. P..

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 17 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të hartojnë një akt juridik normativ të qartë dhe të saktë për procedurën që ndiqet në analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, duke harmonizuar legjislacionin e shoqërive tregtare, tatimore dhe përcaktimet e Kodit Civil.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime dhe kishin dhënë sugjerime për miratimin e Udhëzimit nr. 26,

datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i cili përcakton kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 2, datë 07.06.2023. Në pikën 13, germa (f), 19 dhe 46 të këtij udhëzimi janë përcaktuar procedura që ndiqet në rastet e shoqërive me ortakëri.

Statusi: Zbatuar plotësisht (vërtetuar nga email-et e dërguara në DRT Tiranë nga Drejtoria Teknike e Ligjore e DPT).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një akti juridik normativ të qartë, të procedurës së llogaritjes së detyrimeve tatimore për kontrollat nga zyra, në rastet kur tatimpaguesi nuk bashkëpunon për kryerjen e kontrolleve të autorizuar në vend.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime për përmirësimin e bazës ligjore në lidhje me vlerësimet nga zyra, kur tatimpaguesi nuk bashkëpunon me Administratën Tatimore. Në kuadër të këtyre takimeve është miratuar Udhëzimi nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të propozojë për kontroll tatimor specifik me objekt “Transferimin e Çmimit”, në subjektet “I.A.” SHPK dhe “S. S.” SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/5 prot., datë 27.06.2023, DRT Tiranë kishte marrë masa duke dërguar për kompetencë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, propozimin për kontroll tatimor në subjektet “I. A.” SHPK.

Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i ishte drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për subjektin “S. S.” SHPK, për të cilin i kishte kërkuar kontroll specifik, pasi sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 16.03.2019, ky subjekt ka kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojë dhe miratojë një akt juridik normativ ku të përcaktojnë qartë dhe të saktë llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontrolleve tatimore, kur konstatohen klasifikime të gabuara kontabël edhe aplikim të normës së amortizimit nga ana e shoqërive në lidhje me aktivin “HEC” duke harmonizuar legjislacionin fiskal me standardet kontabël në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime për përmirësimin e procedurave tatimore. Në kuadër të këtyre takimeve është miratuar Udhëzimi nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

5.1. Rekomandimi: Drejtuesit e njësive përgjegjëse dhe nëpunësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë gjatë procedurave administrative të nxjerrjes dhe evadimit të akteve administrative të respektojnë afatet ligjore të nxjerrjes së akteve me qëllim eliminimin e riskut në mos vlefshmërinë ligjore të akteve administrativë të nxjerra nga kjo njësi përgjegjëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Kontrollit të Biznesit të Madh në DRT Tiranë me shkresën nr. 7308 prot., datë 12.04.2022, kishte dërguar “Njoftim kontrolli tatimor”, në subjektin “T.B.P.” SHPK. Me shkresën nr. 7308/2 prot., datë 17.06.2022, i kishte dërguar subjektit, Raportin e Kontrollit Tatimor duke respektuar afatet ligjore të nxjerrjes së akteve.

Drejtoria e Kontrollit të Biznesit të Madh në DRT Tiranë me shkresën nr. 26139/1 prot., datë 22.02.2023, kishte dërguar “Autorizimin për fillimin e kontrollit” në subjektin “E.S.”. Me shkresën nr. 26139/3 prot., datë 05.04.2023, i kishte dërguar subjektit, Raportin e Kontrollit Tatimor duke respektuar afatet ligjore të nxjerrjes së akteve.

Komisioni Disiplinor në DPT, kishte dërguar shkresat e fillimit të ecurisë, për inspektorët të cilët kishin rezultuar me shkelje të afateve të kontrollit.

Shkresa nr. 16895/7 prot., datë 22.11.2022 për G. Z.;
Shkresa nr. 16895/8 prot., datë 22.11.2022 për A. S.;
Shkresa nr. 16895/9 prot., datë 22.11.2022 për M. M.;
Shkresa nr. 16895/10 prot., datë 22.11.2022 për Gj. C.;
Shkresa nr. 16895/11 prot., datë 22.11.2022 për A. B.;
Shkresa nr. 16895/12 prot., datë 22.11.2022 për A. L.;
Shkresa nr. 16895/13 prot., datë 22.11.2022 për A. N.;
Shkresa nr. 16895/14 prot., datë 22.11.2022 për E. P.;
Shkresa nr. 16895/15 prot., datë 22.11.2022 për F. P.;
Shkresa nr. 16895/16 prot., datë 22.11.2022 për D. M.;
Shkresa nr. 16895/17 prot., datë 22.11.2022 për E. J.;
Shkresa nr. 16895/18 prot., datë 22.11.2022 për E. K.;
Shkresa nr. 16895/19 prot., datë 22.11.2022 për A. B.;
Shkresa nr. 16895/20 prot., datë 22.11.2022 për S. M..

Statusi: Zbatuar plotësisht.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë të marrë masa për respektimin e dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me rregullshmërinë e regjistrimit të veprimeve financiare, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masa për një planifikim sa më të drejtë të fondeve buxhetore të llogarisë në zërin “Shpenzime udhëtimi” me qëllim kryerjen në kohë të likuidimit të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë nuk kishin lidhur më marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet saj dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit, për punësimin e praktikantëve në vitet në vazhdim. Nga verifikimi i Deklaratës “Listë pagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, muaji Nëntor 2021, llogaritjet ishin kryer sipas parashikimeve ligjore.

Me shkresën nr. 4370 prot., datë 25.02.2021, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në DRT Tiranë i kishte kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, miratimin e Regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2021, ku në zërin “Shpenzim udhëtim i brendshëm e dieta” ishte bërë një planifikim më i madh i fondeve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit si dhe të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi të vepohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi duke bërë investigim të tregut, argumentim dhe dokumentim të përlllogaritjes së vlerës së kontratës me qëllim përdorimin me eficiencë, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ishin kryer inventarizimet dhe arkivimet e dosjeve të procedurave të prokurimit për vitin 2022. Praktika “Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime”, procedurë prokurimi me vlerë të vogël, ishte inventarizuar dhe protokolluar me fletën përmbledhëse nr. 35497/5 prot.

Në dosjen për procedurën blerje me vlerë të vogël “Siguracioni i automjeteve në zotërim të DRT Tiranë” u konstatua: urdhër-shpenzimi nr. 73, datë 21.03.2023; Memo, kërkesë për pagesën e siguracioneve të mjeteve të institucionit; urdhër-prokurimi nr. 10, datë 27.02.2023; ftesë për ofertë; oferta nga 3 operatorë me kartelat shoqëruese të praktikave, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, i firmosur nga komisioni i procedurës; faturë tatimore shitjeje e shoqëruar me formular vetë deklarimi të operatorit, kopje të licencës së operatorit, vërtetim të llogarive bankare; marrëveshja e shërbimit; vërtetim shlyerje detyrimesh nga OSHEE; vetë deklarim për konflikt interesi nga komisioni i prokurimit; polisë sigurimi.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit çdo vit dhe në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me Urdhrin nr. 29, protokolluar me nr. 25880, datë 19.09.2022, të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i inventarizimit të vlerave materiale të DRT Tiranë për vitin 2022, me përbërjen e 5 punonjësve. Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni kishte mbajtur proces-verbalin me nr. 25880/1 prot., datë 03.11.2022, mbi gjendjen e konstatuar.

Me Urdhrin nr. 25880/3 prot., datë 07.11.2022, të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DRT Tiranë, me përbërjen e 5 punonjësve. Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni kishte mbajtur relacionin me nr. 25880/4, datë 07.12.2022 mbi gjendjen e konstatuar.

Me Urdhrin nr. 41, protokolluar me nr. 36245, datë 12.12.2022 të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i asgjësimit të aktiveve në DRT Tiranë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë mbi mangësitë e evidentuara në kontrollin për rimbursimin e TVSH, si dhe të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për të bërë ndryshimet e nevojshme në “Rregulloren e rimbursimit të TVSH-së, mbështetur në analizën e riskut”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime për përmirësimin e Manualit të Riskut. Me Vendimin nr. 1, datë 27.02.2023, protokolluar me nr. 3019, Komiteti i Riskut në DPT kishte miratuar ndryshime në Manualin e Riskut.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.1. Rekomandimi: DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit BM, të kryerje një analizë të detajuar dhe të thelluar nga zyra të situatës së tatimpaguesve BM të cilët rezultojnë me humbje mbi 1,000,000 lekë për 3 vite të njëpasnjëshëm, dhe/ose të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend/vizitave fiskale për rastet e vlerësuara me

risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, për të vijuar në gjykatë për fillimin e procedurave të likuidimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë kishte marrë masa ku nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Biznes i Madh, kishin dërguar në DPT propozimet për kontroll të plotë në vend ose nga zyra, konkretisht:

Me shkresën nr. 33720 prot., datë 30.06.2023, për tatimpaguesin “T.T.”;

Me shkresën nr. 33723 prot., datë 30.06.2023, për tatimpaguesin “E.E.”;

Me shkresën nr. 33722 prot., datë 30.06.2023, për tatimpaguesin “C.E.L.P.”;

Me shkresën nr. 33145 prot., datë 27.06.2023, për tatimpaguesin “A.-AI”;

Me shkresën nr. 36916 prot., datë 11.07.2023, për tatimpaguesin “IN.”;

Me shkresën nr. 36915 prot., datë 11.07.2023, për tatimpaguesin “H.L.”;

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.1. Rekomandimi: DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit BV, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra të situatës së tatimpaguesve Biznes i Vogël të cilët rezultojnë me humbje mbi 500,000 lekë, për 3 vite të njëpasnjëshëm, ose të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend/vizitave fiskale, për rastet e vlerësuara me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, duke kryer propozimet përkatëse në gjykatë për fillimin e procedurave të likuidimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Qëndrimi i subjektit në lidhje me mospranimin e rekomandimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin” Neni 14, pika 1, për të zbatuar procedurat e falimentit, ju bëjmë me dije se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 110/2016 datë 27.10.2016, i shpallur me dekreten 9852, datë 17.11.2016, Ligji me nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin” është shfuqizuar.

Në nenin 16, të Ligjit nr. 110/2016 datë 27.10.2016 “Për Falimentimin”, nuk përcakton që Drejtoria e Tatimeve të bëjë shpalljen e falimentit, por ky nen përcakton kërkesën e kreditorit drejtuar Gjykatës për të pranuar falimentin. Nga ana juaj referuar kësaj pike nuk është përcaktuar në asnjë rast që tatimpaguesit kanë detyrime të papaguara ndaj DRT Tiranë e cila mund të kërkojë sipas përcaktimeve në Ligjin e mësipërm për nisjen e procedurave për falimentimin.

Sqarojmë se kontrolli në të gjithë tatimpaguesit nga ana e DRT-Tirane ushtrohet në bazë të planeve të kontrolleve të miratuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT.

Statusi: Pa pranuar

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin e problematikave të nxjerra gjatë auditimit, me qëllim vlerësimin e treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës.

Nga auditimi ka rezultuar: Drejtori i DRT Tiranë kishte marrë masa në vlerësimin e problematikave. Me urdhrin e brendshëm nr.1130 prot., datë 13.01.2023, kishte urdhëruar ndarjen e detyrave funksionale dhe intervalit të NIPT-eve, për inspektorët. Në lidhje me tatimpaguesit të cilët kishin paraqitur tepricë të lartë kreditorë të TVSH, ishin dërguar letër kujtesa dhe ishin kërkuar informacione për arsyet e tepricave.

Statusi: Në proces zbatimi

12.2 Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë planet e punës vjetore dhe mujore, për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për biznesin e madh dhe të vogël, me detyra dhe afate të mirë përcaktuara sipas funksioneve përkatëse, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të

jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar: Me shkresën nr. 63911 prot., datë 29.09.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, kishte hartuar Planin e punës me detyra dhe afate të përcaktuara, për muajin Tetor 2023.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

13.1 Rekomandimi: DRT Tiranë, të marrë masa për tatimpaguesin “H.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, me qëllim të kryejë ri kontrollin tatimor.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë kishte kryer kontrollin në tatimpaguesin “H.” SHPK me Njoftim Kontrollin Tatimor nr. 53540 prot., datë 19.06.2018, ku detyrimet paraprake kishin qenë në shumën 636,335,798 lekë, si dhe në raportin përfundimtar në shumën 5,039,497 lekë.

Me shkresën nr. 17198/6 prot., datë 18.09.2019, “Dërgim Raport Kontrolli”, DRT Tiranë kishte përcjellë raportin në të cilin ishin konstatuar detyrimet e tatimpaguesit në shumën 636,075,672 lekë, të cilat ishin ngarkuar në sistemin tatimor me çështjen nr. C0001034986.

Statusi: Zbatuar plotësisht

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, të marrë masat e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve, me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi me qëllim vjeljen e detyrimeve debitorë dhe uljen e riskut të mos arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, kishte marrë masat shtrënguese për vjeljen e detyrimeve debitorë.

1. Me shkresën nr. 76 prot., datë 13.01.2022, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar”, i kishte dërguar tatimpaguesit “77 E.” detyrimet tatimore të papaguara sipas sistemit informatik në vlerën 1,026,786 lekë. Me Urdhrin nr. 1819 prot., datë 31.01.2022, DMDP kishte kryer bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesit. Me shkresën nr. 2488 prot., datë 09.02.2022, DMDP kishte njoftuar tatimpaguesin për Vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Siguruese. Me shkresën nr. 2505/73 prot., datë 09.02.2022, Vendosja e Barrës Hipotekore, Shkresa nr. 3930 prot., datë 17.02.2022, “Kërkesë për Vendosjen e Masës së Sigurimit të detyrimit tatimor” drejtuar QKB, për mos lejim tjetërsimi prone nga tatimpaguesi.

2. Me shkresën nr. 19852 prot., datë 11.05.2022, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar”, i kishte dërguar tatimpaguesit “M.R.” SHPK, detyrimet tatimore të papaguara sipas sistemit informatik në vlerën 129,418,272 lekë. Me Urdhrin nr. 23975 prot., datë 30.05.2023, DMDP kishte kryer bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesit. Me shkresën nr. 35753 prot., datë 06.07.2023, DMDP kishte njoftuar tatimpaguesin për Vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Siguruese. Me shkresën nr. 786 prot., datë 10.01.2023, Vendosja e Barrës Siguruese, Shkresa nr. 26297 prot., datë 08.06.2023, “Kërkesë për Vendosjen e Masës së Sigurimit të detyrimit tatimor” drejtuar QKB, për mos lejim tjetërsimi prone nga tatimpaguesi.

Statusi: Zbatuar plotësisht

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve të analizojë plotësimin e kushteve dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit, si dhe të monitorojë nivelin e detyrimeve dhe pagesat e kryera për çdo këst me qëllim përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 31508/1 prot., datë 04.11.2022, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë kishte lidhur “Marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore” me tatimpaguesin “O.” SHPK. Përpara lidhjes së kësaj marrëveshje, tatimpaguesi kishte paguar për llogari të administratës tatimore 20% të detyrimit. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, kishte marrë masa në monitorimin e detyrimeve dhe pagesave të kryera nga tatimpaguesit.

Statusi: Në proces zbatimi

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, të marrë masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen dhe rritjen e shkallës së saktësisë së evidencave të mbajtura dhe raportimeve të kryera.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara kishte marrë masa në vlerësimin e problematikave të konstatuara me qëllim shmangien e tyre. Me shkresën nr. 20488 prot., datë 15.05.2023, kishte përcjellë në DPT, formularët për evidentimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore, për periudhën Janar-Prill 2023.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Mbi zbatimin e rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 28 masa shpërblim dëmi (të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit), për shumën 59,569,725 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të marrë masa të menjëhershme dhe të ndjekë çdo rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi në vlerën 1,352,271 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara kishte marrë masat për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit për subjektet të cilat nuk kishin kryer pagesën e këtij tatimi. Me shkresën nr. 70495 prot., datë 23.10.2023, kishte përcjellë në DPT, formularët për evidentimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore, për periudhën Maj-Shtator 2023.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “A.B.” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit tatimor, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 21,678 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/10 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “A.B.”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1 Rekomandimi: Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “F.” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të

ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 15,124 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/9 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, kishte mbajtur Akt konstatim, ku kishte shprehur mospranimin e rekomandimit, si më poshtë:

“Per tatimpaguesin F. SHPK, informojme se nga verifikimet e bere ne sistemin tatimor rezulton se ky tp per periudhen e kontrolluar sipas njoftim kontrollit me nr 62250 prot dt 09.08.2018 , ka qene ne rolin e investitorit. Ndertimet jane kryer nga shoqeria A. shpk , per te cilen i eshte derguar shkrese DPT-se , Drejtorise se Kontrollit tatimor , Drejtorise se Menaxhimit te Riskut per tu planifikuar per kontroll te plote, shkresa me nr. 6802/6 prot, date 27.06.2023. Pretendimet e ngritur ne lidhje me mosrespektimin e kostos se ndertimit nga ana e shoqerise ndertuese sipas udhezimit nr. 3 te keshillit te ministrave te dates 03.02.2010 per ti vleresuar si te ardhura tek subjekti investor F. shpk nuk qendron pasi nga ana e kesaj shoqerie, ne rast se do te ishin kryer investimet e pretenduara, do ti kishte lindur e drejta e kreditimit te tvsh-se, si dhe marrjes se shpenzimeve ne formen e amortizimit, duke ulur fitimin (jo duke e rritur) te vitit ushtrimor. Gjithashtu do ti kishte lindur e drejta edhe per rimbursimin e tvsh-se per investimin e munguar te pretenduar nga KLSH-ja. Me perfundimin e kontrollit ne shoqerine ndertuese (A. shpk) ne rast se do te konstatohen parregullsi do te nderhyhet nga ana jone ne lidhje me sa pretendohet, per kete arsye gjykojme qe nuk ka vend per rikontroll tatimor, pasi i gjithe ndertimi eshte bere nga shoqeria e cila i eshte propozuar DPT-se per kontroll tatimor”.

Statusi: Pa pranuar

3.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të informojë në lidhje me parregullësitë e konstatuara për subjektin “A.” SHPK, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila të ndërmarrë të gjitha veprimet administrative, me qëllim propozimin për kontroll tatimor të thelluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, nën juridiksionin e të cilit ndodhet subjekti “A.” SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/6 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “A.” SHPK.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1 Rekomandimi: Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “S.K. 2008” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 69,081 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/11 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “S.K. 2008” SHPK.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogarituara për subjektet “G.L.A.” SHPK, “H.” SHPK, “J.5” SHPK, “L. & E.” SHPK, P. C., “T. D. G.” SHPK, që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve tatimore në shumën 350 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/12 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “G.L.A.” SHPK.

Me shkresën nr. 6802/13 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “J.5” SHPK.

Me shkresën nr. 39129/6 prot., datë 20.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “L. & E.” SHPK.

Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i ishte drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për subjektin “T. D. G.” SHPK, për të cilin kishte kërkuar ri kontroll tatimor, pasi sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 26.10.2022, ky subjekt kishte kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “H.L.G.” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 1,393 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/9 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, kishte mbajtur Akt konstatim, ku kishte shprehur mospranimin e rekomandimit, si më poshtë:

Tatimpaguesin H.L.G shpk, per te cilin jane konstatuar mangesi per vendosje penaliteti ne masen 100% te detyrimit dhe vleresim tatimor, nga verifikimi i kryer i dokumentacionit ne baze te rekomandimeve te lena nga klsh-ja, rezulton se per kete tp jane kryer vleresime tatimore per mallrat e shitur nen kosto per te cilin eshte marre edhe vendimi I drejtorit rajonal me nr. 81645/7 prot dt 26.02.2019, ku ne baze te ketij vendimi jane llogaritur detyrime tatimore dhe vendosur penalitete sipas percaktimeve ne nenin 128.1 te ligjit te procedurave tatimore, nen I cili ka te beje me leshimin e fatures tatimore, ku kjo fature ka pasaktesi, pretendimi I ngritur nga klsh-ja ne lidhje me zbatimin e nenit 124 te ligjit te procedurave nuk qendron, pasi ky nen ka te beje me mosleshimin e fatures tatimore. Ne rastin konkret tp ka leshuar faturen tatimore por ka rezultuar se cmimi I aplikuar ne fature eshte nen kosto, per te cilen jane kryer rivleresimet perkatese. Nga ana e inspektorit eshte kryer verifikimi ne lidhje me transfertat e parave te cilat kanë kaluar si hua ndaj ortakut ndaj shoqërisë nëpërmjet bankave në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor, ku ne vitin 2017 kemi rritje te llogarise ortak, kurse ne vitin 2018 kemi ulje te llogarise ortak, te trajtuar ne raportin e kontrollit. Persa I perket pretendimeve te mallrave te shitur mbi kosto por me norme fitimi te ulet por me mosvleresimin e tyre me normen sipas bilancit nuk qendron, pasi shitjet e kryera jane bere me fature te rregullt tatimore, likujduar me banke, me norme fitimi ku legjislacioni tatimor nuk parashikon vleresime tatimore per mallrat e shitura me fitim (mbi kosto) por parashikon vleresime tatimore per mallrat e shitura nen kosto. Per kete arsye gjykojme qe nuk ka vend per rikontroll tatimor.

Statusi: Pa pranuar

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “A.-2014” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të

ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 10,124 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i ishte drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për subjektin “A.-2014” SHPK, për të cilin kishte kërkuar ri kontroll tatimor, pasi sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 14.03.2019, ky subjekt kishte kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “T.N.” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të propozojë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 1,003 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i ishte drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për subjektin “T.N.” SHPK, për të cilin kishte kërkuar ri kontroll tatimor, pasi sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 03.03.2020, ky subjekt kishte kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të kryejë të gjitha veprimet administrative, me qëllim arkëtimin e TVSH-së, së rimbursuar padrejtësisht për shpenzime si blerje ujë i pijshëm, birrë, restorant, ushqime, akomodimi në hotel, kafe, rroba dhe rroba për fëmijë, në shumën 357 mijë lekë dhe penalitetin e llogaritura për TVSH-në, në shumën 71 mijë lekë, pra gjithsej 428 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i ishte drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për subjektin “Ç.L.A.” SHPK, për të cilin kishte kërkuar arkëtimin e TVSH-së, së rimbursuar padrejtësisht për shpenzime blerjeje, si dhe penalitetin e llogaritur për TVSH-në. Sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 04.03.2020, ky subjekt kishte kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “B.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, të kryejë ri kontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 7,345 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/15 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “B.” SHPK.

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “A.E.” SHPK, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, të kryejë ri kontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 144 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: Me shkresën nr. 6802/7 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “A.E.” SHPK, për të cilin kishte kërkuar ri kontroll tatimor, pasi sipas dokumentit “Historiku i Tatimpaguesit”, nga data 03.11.2022, ky subjekt kishte kaluar në juridiksionin e DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesin “E.M.”, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, të kryejë rikontroll tatimor, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 1,229 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Me shkresën nr. 23226 prot., datë 19.08.2022, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, kishte njoftuar subjektin “E.M.” PF, për ri kontroll tatimor. Me shkresën nr. 23226/1 prot, datë 27.09.2022, Drejtori i DRT Tiranë, kishte miratuar Autorizimin për fillimin e ri kontrollit, të cilit i kishte bashkëngjitur Programin e ri kontrollit dhe kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
- Me shkresën nr. 23226/4 prot., datë 13.12.2022, DRT Tiranë i kishte përcjellë subjektit “E.M.” PF, Raportin Përfundimtar të ri kontrollit dhe Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore të papaguara.

Statusi: Zbatuar plotësisht

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesit “A.2001” SHPK, “T.” SHPK, “D.K.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 19,535 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Me shkresën nr. 6802/18 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “D.K.” SHPK.
- Me shkresën nr. 6802/16 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “A.2001” SHPK.
- Me shkresën nr. 6802/17 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “T.” SHPK.

Statusi: Zbatuar plotësisht

13.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për tatimpaguesit “A.A.” SHPK dhe “E.E.2000” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi në llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, të kërkojë informacion mbi metodologjinë e përdorur dhe normat e shfrytëzimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 6802/19 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “A.A.” SHPK, ku i kishin bashkëngjitur gjetjen dhe rekomandimin e auditimit të grupit të KLSH.

Me shkresën nr. 6802/20 prot., datë 03.07.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, i kishte propozuar DPT ri kontroll tatimor për tatimpaguesin “E.E.2000” SHPK, ku i kishin bashkëngjitur gjetjen dhe rekomandimin e auditimit të grupit të KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

14.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në shumën 6,716,809 mijë lekë, në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

1. DRT Tiranë, kishte marrë masa dhe kishte vlerësuar diferencat e pajustificuara, në të ardhurat tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së.

a. Me shkresën nr. 71870 prot., datë 26.10.2023 Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte përcjellë Akt verifikimin për “Tatimpaguesit nga Lista “BV 2019” me diferenca midis qarkullimi i korrektuar i kasës me të ardhurat nga deklarata e TTHF, vitin 2019”, subjekti “F.B.P S. 5”, për të cilin kishte arritur në, citojmë konkluzionin: *“Tatimpaguesi nuk ka ndryshuar deklaratë, por kanë argumentuar diferencat e konstatuara”*.

2. Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte marrë masat dhe për çdo tatimpagues kishte vendosur penalitet, në zbatim të nenit 126, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Me shkresën nr. 27116/6 prot., datë 24.03.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “G&M H.”.

- Me shkresën nr. 27116/8 prot., datë 24.03.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “V. N.”.

- Me shkresën nr. 27116/7 prot., datë 24.03.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “A. G.”.

b. Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte marrë masat dhe për çdo tatimpagues kishte vendosur penalitet, në zbatim të nenit 118, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Me shkresën nr. 70949/1-18 prot., datë 25.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “V.P.”.

- Me shkresën nr. 70540 prot., datë 23.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “G. M.” PF, për diferenca deklarim në shitje.

- Me shkresën nr. 70540 prot., datë 23.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “G. M.” PF, për diferenca deklarim në shitje.

- Me shkresën nr. 70538 prot., datë 23.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “Zh. H.” PF, për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale për periudhën 2018.

- Me shkresën nr. 70750 prot., datë 26.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “M. H.” PF, për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale për periudhën 2019.

c. Me shkresën nr. 70782 prot., datë 24.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, kishte njoftuar tatimpaguesin “A.-AL”, si dhe kishte mbajtur Akt

Verifikimet më datë 18.10.2023 për tatimpaguesit “T.” dhe “N. K.” për mospërputhje të dhënash, si dhe sistemim të deklaratave të TF-së për periudhën 2020.

Statusi: Në proces zbatimi

14.2 Rekomandimi: Të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë kryente propozimet dhe ndjekjen e diferencave të konstatuara, si dhe vlerësonin dhe rivlerësonin kryerjen e kontrolleve.

- Me shkresën 70772 prot., datë 24.10.2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, i kishte përcjellë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e madh, si dhe tatimpaguesit “S. Xh.” praktikën e Akt vlerësimit mbi detyrimet tatimore të subjektit.
- Me shkresën nr. 70777 prot., datë 24.10.2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, i kishte përcjellë Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse, Akt vlerësimit e mbajtur më datë 18.10.2023 për tatimpaguesin Qendra “P.”, në lidhje me konkluzionet mbi verifikimet e diferencave midis shitjeve të deklaruara sipas deklaratave të TVSH-së dhe të shitjeve nga kasa për periudhën 2020.
- Me shkresën nr. 70929 prot., datë 25.10.2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, i kishte përcjellë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e madh, Akt vlerësimit dhe Njoftim vlerësimit tatimor për detyrimet e tatimpaguesit “E.H.” PF, në lidhje me detyrimet tatimore të papaguara.
- Me shkresën nr. 70927 prot., datë 25.10.2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, i kishte përcjellë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e vogël, Akt vlerësimit dhe Njoftim vlerësimit tatimor për detyrimet e tatimpaguesit “F.”, në lidhje me detyrimet tatimore të papaguara.
- Me shkresën nr. 70925 prot., datë 25.10.2023 Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, i kishte përcjellë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e madh, Akt rivlerësimit dhe Njoftim vlerësimit tatimor për detyrimet e tatimpaguesit “B. M.” PF, në lidhje me diferenca në deklarim në të ardhura të realizuara.

Statusi: Në proces zbatimi

15.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në shumën 28,830,343 mijë lekë, në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, kishte përcjellë me shkresën nr. 70778 prot., datë 24.10.2023, Akt Verifikimit e datës 18.10.2023, mbi diferencat për tatimpaguesit “A.O.”, “EU P.” në lidhje me konkluzionet mbi verifikimet e diferencave midis shitjeve të deklaruara sipas deklaratave të TVSH-së dhe të ardhurave të deklaruara sipas deklaratës së TF-së për periudhën 2020.

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, me shkresën nr. 70779 prot., datë 24.10.2023 kishte njoftuar tatimpaguesin “C. T.” SHPK për diferenca dhe mospërputhje të dhënash, bashkëngjitur dokumentet “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore”, si dhe Raporti i vlerësimit tatimor nga zyra i datës 18.10.2023.

Statusi: Në proces zbatimi

15.2 Rekomandimi: Të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë kryente propozimet dhe ndjekjen e diferencave të konstatuara, si dhe vlerësonin dhe rivlerësonin kryerjen e kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

16.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në shumën 16,767,826 mijë lekë, në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 70773 prot., datë 24.10.2023, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, kishte përcjellë praktikën e Aktit të Vlerësimit nga Zyra të tatimpaguesit "E.A.2020", në të cilin i kishin bashkëngjitur njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore.

Statusi: Në proces zbatimi

16.2 Rekomandimi: Të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë kryente propozimet dhe ndjekjen e diferencave të konstatuara, si dhe vlerësonin dhe rivlerësonin kryerjen e kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

17.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në shumën 5,678,321 mijë lekë, në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

1. Qëndrimi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në lidhje me këtë rekomandim, për të cilin nuk kishte paraqitur dokumente justifikues.

Në lidhje me diferencat negative dhe pozitive, midis deklarimeve të shoqërisë dhe të dhënave doganore për eksportet dhe importet, ju sqarojmë se nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit nga Zyra për Biznesin e Vogël janë duke u verifikuar diferencat. Për rastet e verifikuara janë konstatuar:

- Tatimpaguesit që kanë kryer rakordimet përkatëse në sistemin tatimor. Një pjesë e importeve dhe eksporteve janë deklaruar në muajt pasardhës prandaj dhe ekziston dhe mosrakordimi në muajt përkatës.

-Tatimpagues që kanë blerë aset (aktiv) të cilët, mbështetur në Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH" i ndryshuar, neni 5, pika nr. 4, janë të përjashtuar nga regjistrimi me TVSH.

- Diferencat kanë ardhur nga mosrakordimet dhe deklarimet midis sistemit të doganës dhe tatimeve subjekteve, si dhe mosrakordimi nga ana e shoqërive me doganat, për periudhën tatimore 2018- 2020.

-Gjithashtu sqarojmë se një pjesë e këtyre diferencave të eksportit vijnë si rezultat i subjekteve fason ku në deklaratat doganore është e përfshirë dhe blerja e mallit të porositësit e cila nuk

është eksport por është kthim malli i përfunduar, si eksport për tatimpaguesit shërben vetëm haku i punës. Ky rekomandim është në proces.

2. Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, kishte marrë masa në vlerësimet për të ardhurat e munguara në shumën 1,555 mijë lekë.

Me shkresën nr. 70774 prot., datë 24.10.2023, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, kishte përcjellë Akt verifikimin për tatimpaguesin “E. G. & Ch.” në lidhje me konkluzionet mbi verifikimet e diferencave në importe tatime-doganë për periudhën 2020.

Me shkresën nr. 70775 prot., datë 24.10.2023, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, kishte përcjellë Akt verifikimin për tatimpaguesin “M..Al” në lidhje me konkluzionet mbi verifikimet e diferencave në importe tatime-doganë për periudhën 2020.

Statusi: Në proces zbatimi

17.2 Rekomandimi: Të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Bisnesin e Madh, kishte marrë masa për kryerjen e vlerësimeve nga zyra. Nuk kishte propozuar kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit.

Statusi: Në proces zbatimi

18.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në shumën 56,155 mijë lekë, në zërin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 73026 prot., datë 30.10.2023, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Vogël kishte paraqitur Akt konstatimin nga zyra dhe Njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore të tatimpaguesit “G.” SHPK, në lidhje me detyrimet e papaguara.

Me shkresën nr. 73027 prot., datë 30.10.2023, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Vogël kishte paraqitur Akt konstatimin nga zyra dhe Njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore të tatimpaguesit “R.H.” PF, në lidhje me detyrimet e papaguara.

Statusi: Zbatuar plotësisht

18.2 Rekomandimi: Të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Bisnesin e Madh, kishte marrë masa për kryerjen e vlerësimeve nga zyra. Nuk kishte propozuar kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit.

Statusi: Në proces zbatimi

18.3 Rekomandimi: DRT Tiranë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e vogël, të analizojnë me hollësi treguesit e vetë deklaruar të tatimpaguesve të regjistruar në tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe të propozojnë ndryshimin e përgjegjësisë tatimore për tatimpaguesit të cilët plotësojnë kushtet për kalimin në përgjegjësinë tatimore të TVSH-së dhe Tatimit mbi Fitimin.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël në lidhje me këtë rekomandim ka rezultuar se është shqyrtuar rekomandimi i lënë nga KLSH, por në lidhje me mospranimin e tij kanë argumentuar sa më poshtë:

- Në lidhje me konstatimin për 1,753 tatimpagues me mbi mesatarisht 5 punonjës përgjatë periudhës tatimore 2018-2020, të cilët rezultojnë pa përgjegjësi tatimore të TVSH-së bazuar në nenin 117, të Ligjit me Nr. 92/2014 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH' i Ndryshuar, Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 i ndryshuar dhe VKM me Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese Të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të ndryshuar me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, kushti për të ndryshuar përgjegjësitë tatimore janë të ardhurat e realizuara nga subjekti, në rastin konkret këto të ardhura do vlerësoheshin në momentin e vetë deklarimit. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, rastet e përjashtimit apo kufiri minimal i regjistrimit për kategori të veçanta, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

-Numri i punonjësve dhe çdo shpenzim tjetër që ka lidhje me zhvillimin e aktivitetit dhe me kostot e punës nuk është kusht ligjor për të kaluar subjektin nga përgjegjësia e vetëdeklaruar nga ai në përgjegjësi më të lartë.

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH-ja në lidhje me konstatimin për 1,753 tatimpagues me mbi mesatarisht 5 punonjës përgjatë periudhës tatimore 2018-2020, të cilët rezultojnë pa përgjegjësi tatimore të TVSH-së rezulton se 60 % të tatimpaguesve kanë patur përgjegjësinë tatimore TVSH, por janë çregjistruar nga përgjegjësia TVSH-së sipas VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, VKM me Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Statusi: Pa pranuar

19.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë një analizë të thelluar të situatës së tatimpaguesve të cilët kanë kaluar kufirin e xhiros, duke ndërmarrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për t'i kaluar në përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, gjithashtu të vlerësohen të ardhurat tatimore të munguara në zërin e TVSH-së, në shumën 17,314 mijë lekë, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

-Me shkresën nr. 6189 prot., datë 24.03.2021, "Për ndryshim Përgjegjësie Tatimore", Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Vogël, i ishte drejtuar Sektorit të Regjistrimit, së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT Tiranë, për kryerjen e ndryshimeve në sistemin informatik dhe njoftimin e 239 tatimpaguesve, lidhur me ndryshimet e pësura dhe detyrimet që lindnin nga ky ndryshim.

-Me shkresën nr. 37722 prot., datë 12.07.2023, "Për ndryshim Përgjegjësie Tatimore", Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Madh, i ishte drejtuar Sektorit të Regjistrimit, së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT Tiranë, për kryerjen e ndryshimeve në sistemin informatik dhe njoftimin e tatimpaguesit "K. B.", lidhur me ndryshimet e pësura dhe detyrimet që lindnin nga ky ndryshim.

Statusi: Zbatuar plotësisht

20.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për efektet financiare në vlerën 2,530 mijë lekë detyrime TF, si pasojë e mungesës së monitorimit korrekt të kërkesave në ulje të tatimit mbi fitimin, me qëllim arkëtimin e tyre në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, kishte marrë masa për monitorimin korrekt të kërkesave në ulje të tatimit mbi fitimin.

1. Me shkresën nr. 16892 prot., datë 25.04.2023, kjo Drejtori kishte kryer “Akt rivlerësimit për kështet paraprake të tatim mbi fitimin”, për subjektin “L. V. Tech.”, për periudhën Maj-Dhjetor 2023 dhe Janar-Mars 2024, të kërkuara nga subjekti, me çështjen nr. E0001086682 datë 18.04.2023.

Me shkresën nr. 16803/1 prot., datë 12.05.2023, kjo Drejtori kishte kryer “Akt rivlerësimit për kështet paraprake të tatim mbi fitimin”, për subjektin “L. M.”, për periudhën Qershor-Dhjetor 2023 dhe Janar-Mars 2024, të kërkuara nga subjekti, protokolluar në DRT Tiranë me nr.16803, datë 25.04.2023.

2. Me shkresën nr. 3570/1 prot., datë 07.08.2023, “Dërgohet praktika e sistemit”, Drejtorja kishte kryer “Akt rivlerësimit për kështet paraprake të tatim mbi fitimin”, për subjektin “E.” SHPK, për periudhën Maj-Dhjetor 2023 dhe Janar-Mars 2024, ku sipas kërkesës nga subjekti dhe verifikimeve në sistemin tatimor, ishin kryer edhe korrigjimet përkatëse.

Me shkresën nr. 38649/1 prot., datë 18.08.2023, “Dërgohet praktika e sistemit”, Drejtorja kishte kryer “Akt rivlerësimit për kështet paraprake të tatim mbi fitimin”, për subjektin “M. D.” SHPK, për periudhën Shtator-Dhjetor 2023 dhe Janar-Mars 2024, bazuar në Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore (KSHAT), i cili kishte pranuar ankimimin e tatimpaguesit. Pasi ishin kryer verifikimet në sistemin tatimor, ishin kryer edhe korrigjimet përkatëse.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 8 masa disiplinore, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. Niveli i masës “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”, për 8 (tetë) punonjës, si më poshtë:

1. L. Zh., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” dhe Udhëzim Nr.3, Datë 3.2.2010 “Për Miratimin e Koston Mesatare të Ndërtimit të Banesave nga

Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, për 1 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 69,080,279 lekë.

2. A. K., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- *Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 118, neni 124, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” dhe Udhëzim Nr.3, Datë 3.2.2010 “Për Miratimin e Koston Mesatare të Ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, për 2 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 25,247,652 lekë.*

3. H. M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- *Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124, për 2 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 23,311,665 lekë.*

4. A. T., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- *Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” dhe Udhëzim Nr.3, Datë 3.2.2010 “Për Miratimin e Koston Mesatare të Ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, për 1 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 15,123,905 lekë.*

5. S. M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- *Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 118, neni 124, për 1 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 10,123,747 lekë.*

6. S. O., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124, neni 128 për 1 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 1,393,316 lekë.

7. M. Xh., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115 dhe neni 21 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", për 1 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 1,003,202 lekë.

8. F. P., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020;

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, neni 118, për 2 raste të konstatuar me efekte financiare të ardhura të munguara në Buxhetit e Shtetit në vlerën 1,279,001 lekë.

D/1. Për punonjësit e Sektorit të Monitorimit dhe Kontrollit nga Zyra për Biznesin e Vogël dhe të Madh në DRT Tiranë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të analizohen dhe vlerësohen rast pas rasti mangësitë dhe parregullsitë e trajtuara më hollësisht në pikën 2.3, faqe 54-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekset bashkëlidhur.

D/II. Për punonjësit në pozicionin e punës Drejtor dhe Përgjegjës Sektori dhënia e masës disiplinore të vlerësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në cilësinë e organit epror, bazuar në performancën e secilit prej tyre e të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për periudhën auditimit 01.01.2018 deri 31.12.2020.

Për vlerësim nga departamenti juridik

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, kishte marrë masa duke "Propozuar masë disiplinore", Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1. Me shkresën nr. 31614 prot., datë 23.06.2023, "Propozim për masë disiplinore" për znj. L. Zh., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, për

periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 386, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

2. Me shkresën nr. 31613 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për z. A.K., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 390, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

3. Me shkresën nr. 31615 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për znj. H.M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 387, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

4. Me shkresën nr. 31616 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për znj. A.T., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 389, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

5. Me shkresën nr. 31618 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për z. S.M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 384, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

6. Me shkresën nr. 31617 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për z. S.O., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 385, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

7. M. Xh., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë; për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, kjo nëpunëse ishte transferuar me detyrë në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

8. Me shkresën nr. 31619 prot., datë 23.06.2023, “Propozim për masë disiplinore” për z. F. P., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Vendimi i Ndërmjetëm nr. 388, datë 14.09.2023, i Komisionit të Disiplinës në DPT, kishte vendosur pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 886/29, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

b. Zbatimi i rekomandimeve për periudhën e audituar nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021

1.3.b. Përshkrimi i auditimit

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 1247/58 prot., datë 30.09.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2021-

31.12.2021, protokolluar në subjekt me nr. 28311 prot., datë 04.10.2022, janë rekomanduar për zbatim 17 rekomandime “Masa organizative”, 4 rekomandime “Shpërblim dëmi ekonomik, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe “Masa disiplinore” për 16 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar me shkresën nr. 29896 prot., datë 18.10.2022, **ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor** nga marrja e RPA, veprim në zbatim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.
- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*, **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë z. R. P..

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 17 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë të marrë masa që procesi i inventarizimit të bëhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Me Urdhrin nr. 29, protokolluar me nr. 25880, datë 19.09.2022, të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i inventarizimit të vlerave materiale të DRT Tiranë për vitin 2022, me përbërjen e 5 punonjësve. Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni kishte mbajtur proces-verbalin me nr. 25880/1 prot., datë 03.11.2022, mbi gjendjen e konstatuar.
- Me Urdhrin nr. 25880/3 prot., datë 07.11.2022, të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i vlerësimit të vlerave materiale në magazinat e DRT Tiranë, me përbërjen e 5 punonjësve. Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni kishte mbajtur relacionin me nr. 25880/4 prot., datë 07.12.2022 mbi gjendjen e konstatuar.

- Me Urdhrin nr. 41, protokolluar me nr. 36245, datë 12.12.2022 të Titullarit të Institucionit ishte ngritur Komisioni i asgjësimit të aktiveve në DRT Tiranë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tiranë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ishin kryer inventarizimet dhe arkivimet e dosjeve të procedurave të prokurimit për vitin 2022. Praktika “Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime”, procedurë prokurimi me vlerë të vogël, ishte inventarizuar dhe protokolluar me fletën përmbledhëse nr. 35497/5 prot. Në dosjen për procedurën blerje me vlerë të vogël “Siguracioni i automjeteve në zotërim të DRT Tiranë” u verifikuan: urdhër-shpenzimi nr. 73, datë 21.03.2023; Memo, kërkesë për pagesën e siguracioneve të mjeteve të institucionit; urdhër-prokurimi nr. 10, datë 27.02.2023; ftesë për ofertë; oferta nga 3 operatorë me kartelat shoqëruese të praktikave, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, i firmosur nga komisioni i procedurës; faturë tatimore shitjeje e shoqëruar me formular vetë deklarimi të operatorit, kopje të licencës së operatorit, vërtetim të llogarive bankare; marrëveshja e shërbimit; vërtetim shlyerje detyrimesh nga OSHEE; vetë deklarim për konflikt interesi nga komisioni i prokurimit; polisë sigurimi.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të marrë masat e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve, me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, me qëllim uljen e riskut të mos arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara kishte marrë masat në hartimin e Planit të punës. Me shkresën nr. 363 prot., datë 05.01.2023 kishte hartuar në fillim të vitit, Plan pune për muajin Janar 2023, në lidhje me detyrat dhe përcaktimin e prioritetëve në ndjekje të masave shtrënguese.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Drejtuesit e njësisë përgjegjëse dhe nëpunësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë gjatë procedurave administrative të nxjerrjes dhe evadimit të akteve administrative të respektojnë afatet ligjore të nxjerrjes së akteve me qëllim eliminimin e riskut në mos vlefshmërinë ligjore të akteve administrativë të nxjerra nga kjo njësi përgjegjëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Me shkresën nr. 7308 prot., datë 12.04.2022, Drejtoria e Kontrollit të Biznesit të Madh në DRT Tiranë, kishte dërguar “Njoftim kontrolli tatimor”, në subjektin “T.B.P.” SHPK. Me shkresën nr. 7308/2 prot., datë 17.06.2022, i kishte dërguar subjektit, Raportin e Kontrollit Tatimor duke respektuar afatet ligjore të nxjerrjes së akteve.
- Me shkresën nr. 26139/1 prot., datë 22.02.2023, Drejtoria e Kontrollit të Biznesit të Madh në DRT Tiranë kishte dërguar “Autorizimin për fillimin e kontrollit” në subjektin “E.S.”. Me shkresën nr. 26139/3 prot., datë 05.04.2023, i kishte dërguar subjektit, Raportin e Kontrollit Tatimor duke respektuar afatet ligjore të nxjerrjes së akteve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtori Rajonal Tiranë të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Nga auditimi ka rezultuar:

Rekomandimi nuk është pranuar, për faktin se auditimi i përket periudhave tatimore të subjekteve para vitit 2018, si dhe referuar Ligjit “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 73, pika 1, ku cilësohet: *“E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 viteve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”*, si dhe të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative”, neni 166, pika c, citon: *“Akti administrativ nuk ekzekutohet nëse kanë kaluar 5 vjet nga data në të cilin akti është bërë i ekzekutueshëm”*.

Statusi: Pa pranuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për të bërë ndryshimet e nevojshme në “Rregulloren e rimbursimit të TVSH-së, mbështetur në analizën e riskut”, në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje dhe sinkron me përcaktimet e ligjit. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me Vendimin nr. 1, datë 27.02.2023, protokolluar me nr. 3019, Komiteti i Riskut në DPT kishte miratuar ndryshime në Manualin e Riskut.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7.1. Rekomandimi: DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në tatimpaguesit, e cilësuar sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit kishte marrë masa në kryerjen e verifikimeve përkatëse për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale.

Me shkresën nr. 27116/28 prot., datë 03.05.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte mbajtur Akt Sistemim, për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale për periudhën 2021, tatimpaguesit “V. N.” PF.

Me shkresën nr. 18444 prot., datë 04.05.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte mbajtur Akt Sistemim, për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale për periudhën 2021, tatimpaguesit “G&M H.” PF.

Me shkresën nr. 27116/29 prot., datë 03.05.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte mbajtur Akt Sistemim, për diferenca midis deklaratave TTHF, TVSH dhe shitjeve me pajisjen fiskale për periudhën 2021, tatimpaguesit “OK.”.

Statusi: Në proces zbatimi

7.2 Rekomandimi: DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e vogël, të analizojnë me hollësi treguesit e vetë deklaruar të tatimpaguesve të regjistruar në tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe të propozojnë ndryshimin e përgjegjësive tatimore për tatimpaguesit të cilët plotësojnë kushtet për kalimin në përgjegjësinë tatimore të TVSH-së dhe Tatimit mbi Fitimin, përfshirë tatimpaguesit e cilësuar sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, kishin kryer verifikime në lidhje me plotësimin e rubrikave të Deklaratës të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për vitin 2021, si dhe me shkresën nr. 29709/2 prot., datë 09.12.2021, kishin njoftuar tatimpaguesit për të kryer ndryshimet e rubrikave të Deklaratës së Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit. Në Aneksin nr. 1 “Lista me tatimpagues të cilët janë plotësuar me vlera mbi 8 milion lekë, i’u është ndryshuar përgjegjësia tatimore” dhe Aneksi nr. 2 “Lista me tatimpagues të cilët kanë korrigjuar Deklaratën e TTHF 2021”.

Statusi: Në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve të analizojë aftësinë paguese të tatimpaguesit me qëllim arritjen e objektivave të lidhjes së Akt-Marrëveshjeve, për likuidimin e plotë të detyrimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

-Me shkresën nr. 4756/1 prot., datë 20.02.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë kishte lidhur “Marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore” me tatimpaguesin “A. V. S.”. Përpara lidhjes së kësaj marrëveshje, tatimpaguesi kishte paguar për llogari të administratës tatimore 20% të detyrimit.

-Me shkresën nr. 13193/1 prot., datë 18.04.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë kishte lidhur “Marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore” me tatimpaguesin “Q. e M. së P.”. Përpara lidhjes së kësaj marrëveshje, tatimpaguesi kishte paguar për llogari të administratës tatimore 20% të detyrimit.

-Me shkresën nr. 12301/1 prot., datë 05.04.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë kishte lidhur “Marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore” me tatimpaguesin “Ph.”. Përpara lidhjes së kësaj marrëveshje, tatimpaguesi kishte paguar për llogari të administratës tatimore 20% të detyrimit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për subjektet që kanë lidhur Akt-Marrëveshje të monitorojë nivelin e detyrimeve të tatimpaguesve, si dhe pagesat e kryera për çdo këst, me qëllim përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Madh, kishte marrë masa në monitorimin e detyrimeve të tatimpaguesve.

Me shkresën 9974/3 prot., datë 26.06.2023, kjo drejtori kishte zgjidhur “Akt-Marrëveshjen për pagesë me këste të detyrimeve tatimore”, me tatimpaguesin “R.-19”, për mos përmbajtje të kushteve të cituara në këtë Akt, nga ana e tij. Me shkresën 9393/3 prot., datë 30.05.2023, kjo drejtori kishte zgjidhur “Akt-Marrëveshjen për pagesë me këste të detyrimeve tatimore”, me tatimpaguesin “AL.”, për mos përmbajtje të kushteve të cituara në këtë Akt, nga ana e tij. Me shkresën 20414/3 prot., datë 17.08.2023, kjo drejtori kishte zgjidhur “Akt-Marrëveshjen për pagesë me këste të detyrimeve tatimore”, me tatimpaguesin “O.G.”, për mos përmbajtje të kushteve të cituara në këtë Akt, nga ana e tij.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1. Rekomandimi: DRT Tiranë të marrë masa të menjëhershme, për vlerësimin e problematikave të nxjerra gjatë auditimit, me qëllim vlerësimin e treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i DRT Tiranë kishte marrë masa për vlerësimin e problematikave, me nxjerrjen e Urdhrit nr. 19 datë 07.04.2023 “Për njohje dhe zbatimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe ngritjen e Grupit të punës në zbatimin brenda afateve të përcaktuara.
Statusi: Zbatuar plotësisht

9.2 Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë çdo fillim viti dhe muaji, planet e punës për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh dhe të Vogël, me detyra të mirë specifikuar sipas funksioneve përkatëse dhe me afate të mirë përcaktuara, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 63911 prot., datë 29.09.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, kishte hartuar Planin e punës për muajin Tetor 2023. Me urdhrin e brendshëm nr. 1130 prot., datë 13.01.2023, të Drejtorit të DRT Tiranë, ishin kryer ndarjet e detyrave funksionale dhe intervalit të NIPT-eve, për inspektorët.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i DPT, në cilësinë e eprorit direkt, me asistencën e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore, të marrë masa për të rakorduar me Drejtorin Rajonal të DRT Tiranë, në mënyrë që urdhrat e brendshëm të dalin në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllimin që parregullsitë e konstatuara me ndikim dhe impakt direkt mbi mbarëvajtjen normale të punës dhe performancën e sektorëve në DRT Tiranë të mos përsëriten në të ardhmen.

Nga auditimi ka rezultuar:

DRT Tiranë kishte marrë masa në nxjerrjen e urdhrave të brendshëm, në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Urdhri nr. 34, datë 20.09.2023, “Mbi ngritjen e Komisionit të Inventarizimit të vlerave materiale në DRT Tiranë për vitin 2023”.

Urdhri nr. 12, datë 16.03.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë dhe të punonjësve të tjerë të DRT Tiranë gjatë procesit zgjedhor”. (Ky rekomandim i drejtohet DPT për zbatim).

Statusi: Në proces zbatimi

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin veprime administrative me qëllim përcaktimin e një metodologjie të llogaritjes së detyrimeve totale tatimore, të trajtuara sa më sipër, për subjektet E.E.C. Solution SHA, H.K.P. SHPK, H. C. SHPK dhe HEC-i D. SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime dhe kishin dhënë sugjerime për miratimin e Udhëzimit nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”. (Vërtetuar nga email-et e dërguara në DRT Tiranë nga Drejtoria Teknike e Ligjore e DPT).

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të përcaktojnë një metodologji të qartë dhe të saktë ligjore dhe një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontroleve tatimore, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë ku ata janë ortakë ose e anasjellta, për rastet kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga kundërshtitë ligjore që parashikon kodi i procedurave civile.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime dhe kishin dhënë sugjerime për miratimin e Udhëzimit nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i cili përcakton kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 2, datë 07.06.2023. Në pikën 13, germa (f), 19 dhe 46 të këtij udhëzimi janë përcaktuar procedura që ndiqet në rastet e shoqërive me ortakëri. *(vërtetuar nga email-et e dërguara në DRT Tiranë nga Drejtoria Teknike e Ligjore e DPT)*

Statusi: Zbatuar plotësisht

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin veprime administrative, me qëllim përcaktimin e një metodologjie të llogaritjes së detyrimeve totale tatimore, të trajtuara sa më sipër, për subjektet H. K.P. SHPK dhe H. C. SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kishin kryer takime dhe kishin dhënë sugjerime për miratimin e Udhëzimit nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”. *(vërtetuar nga email-et e dërguara në DRT Tiranë nga Drejtoria Teknike e Ligjore e DPT)*

Statusi: Zbatuar plotësisht

12.2.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të përcaktojnë një metodologji të qartë dhe të saktë ligjore dhe një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontroleve tatimore, kur konstatohen se kemi klasifikim të gabuar kontabël edhe aplikimi i metodës kontabël jo të duhur të amortizimit nga ana e shoqërive në lidhje me aktivin “Hec”, nisur edhe nga mungesa e një përcaktimi shterues për këtë situatë nga legjislacioni fiskal apo standardet kontabël në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kanë kryer takime dhe kanë dhënë sugjerime për miratimin e Udhëzimit nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”. *(vërtetuar nga email-et e dërguara në DRT Tiranë nga Drejtoria Teknike e Ligjore e DPT)*

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 4 masa shpërblim dëmi (të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit), për shumën 69,885,540 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: DRT Tiranë në bashkëpunim me DPT-në, në cilësinë e institucionit epror përgjegjës, t'i drejtohen AKSHI-t, me shkresë zyrtare për normalizimin e situatës së funksionimit të sistemit informatik tatimor dhe rikthimin e dokumentacionit dhe informacionit të fshirë në postën elektronike zyrtare të institucionit, në mënyrë që DRT Tiranë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për Biznesin e Madh dhe të Vogël sipas rasteve

specifike, të kryejë verifikimet përkatëse për diferencat e konstatuara në shumën 24,940,778 mijë lekë nga grupi i auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

b) Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë kishte marrë masa ku për çdo tatimpagues kishte vendosur penalitet, në zbatim të nenit 118, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 70949/1-18 prot., datë 25.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “V.P.”.

Me shkresën nr. 70540 prot., datë 23.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “G.M.” PF, për diferenca deklarim në shitje.

Me shkresën nr. 70540 prot., datë 23.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në DRT Tiranë i kishte dërguar Akt konstatimin dhe Njoftim vlerësimi për detyrim tatimor, tatimpaguesit “G.M.” PF, për diferenca deklarim në shitje.

c) Me shkresën nr. 70782 prot., datë 24.10.2023, Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh në DRT Tiranë, kishte njoftuar tatimpaguesin “A.-AL”, si dhe kishte mbajtur Akt verifikimet më datë 18.10.2023 për tatimpaguesit “T.” dhe “N.K.” për mospërputhje të dhënash, si dhe sistemim të deklaratave të TF-së për periudhën 2020.

Statusi: Në proces zbatimi

1.2 Rekomandimi: DRT Tiranë të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së në shumën 43,046,153,916 lekë, si dhe vlerën 1,897,953,947 lekë, e cila përbën parregullsi në të ardhurat e deklaruara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë, kishte përcjellë me shkresën nr. 70778 prot., datë 24.10.2023, Akt verifikimin e datës 18.10.2023, mbi diferencat për tatimpaguesit “A.O.”, “EU P.” në lidhje me konkluzionet mbi verifikimet e diferencave midis shitjeve të deklaruara sipas deklaratave të TVSH-së dhe të ardhurave të deklaruara sipas deklaratës së TF-së për periudhën 2020.

Me shkresën nr. 70779 prot., datë 24.10.2023 kishte njoftuar tatimpaguesin “C.T.” SHPK për diferenca dhe mospërputhje të dhënash, bashkëngjitur dokumentet: Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.70779 prot., datë 24.10.2023, si dhe Raporti i vlerësimit tatimor nga zyra i datës 18.10.2023.

Statusi: Në proces zbatimi

1.3 Rekomandimi: Gjithashtu, të bëhen propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Tiranë për kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe i Monitorimit në DRT Tiranë kryente propozimet dhe ndjekjen e diferencave të konstatuara, si dhe vlerësonin dhe rivlerësonin kryerjen e kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore, me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore të rillogaritura për subjektet që kanë përfutur apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve tatimore,

në shumën 656,429 lekë, (subjektet “H.K.P.” SHPK me NIPT X, “H.P.C.” SHPK me NIPT X, “H.D.” SHPK me NIPT X në vlerën 200,000 lekë, subjektin “E.” SHPK me NIPT X në vlerën 229,562 lekë, subjektin “Ag.” SHPK me NIPT X në vlerën 152,606 lekë, subjektin “K.-A.” SHPK me NIPT X në vlerën 74,261 lekë).

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 23226/6 prot., datë 30.12.2022 Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, kishte kërkuar verifikimin për këto subjekte. Në Akt verifikimin nga zyra, të datës 28.12.2022, mbajtur nga inspektori znj. E.T.dhe znj. T. F.kishte rezultuar se për subjektet:

1. “H.K.P.” SHPK, nga analizat e kryera nuk ka vend për llogaritje të detyrimeve tatimore.
2. “H.P.C.” SHPK, bazuar në arsyetimet ligjore të inspektorit të kontrollit, shoqërisë nuk dhet ti lindin detyrime tatimore për tatim fitimin, si rrjedhojë e amortizimit të llogaritur nga audituesit e KLSH-së. Inspektori i kontrollit ka znatuar ne menyre korrekte legjislacionin tatimor për Raport Kontrollin e kryer në shoqërinë “H.P.C.” SHPK, NIPT X, janë kryer rivlerësime për të gjitha shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit dhe të reflektuara në sistemin tatimor.
3. “H.D.” SHPK, duke qenë se nuk argumentohet përfitimi i të ardhurave, nuk argumentohet rikarakterizimi i situatës për përfitime të cilat do të kishin efekte në tatim fitimin e pagueshëm, në këto kushte nuk ka vend për rivlerësime tatimore.
4. “E.” SHPK, nga analizat e kryera nuk ka vend për llogaritje të detyrimeve tatimore
5. “Ag.” SHPK, nuk rezultojnë të ketë diferenca për Koston e Mallrave të Shitur për vitin 2020.
6. “K.-An” SHPK, duke marrë në konsideratë të gjitha sqarimet e mësipërme, nuk ka vend për rivlerësime tatimore.

Statusi: Pa pranuar

4. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 16 masa disiplinore, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germtat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **i rekomandojmë** Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

a-Largim nga Shërbimi Civil për:

1. Gj.D. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë

Për shkeljet e mëposhtme:

Për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë Tatimore Rajonale Tiranë, sipas përcaktimeve të pikave 3, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore” të Rregullores të Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020.

b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për punonjësit, si më poshtë:

1. E. J., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
2. G.Z., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
3. S. M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
4. A. B., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
5. F. P., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
6. E. K., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
7. M. M., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
8. E. P., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
9. A.S., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
10. A. L., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
11. A. N., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
12. Gj.C., me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

Për shkeljet e mëposhtme:

Pasi nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se inspektorët/nëpunësit përgjegjës të parashikuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 83 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

1. D.M.
2. Dh. Q.
3. A. B.

Për shkeljet e mëposhtme:

Pasi nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se inspektorët/nëpunësit përgjegjës të parashikuara në ligjin 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, neni 118, ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 21.

D/1. Për punonjësit e Sektorit të Monitorimit dhe Kontrollit nga Zyra për Biznesin e Vogël dhe të Madh në DRT Tiranë, nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të analizohen dhe vlerësohen rast pas rasti mangësitë dhe parregullsitë e trajtuara më hollësisht në pikën 2.3, faqe 42-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekset bashkëlidhur.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Komisionit Disiplinor, kishte marrë masa disiplinore për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1. z. Gj.D.me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë ishte përcjellë Vendimi nr. 430, datë 13.12.2022 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masë “Ndërprerje e ecurisë disiplinore”.
2. z. E. J. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37594/1 prot., datë 11.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 284, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”.
3. z. A.L. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37587/1 prot., datë 11.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 288, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masë “Ndërprerje e ecurisë disiplinore”.

4. z. Gj. C. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37588/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 287, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
5. znj. S. M. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37590/1 prot., datë 10.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 285, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
6. z. A. N. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37593/1 prot., datë 10.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 282, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
7. z. M. M. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37589/1 prot., datë 10.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 286, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
8. z. E. K. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37583/1 prot., datë 10.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 293, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
9. z. A. B. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37586/1 prot., datë 10.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 290, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
10. z. F. P. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37592/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 281, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
11. z. E. P. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37586/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 291, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
12. znj. A. S. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37584/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 292, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.
13. z. D. M. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37591/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 283, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”*.

14. z. A. B. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me shkresën nr. 37582/1 prot., datë 14.07.2023 ishte përcjellë Vendimi nr. 289, datë 10.07.2023 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili kishte vendosur masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 (dy) mujore”.

15. znj. Dh.Q. nëpunës civil, me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Me datë 25.02.2022 ishte liruar nga shërbimi civil “Dalë në pension”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Mbi auditimin e këtij subjekti, është mbajtur Projekt Raporti i Auditimit nr. 886/29, datë 10.11.2023, protokolluar në subjekt me nr. 78102, datë 14.11.2023. Mbi këtë Projekt Raport Auditimi, subjekti ka paraqitur observacionin e protokolluar në KLSH me nr. 886/32, datë 30.11.2023, ku sqarojmë sa më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

Informacion plotësues rreth konkluzioneve sipas Rekomandimit nr. 7.2, Pika 2 “Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ..”Kreu II “Përshkrimi i auditimit për periudhën 01.01.2021-31.12.2021” që ka të bëjë me analizat krahasuese e tepëricave kreditore T.TH.Fitimi, në vitin 2021 në lidhje me ndryshimin e përgjegjësiave tatimore për tatimpaguesit me qarkullim mbi 8,000,000 lekë ose mbi 14,000,000 lekë.

- Nga ana e jonë për tatimpaguesit që kanë qarkullim mbi 8,000,000 lekë në përputhje me të dhënat e vëna në dispozicion nga IT e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë bërë ndryshimet e përgjegjësiave tatimore për 12 tatimpagues të cilët kanë plotësuar kushtin për ndryshim të përgjegjësisë tatimore, praktikën e mbajtura jua bashkëlidhim objeksionit.
- Në lidhje me problematikën e diferencave të rubrikave 8/9 dhe 10/11 të Deklaratës të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për 2021, tatimpaguesit kanë ndryshuar vetë deklaratën sipas Nenit 67 “Deklarata tatimore e ndryshuar”, e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Aneksi nr. 2, bashkëlidhur objeksionit.
- Sipas Nenit 28 “Shkalla Tatimore” të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, duke qenë se këta tatimpagues janë subjekte me qarkullim vjetor nën 14,000,000 lekë, deklarimi i tyre nuk ka sjellë efekt në detyrime tatimore. Të gjitha konstatimet tuaja në lidhje me parregullsitë e konstatuara për këta tatimpagues nuk qëndrojnë pasi nuk kanë efekte fiskale apo të ardhura të munguara në buxhet të shtetit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimin e subjektit, është paraqitur dokumentacion vërtetues bashkëlidhur me observacionin. Aneksi nr. 1 “Lista me tatimpagues të cilët nga plotësimi i Rubrikës 8/9 të TTHF 2021, plotësuar me vlera mbi 8 milion lekë i’u është ndryshuar përgjegjësia tatimore”, Aneksi nr. 2 “Lista me tatimpagues të cilët kanë korrigjuar Deklaratën e TTHF 2021”. Shkresa nr. 2901 prot., datë 15.02.2022 “Për ndryshim përgjegjësie tatimore me tatim fitimi për 118 tatimpagues”, si dhe shkresa nr. 3819 prot., datë 25.02.2022 “Për ndryshim përgjegjësie tatimore me tatim fitimi dhe TVSH”, në të cilën paraqiten 94 tatimpagues të rregjistruar si Biznes i Vogël pa TVSH dhe kanë rezultuar me qarkullim mbi 10,000,000 lekë. Për këtë arsye pretendimi pranohet dhe u bënë reflektimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1.4. Rekomandime

a. Periudha e audituar në auditimin e mëparshëm (01.01.2018-31-12-2020)

1.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 7-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojë dhe miratojë një akt juridik normativ ku të përcaktojnë qartë dhe të saktë llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontrolleve tatimore, kur konstatohen klasifikime të gabuara kontabël edhe aplikim të normës së amortizimit nga ana e shoqërive në lidhje me aktivin “HEC” duke harmonizuar legjislacionin fiskal me standardet kontabël në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

12.2. Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë planet e punës vjetore dhe mujore, për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për biznesin e madh dhe të vogël, me detyra dhe afate të mirë përcaktuara sipas funksioneve përkatëse, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Deri më datë 31.03.2024

b. Periudha e audituar në auditimin e mëparshëm (01.01.2021-31.12.2021)

1.2. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 28-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

9.2. Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë çdo fillim viti dhe muaji, planet e punës për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh dhe të Vogël, me detyra të mirë specifikuar sipas funksioneve përkatëse dhe me afate të mirë përcaktuara, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Deri më datë 31.03.2024

1.5. Aneke

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve 2018-2020”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar

Masa organizative	17	1	16	94	11	2	3	-
Masa shpërblim dëmi “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”	28	3	25	89	14	-	11	-
Masa disiplinore	1	-	1	100	1	-	-	-
Totali	46	4	42	91	26	2	14	0

Burimi i të dhënave DRT Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 2 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve 01.01.2021-31.12.2021”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	17	1	16	94	12	1	3	-
Masa shpërblim dëmi “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”	4	1	3	75	-	-	3	-
Masa disiplinore (Në komp. të organit epror)	1	-	1	100	1	-	-	-
Totali	22	2	20	91	13	1	6	0

Burimi i të dhënave DRT Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

2. DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE ELBASAN

2.1. Konkluzioni i auditimit

Në përfundim të auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/16, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre.

Sa më sipër DRT Elbasan, nuk ka dërguar në KLSH dy raportimet, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15 dhe neni 30. Nga auditimi ka rezultuar nivel i lartë i pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve. Nga DRT Elbasan, pavarësisht mos raportimit në KLSH, ishte hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, si dhe ishin marrë masat e duhura për zbatimin e tyre. Për rekomandimet “Në proces zbatimi”, pritet veprimi i DPT.

Nga 16 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 15 rekomandime, ose 94 % e tyre. Nga 15 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 12 rekomandime, ose 80 % e tyre; janë në proces zbatimi 2 rekomandime, ose 13 % e tyre, rezulton pa zbatuar 1 rekomandim, ose 7 % e tyre.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 10 rekomandime, janë pranuar 9. Nuk është pranuar Rekomandimi 1.1, pasi ka dalë nga konteksti kohor, për shkak se i referohen rekomandimeve të pa zbatuara të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH që i përket periudhës tatimore të subjekteve para vitit 2016. Nga 9 rekomandimet e pranuar nuk është zbatuar rekomandimi 6.1.

- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi”, janë lënë 3 rekomandime, janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime, si dhe është në proces zbatimi rekomandimi nr. 1.1;
- Rekomandimet “Masa administrative”, është lënë 1 rekomandim i cili është zbatuar plotësisht.
- Janë dhënë 2 “Masa disiplinore” të rekomanduara nga KLSH, për 16 punonjës:
- Është zbatuar plotësisht 1 masë disiplinore për 7 punonjës të kontrollit tatimor nga zyra, pasi ka vendimmarrje të Drejtorit të DRT;
- Janë në proces zbatimi masat disiplinore për 6 punonjës të kontrollit tatimor në vend, pasi është përcjellë shkresa për fillim të ecures së masave disiplinore në DPT, ndërsa për Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit në Vend dhe Drejtorin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, vendimmarrja do jetë pas përfundimit të ri kontrolleve të cilat presin miratimin e Formularit nr. 4 nga DPT.
- Për Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit nga Zyra, masa konsiderohet e ezauruar për shkak të daljes në pension.

2.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/3, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.886/16 prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 3, datë 20.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 8366/26, datë 20.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/30 prot., datë 10.11.2023.

Auditimi u krye nga:

- B. Z.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 20.10.2023.

2.3. Përshkrimi i auditimit

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 813/11 prot., datë 01.03.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2020-30.06.2022, protokolluar në subjekt me nr. 8366/43 prot., datë 18.01.2023, janë rekomanduar për zbatim 10 rekomandime “Masa organizative”; 3 rekomandime “Masa për shpërblim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, 1 rekomandim “Të tjera (administrative)” si dhe “Masa disiplinore” për 16 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar **nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditë** nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: *“KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”*.

Nga Drejtori i DRT “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, është miratuar me urdhrin nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023, jashtë afateve ligjore, si dhe nuk është përcjellë në KLSH.

- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”, **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Elbasan z. G. P..

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 10 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1 Rekomandimi: Drejtori i DRT Elbasan të analizojë situatën lidhur me rekomandimet e pa zbatuara për nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Nga DRT ishte dërguar lista për ri kontroll të subjekteve në DPT me shkresën nr. 119/K, datë 27.11.2015, së bashku me formularët e propozimit për ri kontroll. Në lidhje me këtë është kthyer përgjigje nga DPT me shkresë nr. 39410/2, datë 15.12.2015; Dërguar përsëri shkresë nga DRT Elbasan nr. 119/2/k, datë 12.01.2016, ku është cilësuar se plotësohet një nga kushtet për kërkesën e fillimit të ri kontrollit tatimor, referuar nenit 85, germa c të Ligjit 9920/2008 me ndryshime. Nga DPT ishte kthyer përgjigje, ku cilësohej se që të miratohet ri kontrolli tatimor në bazë të nenit 85 pika 1 germa c, duhet të ketë filluar procedura disiplinore apo të jetë marrë masa disiplinore ndaj inspektorëve që kanë kryer shkelje.
- Gjithashtu, nga DRT ishte dërguar DPT shkresa nr. 1478/97 prot., datë 31.08.2015 “Kërkesë për bashkëpunim dhe interpretim për rekomandimet e KLSH-së”, e cila nuk ka marrë asnjë përgjigje nga strukturat e DPT.
- Shkresa dërguar KLSH me nr. 1478/111 prot., datë 30.06.2016 “Mbi rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku i është bërë me dije ecuria e zbatimit të rekomandimeve dhe korrespondenca me DPT zbatim të tyre.

Ky rekomandim nuk është pranuar, për faktin se auditimi i mëparshëm i përket periudhave tatimore të subjekteve para vitit 2016, si dhe referuar Ligjit “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 48 “Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të të dhënave tatimore”,

pika 2 ku cilësohet: “Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet”, nuk mund të kryhen ri verifikime dhe kontrole.

Statusi: Pa pranuar

2.1 Rekomandimi: Drejtori rajonal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për tejkalimet e afateve kohore të komunikimit midis drejtorive përkatëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan dhe QKB-së, si dhe të komunikojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve mbi nevojën e hartimit të një akti administrativ për komunikimin brenda drejtorive në DRT, me qëllim respektimin e afatit ligjor të komunikimit përsa i përket verifikimit të situatës tatimore të subjekteve, në mënyrë të tillë që të ç’regjistrohen subjektet vetëm në ato raste kur ato plotësojnë kushtet përkatëse dhe jo si pasojë e tejkalimit të afatit kohor të përgjigjes nga ana e DRT Elbasan.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrit të Drejtorit Rajonal nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023, për zbatimin e rekomandimit nr. 2.1 ishte mbajtur akt-verifikimi nr. 3858 prot., datë 11.07.2023, ku është cilësuar se: “...referimi i auditit pika 4 e nenit 45 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ka ndryshuar me Ligjin nr. 97/2018, datë 03.12.2018. Sipas pikës 3.3 të nenit 45 të Ligjit nr. 9920/2008, komunikimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për detyrimet tatimore dhe deklaratat e pa dorëzuara të tatimpaguesit, do të bëhet në rrugë elektronike, në kohë reale. Afati 10 ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të personave fizikë do t’i shërbejë administratës tatimore për të verifikuar e vlerësuar situatën tatimore në sistemin e të dhënave që disponon dhe për deklaratat e pa dorëzuara njofton tatimpaguesin”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe akteve ligjore, ka rezultuar se veprohet sipas marrëveshjes dypalëshe dhe protokollit elektronik të komunikimit ndërmjet QKB dhe DPT nënshkruar me nr. 12420/1 prot., datë 07.09.2017 të QKB dhe nr.19812 prot., datë 22.08.2017 të DPT, si dhe përcaktimeve në Ligjin nr. 9920/2008, me ndryshime.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1 Rekomandimi: Drejtori rajonal të marrë masa mbi nxjerrjen e përgjegjësive për problematikat e identifikuar si dhe të urdhëroje ngritjen e grupit për ndërtimin e planit strategjik të institucionit si dhe planin e masave dhe veprimit në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tij. Gjithashtu drejtori rajonal të marrë masa për hartimin e një kuadri të plotë rregullash të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, krijimin e strategjisë së menaxhimit të riskut dhe krijimin e gjurmës së auditit sipas kuadrit ligjor në fuqi. DRT Elbasan në çdo fillim viti të plotësojë pyetësorët e vetëvlerësimit sipas standardeve të parashikuara në manualin e MFK-së dhe gjithashtu të dërgojë deklaratën mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim konsolidimin e saj në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtori i DRT Elbasan, ishte ngritur grupi për menaxhimin strategjik sipas urdhrit nr. 365 prot., datë 23.01.2023; grupi për menaxhimin e riskut sipas urdhrit nr. 366 prot., datë 23.01.2023, si dhe ishte hartuar dhe dorëzuar në DPT dhe Ministri, Regjistri i Riskut dhe pyetësi i vetëvlerësimit. Në lidhje me monitorimin dhe rishikimin e risqeve nga ana e DPT ishte kërkuar informacion me shkresën nr. 15464 prot., 26.09.2023, protokolluar në DRT me nr. 4953, datë 28.09.2023. Nga DRT Elbasan ishte kthyer përgjigje me shkresën nr. 4953/1 prot., datë 29.09.2023. Në lidhje me delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, nga ana e subjektit të audituar është vepruar në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e

Drejtorive Rajonale të Tatimeve nr. 192, datë 12.08.2020 dhe Rregulloren Administratës Tatimore Qendrore nr. 193, datë 12.08.2020.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1 Rekomandimi: Drejtori Rajonal në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të marrë masa për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve sipas përcaktimeve ligjore, si dhe për rastet e procedurave të prokurimit në rrugë shkresore të testohet tregu në mënyrë të tillë që të merret treguesi i çmimeve të punëve/mallrave/shërbimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtori i DRT Elbasan, ishte ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me Urdhrin nr. 1, datë 09.01.2023, protokolluar me nr. 48 prot., datë 09.01.2023, si dhe komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve sipas Urdhrit nr. 2, datë 09.01.2023, protokolluar me nr.155 prot., datë 12.01.2023, si dhe për rastet e procedurave të prokurimit në rrugë shkresore ishin marrë masa për kryerjen e testimit të tregut për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve të analizojë aftësinë paguese të tatimpaguesit, me qëllim arritjen e objektivave të saj, për likuidimin e plotë të detyrimeve, të monitorojë nivelin e detyrimeve të tatimpaguesve, si dhe pagesat e kryera për çdo kësht me qëllim përmbushjen e kushteve dhe uljen e riskut të anulimit të tyre, duke shmangur ri lidhjet e akt marrëveshjeve për të njëjtat subjekte të cilat kanë shkelur kushtet e marrëveshjes, brenda të njëjtës periudhë kohore.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrin të Drejtorit Rajonal 8366/44 prot., datë 15.06.2023 pika 5.1, për analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në lidhje me rekomandimin nr. 5.1, nga Sektori i Kontrollit nga zyra, ishin kryer verifikime dhe ishte mbajtur Akt verifikimi datë 10.07.2023, mbi mangësitë e evidentuara dhe rekomandimin e dhënë nga KLSH, në lidhje me Akt marrëveshjet për likuidimin e detyrimeve me këste, referuar dhe shkresës sqaruese nr. 18839 prot., datë 28.09.2020, në zbatim të nenit 77 dhe 78 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në Akt verifikimi Sektori i kontrollit nga zyra në DRT është shprehur se: *“Janë mbajtur relacione me shkrim për analizimin e kërkesës për Akt Marrëveshje me këste. Në çdo rast është hartuar relacioni me shkrim i cili është përcjellë në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror”*. Sektori i Kontrollit nga Zyra Akt verifikimin e datës 10.07.2023, ja ka përcjellë Drejtorit të DRT me shkresën nr. 3853 prot., datë 11.07.2023.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan t’i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të hartojë një akt administrativ për analizimin e llogarisë së ortakut, në rastet kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga DRT Elbasan nuk është dërguar në DPT, ndonjë kërkesë për sa është rekomanduar nga KLSH.

Statusi: Pa zbatuar

7.1 Rekomandimi: DRT Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa, për të unifikuar praktikën e rimbursimit të TVSH-së nga sektori i monitorimit nga zyra.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të DRT Elbasan, nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023, pika 7.1, ishte mbajtur akt verifikimi me nr. 3926 prot datë 12.07.2023 ku është analizuar dhe trajtuar se: *“Përzgjedhja për kontroll e subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për rimbursim, bëhet nga Drejtoria e Rimbursimit në DPT, e cila dërgon pranë DRT-ës shkresën për të ushtruar kontroll në vend, apo kontroll nga zyra”. Subjektet që janë kontrolluar nga zyra për periudhën e audituar deri në shkurt 2022, janë subjekte 100 % eksportues dhe me rrisht të ulët. Kontrolli për këtë kategori është bërë me procedurë të thjeshtuar. Nga 37 tatim pages (TP) të kontrolluar për rimbursim nga zyra, 36 TP, nuk e kanë apeluar njoftim vlerësimin që i përket akt kontrollit për rimbursim . Në një rast kur nga tatimpaguesi kishte pretendime është kaluar në Projekt raport dhe tatimpaguesi ka paraqitur observacionin përkatës.*

Nga muaji Qershor 2022, në referim të ndryshimeve ligjore, rimbursimet pa rrisht kryhen nga Drejtoria e Rimbursimit në DPT pa kontroll. Vetëm Kontrollat me rrisht propozohen të kryhen nga sektori i kontrollit në vend me procedurën standarde të përcaktuar në Ligjin 9920.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan nëpërmjet Drejtorisë së Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave, të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme të tatimpaguesve që ajo administron dhe t’i paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, me qëllim që veprimtaria për ndjekjen dhe realizimin e të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektive dhe eficiente, duke evidentuar dhe përgjegjësinë në rastet e mosrealizimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga auditimi në lidhje me rekomandimin e mësipërm u konstatua se:

Nga subjekti u raportua se: *“Janë përpunuar të dhënat nga TIK në DPT të dhënat e deklarimeve mujore në lidhje me TVSH, Sigurime Shoqërore Shëndetësore, Tatim Burim (Tatim Fitim, Tatim Fitim Thjeshtuar deklarim vjetor), si dhe të dhënat e raporteve që gjeneron sistemi C@TS” si dhe ishin përgatitur:*

- Raportet krahasuese të realizimit të të ardhurave mujore dhe progresive në rang DRT
- Raportet krahasuese mujore dhe progresive sipas deklaratave TVSH në nivel NIPT dhe sektori.

- Raporte mbi ecurinë e numrit të punësuarve në nivel NIPT dhe sektori.

- Situata e statusit të regjistrimit subjekteve DRT Elbasan me specifikim të klasifikimit, statusit, sektorit, agjencisë, formës ligjore etj.;

- Historiku i ndryshimit statusit dhe përgjegjësi;

- Raport mbi mospërputhjet e deklarimit nga subjekte dhe informacionit doganor. Sipas rastit në bashkëpunim me sektorët përpunohen informacione specifike”.

Nga Sektori AKA ishin përgatitur dhe plotësuar analizat e kërkuara sipas një formatit të përcaktuar paraprakisht nga DPT.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1 Rekomandimi: DRT Elbasan, për tatimpaguesin “B. 2020” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura administrative dhe ligjore me qëllim analizimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së kreditimit të TVSH-së së investimit të kryer nga ana e subjektit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrit nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” pika 9.1. nga Drejtori i DRT ishte lëshuar Autorizimi për verifikim në vend me nr. 8366/48 prot., datë 29.06.2023, si dhe ishte mbajtur Akt verifikimi në vend me nr. 8366/48/1 datë 11.07.2023.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi të marr masa të menjëhershme për vlerësimin e problematikave të nxjerra gjatë auditimit me qëllim vlerësimin e treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, si dhe të hartojë plane mujore të punës duke kryer monitorimin rigoroz të tyre referuar kalendarit tatimor të deklarimit të tatimpaguesve.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me organizimin dhe drejtimin e punëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra, ishin hartuar manualët përkatëse nga DPT-ja. Në manualin e miratuar në dhjetor të vitit 2022, janë përcaktuar dhe detyrat për ndjekjen e punëve për inspektorët e kontrollit nga zyra.
- Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit ishin vendosur targete (objektiva) mujore, për çdo inspektor, për realizimin e detyrave të planit, duke përcaktuar format dhe metodat e punës në komunikim me subjektet;
- Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve midis inspektorëve, në Manualin e ri të kontrollit nga zyra, ishte vendosur që ndarja e NIPT-eve të bëhej për një periudhë 3 vjeçare dhe jo çdo vit, vetëm shtesat e NIPT-eve të reja do të rindahen.
- Në lidhje me verifikimin e TP më me risk, Drejtoria e riskut në DPT sipas problematikave mujore të dala nga Komiteti i Riskut i ka vënë DRT Elbasan në dispozicion *çdo muaj listat e subjekteve më me rrisht si dhe listat e subjekteve që kanë realizuar xhiro për t’ju shtuar përgjegjësia TF apo TVSH.*
- Nga DRT ishte raportuar tek Sekretariati i Komitetit të Riskut për rezultatet e kontrollit në lidhje me këto kategori subjektsh.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi (të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit), për shumën 162,775 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1 Rekomandimi: DRT Elbasan, referuar dosjeve përkatëse të kontrollit, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë **ri kontroll tatimor** me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht **në vlerën prej 31,169,550 lekë detyrime tatimore dhe 20,552,533 lekë gjobë** tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

Nr.	Subjektet	Detyrimi tatimor	Penalitete	Totali
1	“S.C.” SHPK	1,182,843	259,043	1,441,886
2	“E. Sh.” SHPK	4,163,590	911,826	5,075,416
3	“Iz.” SHPK	103,026	22,563	125,589
4	“D. 2015 S.” SHPK	963,882	211,090	1,174,972
5	“H.Zh.” SHPK	885,203	446,609	1,331,812

6	"N. M." SHPK	7,477,935	2,308,331	9,786,266
7	"L. BL" SHPK	1,044,395	1,044,395	2,089,790
8	"F. D."	929,707	929,707	1,859,414
9	"Y. S." SHPK	8,231,399	8,231,399	16,462,798
10	"S. T." SHPK	675,563	675,563	1,351,126
11	"B." SHPK	5,512,007	5,512,007	11,024,014
	Totali	31,169,550	20,552,533	51,723,083

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga DRT Elbasan, sipas Urdhrit të Drejtorit Rajonal nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023, ishte vepruar sa më poshtë:

-Dërguar DPT-së, shkresa nr. 8366/50 prot., datë 11.07.2023 ku është kërkuar miratim i ri kontrolleve tatimore referuar rekomandimeve të KLSH;

- Nga DPT ishte kthyer shkresa nr. 12022/1 datë 18.07.2023 protokolluar në DRT Elbasan me nr. 8366/50/1 datë 20.07.2023 pa veprim.

- DRT Elbasan kishte reaguar përsëri me anë të shkresës nr. 8366/52 prot., datë 24.08.2023 "Për miratim ri kontrolli tatimor bashkë me propozimet për fillimin e ecuresë disiplinore për inspektorët.

- Nga DRT ishin dërguar shkresat për çdo subjekt bashkë me propozimet për fillim të ecuresë disiplinore për inspektorët, sipas shkresave nr. 8366/53-63 prot., datë 19.09.2023 janë aprovuar ri kontrollet me vendimet nr. 25 dhe nr. 39-47, datë 02.10.2023;

DRT Elbasan ishte në pritje të planeve të punës (formularit 4) nga DPT, për fillimin e ri kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1 Rekomandimi: DRT Elbasan, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 55,378,749 lekë detyrime tatimore dhe 55,378,749 lekë gjobë tatimore për kundravajtjet në lëshimin e faturave tatimore.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrit të Drejtorit Rajonal nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023 "Plan pune mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH" ndarja B pika 2.1 dhe në zbatim të Programit të punës të hartuar nga Drejtoria e Kontrollit, ishin mbajtur akte verifikimi nga secili inspektor për subjektet në ngarkim sipas ndarjes aktuale. Ishte analizuar çdo tatimpagues me diferenca në xhiro kase me deklarimin e TFTH apo TF dhe secili rast argumentohet nga inspektori i dosjes me një nga komentet përkatëse:

- *S'ka diferenca,*
- *Subjekti ka kaluar me TVSH-në gjatë vitit, diferenca i përket periudhës para kalimit me TVSH.*
- *Mbajtur Akt vlerësimi nga inspektori*
- *Ndryshuar nga tatimpaguesi*

Sipas Akt verifikimeve të vëna në dispozicion Grupit të auditimit, rezulton se janë marrë në shqyrtim të gjitha subjektet e listuara nga KLSH nga secili inspektor i kontrollit nga zyra (L. A.; M. F.; E. B.; A. K.; K. M. dhe E. H.), të cilët kanë mbajtur akt verifikimet përkatëse. (Akt Verifikimi nr. 3854; Akt verifikimi nr. 3856; Akt verifikimi nr. 3857; Akt verifikimi nr. 3859; Akt verifikimi nr. 3862, datë 11.07.2023).

Në zbatim të pikës nr. 7 të Programit të punës të Drejtorisë së Kontrollit me nr. 8366/49 datë 30.06.2023 ishte hartuar informacioni përmbledhës për Drejtorin Rajonal me nr. 8366/44/1

prot., datë 12.07.2023. Pas shqyrtimit të informacionit përmbledhës Drejtori i DRT ka hartuar “Memo” me nr. 4820 prot., datë 14.09.2023, ku ka shprehur vendimarrjen e tij në lidhje me sa është konstatuar pas verifikimeve në lidhje me rekomandimin e KLSH-së.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1 Rekomandimi: DRT Elbasan, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në Tatimin e Mbajtur në Burim, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 146,700 lekë detyrime tatimore dhe 146,700 lekë gjobë tatimore për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrat të Drejtorit të DRT Elbasan nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023 Kapitulli B pika 3.1 dhe në zbatim të Programit të punës të hartuar nga Drejtoria e Kontrollit pika nr. 6 ishte mbajtur Akt verifikimi datë 06.07.2023, i cili i është përcjellë Drejtorit të DRT me shkresën nr. 3860 prot., datë 11.07.2023 ku është sqaruar se:

- Tatimpaguesi Xh. L. me NIPT X në periudhën kur i është ngarkuar përgjegjësia tatimore tatimit në burim ka deklaruar të ardhura nga qiraja për periudhat paraardhëse, konkretisht në dy deklaratat e dorëzuara (Tetor-Nëntor 2021), tatimpaguesi ka deklaruar tatimin e mbajtur në burim për 26 periudha tatimore gjithsej, nga momenti i lidhjes së kontratës së qirasë (nëntor 2019 deri në fund të vitit 2021);
- Tatimpaguesi A.T. me NIPT X është regjistruar për përgjegjësinë tatimore TMB në korrik 2020 por kjo nuk ka sjelle mos deklarimin apo mospagimin e detyrimeve tatimore të tij. Pasi ai e ka bërë deklarimin e tij vjetor në periudhën e fundit të vitit.
- Per subjektin “Ç.W.I.A.” SHA, ishte dërguar shkresa për kompetencë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me nr. 8366/51 prot., datë 01.08.2023, pasi ishte transferuar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

4.1. Masa administrative:

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 1 masë administrative, për shumën 110 mijë lekë, realizimi i së cilës paraqitet si më poshtë.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura ligjore me qëllim kryerjen e veprimeve administrative për arkëtimin e detyrimeve tatimore për penalitete të rillogarituara për subjektet “Ç.W.I.A.” SHA, “E. H.” SHPK dhe “Xh.B.” PF, në shumën totale 110,000 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrat të Drejtorit të DRT Elbasan nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023 pika 1.1, nga Drejtoria e Kontrollit ishin kryer veprimet e mëposhtme;

- Nga Drejtori i DRT ka dalë Autorizimi për verifikim në vend me nr. 8366/47 prot., datë 29.06.2023 për subjektin “E. H.” me NIPT-X, në bazë të të cilit ishte mbajtur Akt verifikimi në vend me nr. 8366/47/1 prot., datë 30.06.2023, si dhe ishte vendosur gjoba 10,000 lekë.

- Nga Drejtori i DRT ka dalë për verifikim në vend me nr. 8366/46 prot., datë 29.06.2023 për subjektin “Xh. B.” me NIPT-X në bazë të të cilit ishte mbajtur Akt Verifikimi në vend datë 30.06.2023 vendosur gjoba 50,000 lekë.
- Për subjektin “Ç.W.I.A.” SHA, me NIPT-X, nga DRT Elbasan, ishte dërguar shkresa për kompetencë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) me nr. 8366/51 date 01.08.2023, sepse ky subjekt është transferuar në DTM.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.2. Masa disiplinore:

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar masa disiplinore për 16 punonjës të DRT Elbasan, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germet (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”, për 13 (trembëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

Sektori i Kontrollit në vend:

1. V.H., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
 2. M. K., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
 3. A.D., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
 4. V. S., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
 5. E.K., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
 6. R. B., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 24 dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, neni 124, me efekte negative në të ardhurat tatimore.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga DRT Elbasan, sipas Urdhrit të Drejtorit Rajonal nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023, ishte vepruar sa më poshtë:

-Dërguar DPT-së, shkresa nr. 8366/50 prot., datë 11.07.2023 ku është kërkuar miratim i ri kontrolleve tatimore referuar rekomandimeve të KLSH;

- Nga DPT ishte kthyer shkresa nr. 12022/1 datë 18.07.2023 protokolluar në DRT Elbasan me nr. 8366/50/1 datë 20.07.2023 pa veprim.
- DRT Elbasan kishte reaguar përsëri me anë të shkresës nr. 8366/52 prot., datë 24.08.2023 “Për miratim ri kontrolli tatimor bashkë me propozimet për fillimin e ecuresë disiplinore për inspektorët.
- Nga DRT ishin dërguar shkresat për çdo subjekt bashkë me propozimet për fillim të ecuresë disiplinore për inspektorët, sipas shkresave nr. 8366/53-63 prot., datë 19.09.2023 janë aprovuar ri kontrollet me vendimet nr. 25 dhe nr. 39-47, datë 02.10.2023;

DRT Elbasan ishte në pritje të planeve të punës (formularit 4) nga DPT, për fillimin e ri kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

Sektori i Kontrollit nga Zyra:

1. K. M., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
2. L. A., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;
3. E. H., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;
4. A. J., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;
5. E. B., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;
6. M. F., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;
7. A.K., në detyrën e inspektorit të Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; për periudhën 01.01.2020 – 30.06.2022;

Për shkëljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, neni 61 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas urdhrit të Drejtorit Rajonal nr. 8366/44 prot., datë 15.06.2023 “Plan pune mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” ndarja B pika 2.1 dhe në zbatim të Programit të punës të hartuar nga Drejtoria e Kontrollit ishin mbajtur akte verifikimi nga secili inspektor për subjektet në ngarkim sipas ndarjes. Ishte analizuar çdo tatimpagues me diferenca në xhiro kase me deklarin e TFTH apo TF. Sipas Akt verifikimeve të vëna në dispozicion Grupit të auditimit, rezulton se janë marrë në shqyrtim të gjitha subjektet e listuara nga KLSH nga secili inspektor i kontrollit nga zyra (L.A.; M. F.; E. B.; A.K.; K. M. dhe E. H.), të cilët kanë mbajtur akt verifikimet përkatëse. (Akt Verifikimi nr. 3854; Akt verifikimi nr. 3856; Akt verifikimi nr.

3857; Akt verifikimi nr. 3859; Akt verifikimi nr. 3862, datë 11.07.2023). Në zbatim të pikës nr. 7 të Programit të punës të Drejtorisë së Kontrollit me nr. 8366/49 datë 30.06.2023 ishte hartuar informacioni përmbledhës për Drejtorin Rajonal me nr. 8366/44/1 prot., datë 12.07.2023. Pas shqyrtimit të informacionit përmbledhës Drejtori i DRT ka hartuar “Memo” me nr. 4820 prot., datë 14.09.2023, ku ka shprehur vendimmarrjen e tij në lidhje me sa është konstatuar pas verifikimeve në lidhje me rekomandimin e KLSH-së, ku ka cilësuar se: *“Pas informacionit të dërguar mbështetur në saktësimin e problematikave të ngritura dhe arsyetimet e bëra, gjetjet dhe masat e propozuara nuk qëndrojnë. Në këto kushte konstatohet se nuk ka baza për fillimin e ecurisë disiplinore sipas rekomandimeve të KLSH”*.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Për Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për 3 (tre) punonjës, si më poshtë:

1. L. D., në detyrën e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Vend për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
2. A. C., në detyrën e Përgjegjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimi për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;
3. N. P., në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, për periudhën 01.01.2020-30.06.2022;

Për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e Përgjegjëseve të Sektorëve dhe Drejtorit i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave dhe Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të MFE, të nenit 57.

Nga auditimi ka rezultuar:

Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë veprim i drejtpërdrejtë për fillim të ecurisë disiplinore për tre punonjësit e mësipërm. Sipas informacionit verbal të Drejtorit të DRT Elbasan, ky proces do të kryhet pas përfundimit të ri kontrolleve dhe në varësi të rezultateve të tyre. Kryerja e ri kontrolleve është në proces, pasi DRT Elbasan ishte në pritje të planeve të punës (formularit 4) nga DPT, për fillimin e ri kontrolleve.

Statusi: Në proces zbatimi

Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër DRT Elbasan të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve/Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatohen procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga DRT Elbasan, nuk janë kryer njoftime në Departamentin e Administratës Publike, pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë masë disiplinore. Për 7 punonjës për të cilat ka përfunduar procesi mbi dhënie mase disiplinore, nga ana e titullarit është vendosur për mosdhënie mase,

ndërsa për 9 punonjës të tjerë dhënia e masave disiplinore është në proces.

Statusi: në proces zbatimi

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/30, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

2.4. Rekomandime

Për sa më sipër ri kërkojmë:

1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 41-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan t'i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të hartojë një akt administrativ për analizimin e llogarisë së ortakut, në rastet kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Deri më datë 31.03.2024

2.5. Aneke

Tabela nr. 1 "Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve"

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimi %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	10	1	9	90	8	-	-	1
Masa shpërblim dëmi "Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit"	3	-	3	100	2	-	1	-
Masa të tjera (administrative)	1	-	1	100	1	-	-	-
Masa disiplinore	2	-	2	100	1	-	1	-
Totali	16	1	15	97	12	-	2	1

Burimi i të dhënave DRT, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

3. DEGA E DOGANËS DURRËS

3.1.Konkluzioni i auditimit:

Në përfundim të auditimit të ushtruar në Degën Doganore Durrës, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/11, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **Dega Doganore Durrës, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje me raportimin e plan veprimit dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve në KLSH, nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre.

Sa më sipër nga ana e Degës Doganore Durrës janë dërguar shkresat lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30. Nga 21 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 15 rekomandime, ose 71 % e tyre. Nga rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 6 rekomandime, ose 40 % e tyre; janë në proces zbatimi 8 rekomandime, ose 53 % e tyre, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim ose 7% e tyre.

- Rekomandimi “Masa për ndryshime apo përmirësime ligjore” është vënë në dijeni DPD nga ana e DD Durrës; dhe rekomandimi është konsideruar i zbatuar në kushtet kur DD Durrës nuk ka kompetencë për miratimin e ndryshimit ligjor.
- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 11 rekomandime, janë pranuar 10, ku nuk është pranuar rekomandimi 1.1. Prej këtyre rekomandimeve, janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 dhe janë në proces zbatimi 5 rekomandime.
- Rekomandimet “Masa shpërblymjeje”, janë lënë 8 rekomandime nga ku janë pranuar 3 rekomandime, ku 2 paraqiten në proces zbatimi dhe 1 rekomandim është zbatuar.
- Masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, është lënë një masë disiplinore, për 51 punonjës, është në proces zbatimi duke qenë se vendimmarrja lidhur me rastet e mësipërme i takon DPD; konstatohet se nga ana e DD Tiranë janë marrë masat për njoftimin e DPD në cilësinë e organit kompetent për masat disiplinore në administratën doganore.

3.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/6, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/11 Prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Degën Doganore Durrës”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrat elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 9, datë 30.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 16691/3 Prot., datë 30.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/29 prot., datë 10.11.2023 dhe konfirmuar nga subjekti me shkresën nr. 16691/20 prot., datë 07.12.2023, protokolluar në KLSH me nr. 886/34, datë 12.12.2023.

Auditimi u krye nga:

- Xh.N.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 30.10.2023.

3.3.Përshkrimi i auditimit:

Veprimtaria e Degës Doganore Durrës, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021, është audituar nga grupi i KLSH bazuar në Programin nr. 16/1 Prot., datë 17.01.2022 “Mbi përputhshmërinë dhe rregullueshmërinë financiare në Degën Doganore Durrës”, i ndryshuar. Raporti Përfundimtar i Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të Audituar me shkresën nr. 16/29 Prot., datë 05.10.2022, protokolluar në subjekt me nr. 615/50 Prot., datë 07.10.2022, ku janë rekomanduar për zbatim 1 rekomandim “Përmirësim ligjor”, 11 rekomandime “Masa organizative”; 8 rekomandime “Masa për shpërbllim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit” dhe 1 rekomandim “Masa disiplinore” për 51 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar **ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor** nga marrja e RPA, bazuar në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”, ku Dega Doganore Durrës ka kthyer përgjigje pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit nëpërmjet shkresës nr. 615/55 Prot., datë 14.10.2023 “Dërgim Informacioni”, mbi hartimin e Plan Veprimit nr. 615/52 Prot., datë 13.10.2023 dhe Urdhrit të Brendshëm të DDD nr. 41, datë 11.10.2023 për ngritjen e Grupit të Punës me qëllim marrjen në analizim dhe shqyrtim të RPA, brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA.
- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*, **subjekti i audituar ka kthyer përgjigje** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

2. Zbatimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime ligjore. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marri masa për përfshirjen e artikujve “Koks Qymyri për lëndë djegëse” dhe “Qymyr për lëndë djegëse” në listën e Shtojcës nr. 2 bashkëlidhur lidhur Ligjit nr. 61/2012 për Akcizat në RSH, për pagesë të taksës kombëtare akcize sipas nivelit 2 lek/kg. **Nga auditimi ka rezultuar:** Lidhur me këtë problematikë Dega e Doganës Durrës më parë i është drejtuar pëmes shkresave me nr. 20345/37 Prot., datë 26.11.2021; shkresa nr. 20345/33 Prot., datë 23.11.2021 dhe shkresa nr. 20345/35 Prot., datë 25.11.2021, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave duke kërkuar interpretimin për produktet energjitike të parashikuara në nenin 50, pika b, të Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga ana e Departamentit Teknik të Akcizës dhe Procedurave Doganore me shkresën nr. 20345/40 Prot., datë 07.03.2022 (protokolluar në DD Durrës me shkresën nr. 3672 Prot., datë 10.03.2022) është bërë me dije se në Ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH-në”, i ndryshuar”, në shtojcën nr. 1 “Mallrat e tatueshme me akcizë në RSH-në”, bashkëlidhur ligjit, janë përfshirë kategoritë:

- E201 Qymyri me kre 2701;
- E202 Linjiti me kre 2702;
- E203 Koks dhe Gjysëm Koks me kre 2704;
- E204 Gaz Qymyri, Gaz Uji, Gaz Prodhimi me kre 2705;
- E205 Katran i distiluar nga qymyri me kre 2706;

me shkallë taksimi 0 lekë/kg.

Me shkresën nr. 615/56 Prot., datë 20.10.2022 Dega e Doganës Durrës ka përcjellë rekomandimin e KLSH pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton që për këto kategori të jetë përcaktuar shkalla e taksimit në vlerën 0 lekë/kg, edhe pas ndryshimeve ligjore me Ligjin nr. 81/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH-në”, i ndryshuar”, miratuar më datë 24.11.2022, hyrë në fuqi në datë 01.01.2023.

Sa më sipër, në kushtet kur DD nuk është organi kompetent për miratimin e këtij ndryshimi ligjor, por ka njoftuar DPD përmes shkresës përkatëse, rekomandimi konsiderohet i zbatuar nga ana e DD Durrës.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 11 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre të pranuara nga Dega Doganore Durrës dhe të pa arkëtuar në vlerën prej 15,352,307 lekë e rekomanduar në auditimin e mëparshëm.

Statusi: Pa pranuar

2.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave doganore për arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të duhur, duke vlerësuar metodologjinë aktuale të planit të të ardhurave doganore duke bërë pjesë të këtij procesi edhe degën doganore, si dhe të shmanget praktika e kryerjeve të ndryshimeve të shpeshta në plan duke ndjekur nivelin e realizimit. Në vijim, Dega Doganore Durrës, të ndjekë limitet e përcaktuara në planin mujor duke kryer analiza të mirëfillta sipas llojit të të ardhurave doganore të gjeneruara, për të përcaktuar saktë faktorët që rezultojnë në mbi realizim apo mos realizim apo kryerjen e analizave krahasimore me vitin paraardhës, duke mos u mjaftuar vetëm në evidenca sintetike statistikore.

Nga auditimi ka rezultuar: Dega Doganore Durrës me shkresën nr. 615/57 Prot., datë 20.10.2022 ka përcjellë rekomandimin e KLSH pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si organi kompetent për procesin e planifikimit të të ardhurave doganore. Në kushtet ku analizat e përmendura realizohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Dega Doganore Durrës nuk është e përfshirë në proces.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me institucionet e përmendura në Udhëzimin nr. 15, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës” të marrin masa që të hartojnë programin për rikuperimin e borxhit doganor në vlerën prej 7,187,458,907 lekë, edhe nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja.

Nga auditimi ka rezultuar: DD Durrës i referohet Udhëzimit nr. 15 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, në këtë kuadër, ka dërguar pranë DPD shkresën nr. 615/57 Prot., datë 20.10.2022 duke e vënë në dijeni këtë të fundit lidhur me rezultatet dhe rekomandimet e KLSH sa i takon borxhit doganor.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, të marrë masa të menjëhershme, për plotësimin e dosjeve me të gjithë dokumentacionin e duhur, si dhe inventarizimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të autorizimeve të mbyllura për regjimet që operojnë pranë Degës Doganore Durrës.

Nga auditimi ka rezultuar: Përmes shkresës nr. 615/58 Prot., datë 20.10.2022, DD Durrës ka informuar Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore dhe Zyrën e Arshivës lidhur me rekomandimet e lëna nga KLSH si dhe ka urdhëruar zbatimin e rekomandimit, duke lënë si afat datën 31.12.2022 për njoftimin mbi realizimin/mosrealizimin e rekomandimit, ndaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi. Nga Zyra e Mbikëqyrjes është kthyer përgjigja përmes shkresës nr. 16696/16 Prot., datë 02.11.2023 (referuar shkresës së Kryetarit të DD Durrës nr. 16691/5 Prot., datë 02.11.2023) ku specifikohet se dosjet janë gati për t’u inventarizuar, por nuk ka ambiente në dispozicion.

Statusi: Në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës dhe Sektori i Mbikëqyrjes Doganore, të marrë masat në plotësimin e dokumentacionit (mund të thuhet emërtimi i plotë i tij) në mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv me të gjitha elementët e tij si: data, firma e doganierit mbikëqyrës, Kryetarit të Degës Doganore dhe më pas protokollimin e tij.

Nga auditimi ka rezultuar: Kryetari i DD Durrës ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm me nr. 43, datë 20.10.2022 për marrjen e masave me qëllim plotësimin e udhëzimeve dhe detyrave funksionale të vendit të punës, ku ndër të tjera edhe: plotësimi i datës së mbylljes së regjistrimit, firma e doganierit dhe Kryetarit të DD Durrës, plotësimi i vlerës së shtuar të mallit dhe kodeve të produkteve, etj; ndaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1. Rekomandimi: Sektori i Mbikëqyrjes Doganore të marrë masat për të maksimizuar kontrollet e kryera për verifikimin e procedurave të asgjësimit të mbetjeve si dhe për verifikimin e koeficienteve të shfrytëzimit, në mënyrë që të garantohet kryerja e tyre konform kuadrit ligjor dhe në përputhje me sasitë e deklaruara në dokumentacionin shoqërues, si dhe të pajisë çdo dosje regjimi për këto procedura me të gjithë dokumentacionin shoqërues në mënyrë që të ketë një pasqyrim sa më të drejtë të situatës. Gjithashtu, të shqyrtohet mundësia për aplikimin e metodave alternative në rastet e koeficientëve të shfrytëzimit që do të merren në konsideratë për ato operatorë që objekt veprimtarie kanë produkte të ndryshme dhe për të cilat ky koeficient varion.

Nga auditimi ka rezultuar: Kryetari i DD Durrës me shkresën nr. 615/59 Prot., datë 20.10.2022 ka vënë në dijeni Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore mbi rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit të KLSH si dhe ka urdhëruar marrjen e masave mbi zbatimin e rekomandimit. Nga Zyra e Mbikëqyrjes është kthyer përgjigja përmes shkresës nr. 16696/16 Prot., datë

02.11.2023 se është vepruar në përputhje me rekomandimet, si hallka të procesit të punës së përditshme, gjithashtu janë përcaktuar koeficientët e rekomanduar.

Statusi: Në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës të analizojë procesin aktual të ndjekur për kryerjen e ndryshimeve në autorizim sipas nevojës së subjektit dhe të nxirren përgjegjësitë duke e përcaktuar në mënyrë eksplicite në shkresat përkatëse, rastet për të cilat ky ndryshim do të ketë efekt para veprues në kuptim të kapitullit II “Të përgjithshme” pika 6 të udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019. Gjithashtu, të merren në shqyrtim rastet e mallrave të përpunuara nën një regjim doganor dhe që do të duhet të kthehen për riparim apo probleme të tjera, dhe më pas të importohen sërish nga subjekti, për të përcaktuar nëse këto kode nuk janë në autorizim, në vlerësim të kushteve të importit duhet apo jo të aplikohet penalizimi përkatës ndaj subjekteve.

Nga auditimi ka rezultuar: Kryetari i Degës së Doganës Durrës me shkresën nr. 615/60 Prot., datë 20.10.2022 ka urdhëruar Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore për zbatimin e rekomandimit. Nga Zyra e Mbikëqyrjes është kthyer përgjigja përmes shkresës nr. 16696/16 Prot., datë 02.11.2023 se është vepruar në përputhje me rekomandimet, si hallka të procesit të punës së përditshme.

Statusi: Në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Dega Doganore Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të verifikojnë faturat e subjekteve në importin e artikullit membranë bituminoze të deklaruar në kapitullin 69 të nomenklaturës mallrave sipas praktikave doganore të vitit 2021 si dhe të kryejë veprime verifikuese pranë tyre për çmimet e këtij artikulli.

Nga auditimi ka rezultuar: Referuar shkresës nr. 16184 Prot., datë 20.10.2022 të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore rezulton se janë marrë masa për njoftimin e subjekteve me shkresat me nr. 16184/1/2/3/4/5/6. Nga ana e Administratës Doganore kompetente në shkresën me nr. 16184/15 Prot., datë 16.11.2022 është pranuar vlerësimi doganor sipas transaksionit. Nga ana e DD Durrës me shkresën nr. 16184/19 Prot., datë 23.11.2022 për shoqërinë M.E.SHPK; shkresën me nr. 16184/27 Prot., datë 15.12.2022 për shoqërinë P.B.SHPK; shkresën me nr. 16184/31 Prot., datë 21.12.2022 për shoqërinë V. & PSHPK; shkresën me nr. 16184/32 Prot., datë 21.12.2022 për shoqërinë E.C.SHPK dhe shkresën me nr. 16184/34 Prot., datë 10.01.2023 për shoqërinë D. SHPK, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me kërkesë për verifikim fature.

Nga ana e DPD, me shkresën nr. 20741/1 Prot., datë 15.12.2022, është bërë me dije se janë duke u kryer verifikime për kompaninë M.E.pranë homologëve gjermanë në lidhje me artikullin membranë bituminoze.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës të shqyrtojë rastet e trajtuara nga grupi i auditimit mbi mangësitë e evidentuara të dokumentacionit të dosjeve dhe në vijimësi të marrë masat e nevojshme në bashkëpunim me zyrën juridike për plotësimin e tyre.

Në vijimësi sektori aposterior dhe zyra juridike të kryejnë dhe të dokumentojnë njoftimin shkresor të operatorëve ekonomikë duke zbatuar afatet kohore të ankimimit dhe vendimmarrjes.

Nga auditimi ka rezultuar: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi, si veprim në vijimësi pjesë e procesit të punës duke njoftuar operatorët ekonomikë përmes shkresave përkatëse në rastet kur njoftimi vjen nga sektori aposterior (operatori ekonomik nuk është prezent) si dhe përmes nënshkrimit të operatorit ekonomik, kur ai është prezent.

Statusi: Në proces zbatimi

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës dhe përgjegjësi i Sektorit të Porto Romanos, në vijimësi të marrin masa periodike 6 mujore për kryerjen e inventarit fizik të mallrave çdo 6 muaj.

Nga auditimi ka rezultuar: Kryetari i Degës së Doganës Durrës nëpërmjet shkresës nr. 615/53 Prot., datë 13.10.2022, ka kërkuar nga ana e personelit të Sektorit të Porto Romanos zbatimin me korrektësi të rekomandimit. Duke qenë se kompetenca për kryerjen e inventarizimit fizik është e Sektorit të Porto Romanos, rezulton se Kryetari i DD Durrës ka vënë në dijeni Sektorin e Hidrokarbureve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.2. Rekomandimi: Në vijimësi doganierët e sektorit të Porto Romanos të ngarkuar për marrjen e mostrës, të vlerësojnë maksimalisht nënshkrimin e Aneksit 4 si dhe kërkesave të tjera ligjore për marrjen e mostrës, me qëllim shmangien e risqeve që mund të lindin nga pretendimet e mundshme të subjekteve.

Nga auditimi ka rezultuar: Për realizimin e këtij rekomandimi Kryetari i Degës së Doganës Durrës me shkresën nr. 615/53 Prot., datë 13.10.2022 ka kërkuar nga ana e personelit të Sektorit të Porto Romanos zbatimin me korrektësi të rekomandimit. Duke qenë se kompetenca për përmbushjen e këtij rekomandimi është e doganierëve të sektorit të Porto Romanos, rezulton se Kryetari i DD Durrës ka vënë në dijeni Sektorin e Hidrokarbureve. Nga DDD është paraqitur shkresa 16691/20, datë 14.11.2023, e Sektorit të Hidrokarbureve në Zyrën e Porto Romanos në DDD, ku cilësohet se po veprohet në përputhje dhe me korrektësi Udhëzimi nr. 1, datë 14.02.2023 i DPD, në zbatim edhe të rekomandimit të lënë nga KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 8 masa shpërblim dëmi (të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit), për shumën 327,987 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Dega Doganore Durrës të bashkërendojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 182,290,466 lekë (detyrim dhe penalitet) për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2021 që lidhen me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

Nga auditimi ka rezultuar: DD Durrës ka marrë masa lidhur me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, siç paraqiten edhe në Tabelën nr. 1 të këtij Projekt Raporti, ku nga DD Durrës në total janë përlllogaritur detyrime dhe penalitete në vlerën 24,001,692 lekë, ndërsa ende është në proces përfundimi i përlllogaritjeve për të gjitha rastet e cituara në Aneksin e RPA.

Tabela nr. 1: Pasqyrimi i rillogaritje pagesash detyrime doganore në import, 2021 (Në lekë)

Aneksi sipas RPA	Sipas përlllogaritjeve të KLSH (A)			Sipas DD Durrës (B)			Diferenca B-A
	Detyrimi	Penaliteti	Total	Detyrimi	Penaliteti	Total	
3.1	2 193 483	-	2 193 483				(2 193 483)

3.2	165 520	-	165 520	165 520	-	165 520	-
3.3	10 639 320	-	10 639 320		-	-	(10 639 320)
3.4	1 170 024	-	1 170 024	19 908	-	19 908	(1 150 116)
3.5	13 309	-	13 309		-	-	(13 309)
3.6	448 302	-	448 302	230 546	-	230 546	(217 756)
3.7	31 437	-	31 437	31 437	-	31 437	-
3.8	1 115 466	-	1 115 466				(1 115 466)
3.9	-	-	-	-	-	-	-
3.10	2 242 728	-	2 242 728	862 097	-	862 097	(1 380 631)
3.11	137 572	-	137 572	137 572	-	137 572	-
3.12	2 118 133	-	2 118 133	266 647	-	266 647	(1 851 486)
3.13	540 410	-	540 410	431 807	-	431 807	(108 603)
3.14	1 233 696	-	1 233 696	1 233 696	-	1 233 696	-
3.15	218 103	-	218 103	218 103	-	218 103	-
3.16	1 011 952	-	1 011 952	1 011 952	-	1 011 952	-
3.17	427 812	-	427 812	208 116	-	208 116	(219 696)
3.18	1 500 391	-	1 500 391	36 236	-	36 236	(1 464 155)
3.19	41 667	-	41 667	-	-	-	(41 667)
3.20	2 259 058	-	2 259 058	249 146	-	249 146	(2 009 912)
3.21	1 743 211	1 743 211	3 486 422	-	-	-	(3 486 422)
3.22	181 025	-	181 025	63 249	-	63 249	(117 776)
3.23	5 714 029	-	5 714 029	523 908	-	523 908	(5 190 121)
3.24	-	-	-	-	-	-	-
3.25	62 372	-	62 372	46 469	-	46 469	(15 903)
3.26	-	-	-	-	-	-	-
3.27	756 100	-	756 100	475 838	-	475 838	(280 262)
3.28	920 012	-	920 012	920 012	-	920 012	-
3.29	1 961 977	-	1 961 977	309 006	-	309 006	(1 652 971)
3.30	863 518	-	863 518	186 397	-	186 397	(677 121)
3.31	4 590 199	-	4 590 199	1 056 344	-	1 056 344	(3 533 855)
3.32	310 460	-	310 460	-	-	-	(310 460)
3.33	4 487 084	-	4 487 084	1 326 207	-	1 326 207	(3 160 877)
3.34	4 769 334	-	4 769 334	468 351	-	468 351	(4 300 983)
3.35	2 581 314	-	2 581 314	404 331	-	404 331	(2 176 983)
3.36	226 057	-	226 057	48 550	-	48 550	(177 507)
3.37	6 570 871	-	6 570 871	-	-	-	(6 570 871)
3.38	495 212	-	495 212	39 127	-	39 127	(456 085)
3.39	2 634 567	-	2 634 567	-	-	-	(2 634 567)
3.40	578 779	-	578 779	208 192	-	208 192	(370 587)
3.41	414 116	-	414 116	414 116	-	414 116	-
3.42	1 234 856	-	1 234 856	-	-	-	(1 234 856)
3.43	7 156 836	-	7 156 836	356 473	-	356 473	(6 800 363)
3.47	1 448 155	-	1 448 155	1 373 118	-	1 373 118	(75 037)
3.48	479 463	479 463	958 926	127 361	127 361	254 722	(704 204)
3.49	253 559	253 559	507 118	116 772	116 772	233 544	(273 574)
3.50	18 750	18 750	37 500	18 750	18 750	37 500	-
3.51	26 400	26 400	52 800	26 400	26 400	52 800	-
3.52	238 152	-	238 152	238 152	-	238 152	-
3.53	-	-	-	-	-	-	-
3.54	6 170 291	-	6 170 291	-	-	-	(6 170 291)
3.55	55 559	55 559	111 118	55 559	55 559	111 118	-
3.56	138 072	138 072	276 144				(276 144)
3.57	279 166	-	279 166				(279 166)
3.58	728 233	728 233	1 456 466				(1 456 466)
3.59	252 204	252 204	504 408				(504 408)
3.60	585 086	585 086	1 170 172	98 851	98 851	197 702	(972 470)
3.61		280 000	280 000				(280 000)
3.62	608 842	608 842	1 217 684				(1 217 684)
3.63	419 756	419 756	839 512	100 448	100 448	200 896	(638 616)
3.64	2 665 487	2 665 487	5 330 974	102 309	102 309	204 618	(5 126 356)
3.65	551 610	871 610	1 423 220	45 396	45 396	90 792	(1 332 428)
3.66	7 297 853	7 297 853	14 595 706				(14 595 706)
3.67	2 300 227	2 300 227	4 600 454				(4 600 454)
3.68	182 549	182 549	365 098	162 334	162 334	324 668	(40 430)
3.69	335 173	335 173	670 346	335 173	335 173	670 346	-
3.70	151 939	151 939	303 878	151 939	151 939	303 878	-
3.71	39 007	39 007	78 014	27 389	27 389	54 778	(23 236)
3.72	30 576	425 076	455 652	209 379	219 019	428 398	(27 254)
3.73	-	-	-	-	-	-	-
3.74	197 396	257 396	454 792	197 396	257 396	454 792	-
3.75	9 266 734	9 266 734	18 533 468	1 910 978	1 910 978	3 821 956	(14 711 512)

3.76	1 007 777	1 007 777	2 015 554	352 874	352 874	705 748	(1 309 806)
3.77	266 796	266 796	533 592	266 796	266 796	533 592	-
3.78	-	400 000	400 000				(400 000)
3.79	-	-	-	-	-	-	-
3.80	-	-	-	-	-	-	-
3.81	-	-	-	-	-	-	-
3.82	-	-	-	-	-	-	-
3.83	5 876 975	-	5 876 975				(5 876 975)
3.84	2 847 824	-	2 847 824				(2 847 824)
3.85		-	-	-	-	-	-
3.86		-	-	-	-	-	-
3.87	1 290 417	-	1 290 417	591 540	-	591 540	(698 877)
3.88	866 517	-	866 517	498 889	-	498 889	(367 628)
3.89	223 238	-	223 238				(223 238)
3.90	339 601	-	339 601	149 927	-	149 927	(189 674)
3.91	33 186	-	33 186	33 186	-	33 186	-
3.92	5 931 544	-	5 931 544	485 679	-	485 679	(5 445 865)
Total			160 221 185			24 001 692	(136 219 493)

Burimi: Të dhënat nga Dega Doganore Durrës. Përpunuar nga KLSH.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Dega Doganore Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të ndjekë të gjitha rrugët për nxjerrjen e vendimeve administrative, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 88,600,197 lekë për periudhën 01.12.2021 deri në datën 31.12.2018 për rillojaritje të pagesave të detyrimeve doganore në procedurat e regjistrimit të mallit në Zonën e Lirë Porto Romano dhe në procedurat e deklarimit doganor IMP 9 (Firo te thjeshta) për të cilat nuk është vepruar në përputhje të procedurave për evidentimin e firove, skarcove dhe humbjeve ligjore në regjimin e magazinimit dhe përcaktimit të tyre gjatë prodhimit, magazinimit, transportit etj.

Nga auditimi ka rezultuar: Lidhur me këtë rekomandim, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DD Durrës, konstatohet se kjo e fundit është duke shqyrtuar dokumentacionin përkatës si dhe është ngritur Grupi i Punës lidhur me analizat përkatëse (Urdhri nr. 41, datë 11.10.2022). Deri tani nuk rezulton që të jetë kontabilizuar shuma prej prej 88,600,197 lekë në Zonën e Lirë Porto Romano dhe në procedurat e deklarimit doganor IMP 9 (Firo te thjeshta), ndaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Dega Doganore Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi me qëllim ndjekjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit doganor dhe sanksioneve doganore për arkëtimin e shumës së rekomanduar në shumën 762,322 lekë për 11 raste trajtuar më hollësisht në aneksin respektiv dhe materialin e Raportit të Auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar: Sa i takon marrjes së masave për ndjekjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit dhe sanksioneve doganore lidhur me veprimtarinë e subjekteve që operojnë sipas Ligjit nr. 61/2012, në vlerën totale 762,322 lekë për 11 rastet e detajuara në RPA, DD Durrës ka marrë masa vetëm mbi shumën 662,322 lekë, pasi sipas DD Durrës vlera prej 100,000 lekë nuk mund të kontabilizohet.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 119 raste, në vlerën 11,993,724 lekë. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 7 të Raportit të Auditimit).

Statusi: Pa pranuar

5.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative apo procedurave të tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në 1362 raste në shumën 27,240,500 lekë.

Statusi: Pa pranuar

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës, të shqyrtojë, kontabilizojë dhe arkëtojë detyrime doganore dhe penalitete për subjektet që kanë kryer shkelje në procedurat e mbylljes së regjimit të përpunimit aktiv në drejtim të kufirit të rieksporit; importeve të produkteve parësore të pa përfshira në autorizim; diferencave sasiore në produktet kompensuese, mos pagesës taksës TDP etj., në vlerën totale prej 10,629,957 lekë detyrim doganor dhe penalitet, (të përshkruara hollësisht në aneksin 4.1)

Statusi: Pa pranuar

6.2. Rekomandimi: Kryetari i DDD të ngrejë një grup pune me qëllim verifikimin e problematikave ku është konstatuar mungesa e shtesave në autorizim për disa kode të cilat nuk u vendosën në dispozicion të grupit, por as nuk u konfirmua mungesa e tyre, dhe në rast se konstatohet se për kodet respektive nuk janë miratuar nga titullari, të përllogarisë detyrimet përkatëse për të gjitha procedurat e importit të kryera për këto kode sikundër është vepruar për subjektet e tjera në këtë material.

Statusi: Pa pranuar

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës Doganore Durrës, të shqyrtojë 6 rastet e evidentuara dhe të pasqyruara në këtë material për të kontabilizuar dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit në mënyrë që të arkëtojë vlerën e detyrimeve doganore prej 6,469,840 lekë dhe penalitetin dyfish, në kushtet kur mallit të vendosur nën regjimin doganor nuk i është dhënë destinacion konform afateve të përcaktuara në autorizim.

Statusi: Pa pranuar.

5. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar masa disiplinore për 51 punonjës, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjes në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Durrës, që në vlerësimin e shkeljeve, gjykimit përfundimtar që lidhet me kontabilizimin e detyrimeve doganore të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, proces i cili duhet të kryhet në bashkëpunim të plotë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të urdhëroje dhe të konkludojë me nisjen e procedurave sipas pikës 1 gërma “a”, “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkelje të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, me qëllim klasifikimin e tyre duke urdhëruar fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, për personat përgjegjës në proporcion të plotë me shkeljet doganore, vlerat e konstatuara, veprimet e kryera në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sipas nenit 58 gërma “b”, “c” dhe “ç” të nenit 57 dhe 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, si më poshtë:

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

I. Nga niveli i masës nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit si më poshtë me detyra funksionale pranë Sektorit të Vlerës në Qendër (SVQ) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- 1- Znj. K. S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 2- Znj. K. Xh, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 3- Znj. G. G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 4- Z. L. Xh, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 5- Z. J. S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 6- Z. B. D, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 7- Z. R. M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 8- Z. A.H, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 9- Znj. M.H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 10- Znj. A. B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 11- Znj E. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 12- Z. I. Ç, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 13- Znj. B. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 14- Znj.R. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 15- Z. R.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 16- Z. Sh. Sh, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 17- Z. R. Z, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 18- Znj. E.G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 19- Znj. L.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 20- Z. E. N, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.

me detyrë funksionale doganiere e kontrollit dokumentar pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor SVQ për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021 dhe;

II. Nga niveli i masës “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit si më poshtë me detyra funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- 1- Znj.E. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 2- Znj.A. M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 3- Znj.J. T, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 4- Znj.E. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 5- Znj. K. H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 6- Znj.E. Xh, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 7- Z. A. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 8- Z.D. H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 9- Znj T. Sh, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.

me detyrë funksionale doganier te kontrollit dokumentar pranë Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit (5 Ditor) SKAO nga periudha 01.01.2021 deri 31.12.2021.

III. Nga niveli i masës “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit si më poshtë me detyra funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- 1-Znj S. D, me detyrë përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 2-Z. I.R, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 3-Z. K.B, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 4-Z. J. C, me detyrë përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SKAO-se.

IV. Nga niveli i masës nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, për punonjësit si më poshtë me detyra funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- 1-Z. N.H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 2-Z. E. D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 3-Z. A. N, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 4-Z. A. D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 5-Z.A. Sh, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 6-Z.A. V, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 7-Znj.O. V, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 8-Z. S.T, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 9-Z.H.M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 10-Z.J. C, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 11-Z.M. K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 12-Z.E.M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 13-Z.A. B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 14-Z. O. H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 15-z. R.B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 16- Z. I.M, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 17- Z. R. M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 18- Znj. L. G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.

me detyrë funksionale doganiere e kontrollit dokumentar pranë Drejtorisë së Vlerësimit Doganor SVQ dhe SKAO për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021.

Nga auditimi ka rezultuar:

Dega e Doganës Durrës ka përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 615/69 Prot., datë 12.04.2023 pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave rekomandimet lidhur me masat disiplinore. Nga ana e DD Durrës janë marrë masat e mëposhtme disiplinore, njoftuar me shkresën nr. 6715/1 Prot., datë 25.04.2023:

- Vendimi nr. 6298/2 Prot., datë 09.10.2023 për B. D, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ;
- Vendimi nr. 6174/3 Prot., datë 09.10.2023 për R.D, me detyrë doganier i klasifikim/ vlerësim në SVQ;
- Vendimi nr. 6174/1 Prot., datë 09.10.2023 për E. K, me detyrë doganier i klasifikim/ vlerësim në SKAO;
- Vendimi nr. 6297/2 Prot., datë 09.10.2023 për E. K, me detyrë doganier i klasifikim/ vlerësim në SKAO;
- Vendimi nr. 6300/2 Prot., datë 09.10.2023 për I. M, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO;
- Vendimi nr. 6303/2 Prot., datë 09.10.2023 për R. M, me detyrë doganier i klasifikim/ vlerësim në SKAO;
- Vendimi nr. 6174/2 Prot., datë 09.10.2023 për V. P me detyrë ish doganiere i Sektorit të Doganor Porto Romano. Nga auditimi konstatohet se nga ana e DD Durrës janë marrë masat për njoftimin e DPD në cilësinë e organit kompetent për masat disiplinore në administratën doganore. Gjithashtu, DD Durrës ka ridërguar pranë DPD shkresën nr. 16691/15 Prot., datë 02.11.2023 për këtë qëllim, ndaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/31, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit me shkresën nr. 16691/20 prot., datë 07.12.2023, protokolluar në KLSH me nr. 886/34, datë 12.12.2023,

janë paraqitur observacionet në lidhje me Projektraportin e Auditimit, ku sqarojmë:

Pretendimi i subjektit:

- Në zbatim të **rekomandimit 10.2** “Masa organizative” lidhur me zbatimin e vazhdueshëm të kërkesave ligjore për procedurën e marrjes së mostarve, transportimin dhe dorëzimin për analizim në LD, nga ana jonë konfirmojmë vlerësimin e rekomandimit si dhe zbatimin me korrektësi të procedurës standarde të normuar sipas Udhëzimit nr. 1, datë 04.02.2023. Nga doganierët e sektorit të Porto Romanos të ngarkuar për marrjen e mostrës, është vlerësuar maksimalisht nënshkrimi i Aneksit 4 si dhe kërkesat e tjera ligjore për marrjen e mostrës, me qëllim shmangien e risqeve që mund të lindin nga pretendimet e mundshme të subjekteve.
- **Rekomandimi 2.1.** Lidhur me nxjerrjen e vendimeve administrative, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 88,600,197 lekë për periudhën 01.01.2021 deri në datën 31.12.2021 për rillogaritje të pagesave të detyrimeve doganore në procedurat e regjistrimit të mallit në Zonën e Lirë Porto Romano dhe në procedurat e deklarimit doganor IMP 9 (Firo te thjeshta) për të cilat nuk është vepruar në përputhje të procedurave për evidentimin e firove, skarcove dhe humbjeve ligjore në regjimin e magazinimit dhe përcaktimit të tyre gjatë prodhimit, magazinimit, transportit etj, nga ana jonë parashtrijmë argumentet sipas shkresës nr. 5460/1, datë 24.04.2023 lidhur me kundërshtimet e konkluzioneve rekomanduese të KLSH, duke relatuar pretendimet me argumente objektive, teknike të bazuara dhe në përputhshmëri të plotë me legjislacionin.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

- Në lidhje me rekomandimin nr. 10.2, nga DDD është paraqitur shkresa 16691/20, datë 14.11.2023, e Sektorit të Hidrokarbureve në Zyrën e Porto Romanos në DDD, ku cilësohet se po vepron në përputhje dhe me korrektësi Udhëzimi nr. 1, datë 14.02.2023 i DPD, në zbatim edhe të rekomandimit të lënë nga KLSH. Observacioni është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në RPA, pasi janë paraqitur argumente dhe dokumentacion mbështetës (shkresa nr. 16691/20, datë 14.11.2023 dhe shkresa nr. 5884/3, datë 15.05.2023).
- Në lidhje me rekomandimin nr. 2.1, i cili sipas observacionit rezulton të jetë kundërshtuar nga DPD, nuk është pranuar nga KLSH dhe nuk ka ndryshuar statusi i zbatueshmërisë së rekomandimit pasqyruar në RPA, pasi nga subjekti nuk është bashkëngjitur shkresa nr. 5460/1, datë 24.04.2023, e cila cilësohet se ka të relatuara argumentet e mospranimit të rekomandimit.

3.4. Rekomandime

Për sa më sipër ri kërkojmë:

3.1. Rekomandim: Kryetari i Degës Doganore Durrës, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 54-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave doganore për arritjen e

efiçencës dhe efektivitetit të duhur, duke vlerësuar metodologjinë aktuale të planit të të ardhurave doganore duke bërë pjesë të këtij procesi edhe degën doganore, si dhe të shmanget praktika e kryerjeve të ndryshimeve të shpeshta në plan duke ndjekur nivelin e realizimit. Në vijim, Dega Doganore Durrës, të ndjekë limitet e përcaktuara në planin mujor duke kryer analiza të mirëfillta sipas llojit të të ardhurave doganore të gjeneruara, për të përcaktuar saktë faktorët që rezultojnë në mbi realizim apo mos realizim apo kryerjen e analizave krahasimore me vitin paraardhës, duke mos u mjaftuar vetëm në evidenca sintetike statistikore.

Deri më datë 31.03.2024

3.5. Aneksë

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Përmirësim ligjor	1	-	1	100%	1	-	-	-
Masa organizative	11	1	10	91%	4	1	5	-
Masa shpërblim dëmi	8	5	3	38%	1	-	2	-
Masa disiplinore	1	-	1	100%	-	-	1	-
Totali	21	6	15	71%	6	1	8	0

Burimi i të dhënave DD Durrës, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

4. DEGA E DOGANËS TIRANË

4.1. Konkluzioni i auditimit

Në përfundim të auditimit të ushtruar në Degën Doganore Tiranë, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/14, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **Dega Doganore Tiranë, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje me raportimin e plan veprimit dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve në KLSH, nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën etyre.

Sa më sipër nga ana e Degës Doganore Tiranë, është dërguar shkresa nr. 9586/5 prot., datë 25.10.2023 mbi shqyrtimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna dhe Urdhrin nr. 13, datë 13.10.2023 për ngritjen e Grupit të Punës me këtë qëllim, brenda afatit 20 ditë nga marrja e RPA, ku është kërkuar shtyrja e afatit për kthimin e përgjigjes brenda 6 muajve. Subjekti i audituar ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30. Nga 18 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 17 rekomandime, ose 94% e tyre. Nga 17 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, ose 29% e tyre; janë në proces zbatimi 7 rekomandime, ose 41% e tyre; janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime ose 24% e tyre, si dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 11 rekomandime, janë pranuar 11; prej të cilave janë zbatuar plotësisht 3 prej tyre, janë zbatuar pjesërisht 4 dhe janë në proces zbatimi 4 rekomandime.
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi”, nga 6 rekomandime të lëna janë pranuar 5 rekomandime, ose 83 % e tyre. Nga 5 rekomandimet e pranuar janë zbatuar plotësisht 2

rekomandime ose 40 % e tyre; janë në proces zbatimi 2 rekomandime ose 40 % e tyre, dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim, ose 20 % e tyre;

- Masa disiplinore e rekomanduar nga KLSH, për 55 punonjës, është në proces zbatimi duke qenë se vendimmarrja lidhur me rastet e mësipërme i takon DPD. Konstatohet se nga ana e DD Tiranë janë marrë masat për njoftimin e DPD në cilësinë e organit kompetent për masat disiplinore në administratën doganore.

4.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/3, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/14 Prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Degën Doganore Tiranë”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 8, datë 30.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 8727/1 Prot., datë 30.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/29 prot., datë 10.11.2023.

Auditimi u krye nga:

- Xh. N.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 30.10.2023

4.3.Përshkrimi i auditimit

Veprimtaria e Degës Doganore Tiranë, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021, është audituar nga grupi i KLSH bazuar në Programin nr. 400/1 Prot., datë 13.04.2022 “Mbi përputhshmërinë dhe Rregullueshmërinë Financiare në Degën e Doganës Tiranë”. Raporti Përfundimtar i Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të Audituar me shkresën nr. 400/14 Prot., datë 07.10.2022, protokolluar në subjekt me nr. 9586 Prot., datë 10.10.2022, ku janë rekomanduar për zbatim 11 rekomandime “Masa organizative”; 6 rekomandime “Masa për shpërblym dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, 1 rekomandim “Masa disiplinore” për 55 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar ka dërguar shkresën nr. 9586/5 Prot., datë 25.10.2023 mbi shqyrtimin dhe analizimin e rekomandimeve të lëna dhe Urdhrin nr. 13, datë 13.10.2023 për ngritjen e Grupit të Punës me këtë qëllim, brenda afatit 20 ditë nga marrja e RPA, ku është kërkuar shtyrja e afatit për kthimin e përgjigjes brenda 6 muajve. Bashkëlidhur kësaj shkrese nuk është dërguar Plani i Veprimit i hartuar për

zbatimin e rekomandimeve, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.

- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*, subjekti i audituar ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 11 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të verifikojnë faturat e subjekteve në importin e artikullit membranë bituminoze të deklaruar në kapitullin 69 të nomenklaturës mallrave sipas praktikave doganore të vitit 2021 si dhe të kryejë veprime verifikuese pranë tyre për çmimet e këtij artikulli.

Nga auditimi ka rezultuar: Dega Doganore Tiranë ka ngritur Grupin e Punës përmes Urdhrit të Brendshëm nr. 13, datë 13.10.2022 (ndryshuar me Urdhrin nr. 2, datë 03.02.2023) “Për shqyrtimin/analizimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ky Grup Pune ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Departamentit Operativo Hetimor, Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, kërkesat për verifikim për Operatorët Ekonomikë:

1. “I.G.” SHPK me NIPT X;
2. “E. G.” SHPK me NIPT X;
3. “M.-E.” me NIPT X.

Statusi: Zbatuar plotësisht

1.2. Rekomandimi: Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Laboratorin Doganor të marrë masa të verifikojë dhe saktësojë, pozicionin tarifor në deklarimin e artikullit “prodhime të homogjenizuara me bazë pastë pule/gjeli (wurstel, wudi)” të subjektit “F.F.”, me NIPT-X.

Nga auditimi ka rezultuar: Me anë të shkresës nr. 11305 Prot., datë 01.12.2022, Dega Doganore Tiranë ka dërguar për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor (DOH) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), praktikën doganore R 6791, datë 29.01.2021 – 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; R 34174, datë 19.04.2021 – 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; R 66698, datë 4.07.2021 – 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; R 104234, datë 26.10.2021 – 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; R 124066, datë 17.12.2021 – 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, të cilat i përkasin importeve të kryera nga subjekti “F.F.” SHPK me NIPT-X, për artikullin “Wudy – produkt i homogjenizuar me bazë pule/gjel deti” klasifikuar në kodin tarifor 16023219. Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit pranë DOH ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 20979/1 prot., datë 15.12.2022, ku shpjegon se këto praktika kanë qenë objekt shqyrtimi dhe verifikimi nga ana e tyre. Nga verifikimi i kryer nga DOH i dokumentacionit shoqërues të praktikave doganore të subjektit “F.F.” me NIPT X ka rezultuar se deklarimi i artikullit “W. – produkt i

homogjenizuar me bazë pule/gjel deti” klasifikuar në kodin tarifar 16023219 është kryer në përputhje me deklaratën e eksportit dhe faturën tregtare bashkëngjitur DAV.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të mundësojë përditësimin e të dhënave të transportit me kontejner të mallrave sipas të dhënave në bursë apo çmimeve të deklaruara të transportit me kontejnerë të cilat janë të publikuara në çdo kohë në faqet zyrtare të kompanive ndërkombëtare të transportit.

Nga auditimi ka rezultuar: Nëpërmjet shkresës nr. 9586/2 prot., datë 24.10.2022, Dega Doganore Tiranë i ka kërkuar DPD (Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit, Drejtorisë së Politikave të Vlerësimit Doganor) rishikimin periodik të të dhënave të disponueshme në lidhje me shpenzimet e transportit me kontejner, duke theksuar se publikimi periodik i tyre çdo vit do të ndikonte pozitivisht në të ardhurat doganore si dhe do të minimizonte ankesat e Operatorëve Ekonomikë. Sa më sipër, rezulton që DD Tiranë ka marrë masa duke dërguar shkresën drejt DPD si organi kompetent për përditësimin e të dhënave të përmendura, megjithatë nuk disponohet dokumentacion lidhur me procedurën e ndjekur nga DPD, ndaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës së Doganës Tiranë në bashkëpunim me zyrën juridike dhe sektorin aposterior, të shqyrtojnë mangësitë në dokumentacionin e dosjeve dhe të marrë masa për plotësimin korrekt të formularit të rivlerësimit doganor, dokumentimit të njoftimit të përfaqësuesve ose operatorëve ekonomikë në afate dhe të kryejë arsyetimin e vendimeve.

Nga auditimi ka rezultuar: Përmes shkresës nr. 9586/8 prot., datë 17.03.2023, Kryetari i Degës Doganore Tiranë, u ka kërkuar Strukturave Kontaktuese të DD Tiranë të vlerësojnë maksimalisht zbatimin e këtij rekomandimi, me qëllim mbajtjen e një akti administrativ në vlerësim të kushteve dhe rrethanave të qarta dhe në zbatim të Ligjit.

Statusi: Në proces zbatimi

3.2. Rekomandimi: Strukturat konstatuese të shkeljeve doganore në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave dhe Degën e Doganës Tiranë në bashkëpunim të plotësojnë me korrektësi procesverbalet për verifikimin dhe konstatimin e shkeljes doganore.

Nga auditimi ka rezultuar: Përmes shkresës nr. 9586/7 prot., datë 16.03.2023, DD Tiranë ka njoftuar DPD dhe departamentet e saj mbi gjetjet e KLSH dhe rekomandimin e lënë lidhur me jo vetëm plotësimin korrekt të procesverbaleve, por dhe unifikimin e një qëndrimi lidhur me zbatimin e masave penalizuese/për zbatimin praktik për klasifikimin e shkeljeve dhe sanksioneve në fushën doganore/akcizës për rastet e konstatuara.

Statusi: Në proces zbatimi

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën e Doganës Tiranë dhe degët e tjera doganore të hartojë udhëzim për zbatimin praktik për klasifikimin e shkeljeve dhe sanksioneve doganore si dhe të unifikojnë qëndrimin në zbatimin e tyre pa cenuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar: Përmes shkresës nr. 9586/7 prot., datë 16.03.2023, DD Tiranë ka njoftuar DPD dhe departamentet e saj mbi gjetjet e KLSH, megjithatë nuk është vënë në dispozicion dokumentacion lidhur me marrjen e masave konkrete nga DPD për hartimin e udhëzimit për zbatimin praktik për klasifikimin e shkeljeve dhe sanksioneve doganore, ndaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës së Doganës Tiranë të marrë masa të administrohet dokumentacioni i plotë në dosjet e borxhit doganor dhe të ndiqen procedurat për mbledhjen me forcë të tij, si dhe të marrë informacione nga shoqëritë përmbarimore mbi procesin e mbledhjes me forcë të borxhit doganor e akcizës prej tyre.

Nga auditimi ka rezultuar: DD Tiranë me anë të shkresës nr. 10072 prot., datë 27.10.2022, ka kërkuar informacion nga shoqëritë përmbarimore lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të operatorëve debitor ndaj DD Tiranë, ku vetëm disa prej shoqërive përmbarimore i janë përgjigjur kësaj shkrese. Zyra e Borxhit Doganor ka ndjekur procedurat për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, referuar Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018 i DPD “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore të akcizës”. Deri në datën 30.09.2023 pranë DD Tiranë rezultojnë 1768 debitorë në vlerë 18,503,995,732 lekë, sipas tabelës nr. 1 të këtij Projekti Raporti.

Tabela nr. 4.1: Pasqyra e fazave dhe rasteve trajtuar nga Zyra e Borxhit Doganor

Nr.	Faza	Numër rastesh	Borxhi në total (në lekë)
1	Kryer procedurat e njoftimit të vendimit për shpalljen debitor	1768	18,503,995,732
2	Nxjerrë Urdhër Ekzekutimi nga Gjykata	455	4,160,074,973
3	Në proces gjyqësor	213	
4	Kryer procedurat për nxjerrjen e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, nga të cilat 112 raste me vlerë 268,094,054 lekë, janë dërguar pranë gjykatës për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit	753	522,585,414
5	Në proces për procedurat për nxjerrjen e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor (debitorë të krijuar rishtaz)	341	72,025,021
6	Akt Marrëveshje	6	6,484,800

Burimi: Dega Doganore Tiranë, përpunoi Grupi i auditimit

Përgjatë vitit 2022 dhe 2023, subjektet debitorë kanë shlyer përkatësisht 213,007,608 lekë dhe 131,670,111 lekë.

Statusi: Në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës së Doganës Tiranë në bashkëpunim me Sektorin e Borxhit dhe Sektorin e Financës të marrin masa për evidentimin e kamatëvonesave në regjistrin e borxhit për çdo subjekt dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

Nga auditimi ka rezultuar: Sa i takon përlllogaritjes së kamatave, nga DD Tiranë është realizuar përlllogaritja e kamatëvonesave për 20 subjekte debitorë në procese gjyqësore (llogaritur kamatat në Dhjetor të vitit 2021), ku kamata shtesë në total për subjektet është llogaritur 37,012,954 lekë. (Tabela anekse nr. 13)

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Degës së Doganës Tiranë, të marrë masa të zbatojë dhe respektojë të gjitha procedurat, për mallrat e sekuestruara dhe të konfiskuara.

Nga auditimi ka rezultuar: Sa i takon këtij rekomandimi, DD Tiranë në vijim të bashkëpunimit me Drejtorinë e Markave dhe Patentave në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (strukturë me të cilën realizohet dhe kryhet mbarëvajtja e mallrave të sekuestruara/bllokuara), për rastet e vitit 2021 ka marrë masa për njoftimin e mbajtësit të vendimit (përfaqësuesi ligjor/teknik i kompanisë për të cilën është vendosur mbrojtja e të drejtës së pronësisë intelektuale) të markave tregtare përkatëse lidhur me vendimin/et e shkatërrimit të mallrave cenuese dhe e ka ftuar mbajtësin e vendimit, për të kryer formalitetet pranë DD Tiranë. Deri tani, rezulton që kjo procedurë nuk është kryer pasi mbajtësi i vendimit nuk është paraqitur si dhe për më tepër nuk ka afate ligjore të përcaktuara për shkatërrimin e mallrave, duke qenë se kjo procedurë është në diskrecionin e mbajtësit të së drejtës për formalizimin e procedurave të përmendura. Në këto kushte, rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar: Nga ana e Degës së Doganës Tiranë përmes shkresës nr. 9586/3, datë 24.10.2023 është përcjellë për kompetencë dhe procedim të mëtejshëm Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Departamenteve të saj. Duke qenë se DPD është organi kompetent për zbatimin e këtij rekomandimi, konstatohet se nga ana e DD Tiranë janë marrë masa për njoftimin e DPD, megjithatë nuk rezulton që kjo e fundit të ketë iniciuar procedura lidhur me zbatimin e rekomandimit, ndaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

7.2. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të përgatisë dosje të rekomandimeve të shqyrtuara rast pas rasti me dokumentacionin argumentues, persona përgjegjës dhe vendimin e marrë si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të rishikojë profilin e riskut për të gjithë artikujt e kreut 0206 për ekzaminim fizik e laboratorik, si në rastin e vajrave lubrifikantë.

Nga auditimi ka rezultuar: Përmes shkresës nr. 9586/4 prot., datë 25.10.2023, DD Tiranë i është drejtuar DPD, Departamentit Operativo Hetimor, Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, lidhur me kërkesën për profilizim të riskut për artikujt e kreut 0206 sipas Formularit Tip. Ndërkohë, sa i takon përgatitjes së dosjeve të rekomandimeve të shqyrtuara me dokumentacionin argumentues, personat përgjegjës dhe vendimin e marrë, nga ana e DD Tiranë nuk është vendosur dokumentacion në dispozicion që vërteton marrjen e masave, ndaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 6 masa shpërblim dëmi për shumën 374,545 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të verifikojë, analizojë, shqyrtojë, saktësojë, dhe nxjerrë vendimet e arkëtojnë, të gjitha rastet e trajtuara nga Tabela nr. 1 deri në Tabelën nr. 47 në “A. Diferenca nga rivlerësimi i detyrimeve doganore” të detajuara në pjesën V. Anekse, për Pikën 2.2 të pjesës III. Përshkrimi i auditimit në Raport në vlerën 245,219,144 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, DD Tiranë ka marrë masa mbi verifikimin, analizimin dhe shqyrtimin e rasteve të trajtuara nga Tabela nr. 1 në Tabelën nr. 47 të Aneksit përkatës të RPA, ka rezultuar se:

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 1 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin “*çimçakiz*”, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 107,000 lekë, për shkak të rivlerësimit sipas çmimit referues, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 2 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin “*hurma arabie*”, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 2,362,500 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 3 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“konserva peshku”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,225,000 lekë ndërsa nga DD Tiranë ka rezultuar diferencë detyrimi vetëm për deklaratat R 96376, R 96377, viti 2021, që i përkasin importeve të Subjektit *“K.F.”*, me NIPT X, nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”*, diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është sipas shumave të specifikuara në aneksin e RPA, pra në vlerën 315,000 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 4 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“veshje këmbë me syprinë inkelidi dhe tekstili”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 472,000 lekë. Nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* dhe është llogaritur diferencë detyrimi po në këtë shumë, pra në vlerën 472,000 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 5 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“çizme e galloshe llastiku”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 5,189,500 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 6 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“doreza pune”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 997,500 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* ku shuma totale e detyrimit doganor shtesë është 785,359 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 7 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“këpucë pune”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,870,000 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* për deklaratat R 79294, R 5405, R 10465, R 45383, R 91275, ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është 157,980 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 8 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“lëndë të para plastike”* të klasifikuara në Kreun 3901, 3902, 3904 dhe 3907, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 3,995,106 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës është hartuar *“Formular Rivlerësimi”* vetëm për deklaratën R 16304, datë 16.02.2021, nga Subjekti *“G.”* ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është 290,473 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën 9 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“kapele tekstili”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,100,231 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* për 20 raste ku vlera totale e diferencës së detyrimit të llogaritur është 948,212 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 10 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“çimçakiz”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 63,854 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës është hartuar *“Formulari i Rivlerësimit”* për deklaratën R 13478, datë 12.02.2021, me importues Subjektin *“N.”*, NIPT X, ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është 40,604 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 11 të Aneksit 2.2 të RPA, për artikullin *“tyl, pëlhura të tjera”*, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 63,959 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* duke i vlerësuar mallrat sipas vlerës së indikatorit 600 lekë/kg-CIF, ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 47,441 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 12 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,163,154 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 1,190,985 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 13 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 15,137,976 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar *“Formularët e Rivlerësimit”* ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 19,776 lekë.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 14 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,791,773 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 21,191 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 15 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,508,646 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 49,604 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 16 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 3,675,896 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” për 13 raste ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 895,827 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 17 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,790,023 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” për 24 raste ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 548,626 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 18 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,421,486 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 19 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 7,260,337 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” për 4 raste ku diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 77,253 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 20 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 3,485,139 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 21 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 174,447 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” për deklaratat R 49426, R R 49711 dhe R 79012, viti 2021, duke i vlerësuar mallrat sipas vlerës së indikatorit 600 lekë/kg-CIF, diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është në shumën 103,934 lekë.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 22 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,279,532 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 23 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 542,351 lekë, ndërsa nga DD Tiranë është përlllogaritur detyrim shtesë 445,229.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 24 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 100,990 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 25 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,515,587 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 26 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 102,297 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.
- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 27 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 12,579,594 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit”, diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur për 15 deklarata është në shumën 650,327 lekë. Për deklaratat e evidentuara që i përkasin importeve

të Subjektit “B.B.F. C.”, nga Grupi i Punës u hartuan “Formularët e Rivlerësimit” për praktikatat doganore të pasqyruara në Tabelën 27 të RPA, duke e rivlerësuar mallin sipas çmimit alternativ 0.33 euro/litër, diferenca e detyrimit është në shumën 187,176 lekë.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 28 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,990,933 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 29 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 925,101 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 30 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 2,465,199 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” për deklaratat R-60331, R-115311, R-10668, R-14545, R-63875, R-87974, R-48331, R-65221, R-114281, R-129199, viti 2021, nga Subjekti “S-A-SHPK” me NIPT X, me diferencë të detyrimit doganor të rillogaritur sipas çmimit alternativ 0.5 euro/kg - FOB në vlerën totale 217,066 lekë; për deklaratat R-59940, R-119494, R-85929, viti 2021, që i përkasin importeve të Subjektit “S. SHPK”, NIPT X, diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur në vlerën totale 199,329 lekë; për deklaratat R-127643, R-46072, R-59196, viti 2021, që i përkasin importeve të Subjektit “M.C.2014” me NIPT X, R-4611, datë 22.01.2021, me deklarues “E.C. GROUP” me NIPT X, si edhe R-55225, datë 15.06.2021, me deklarues “A.TECH.” me NIPT X, diferenca e detyrimit doganor të rillogaritur është gjithsej 146,979 lekë.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 31 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 8,580,145 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” ku janë përlllogaritur diferenca të detyrimit në vlerën gjithsej 512,052 lekë.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 32 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 15,528,571 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 33 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 2,471,697 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 34 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 7,497,436 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 35 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,655,810 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 36 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 5,504,718 lekë, ndërsa nga DD Tiranë ka qenë i pamundur shqyrtimi për shkak të mungesës së referencës DAV në tabelë.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 37 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 8,231,899 lekë, ndërsa nga DD Tiranë pretendohet se është ndërhyrë me vendimmarrje në 24 raste, në ato praktika doganore vlera e të cilave është nën vlerën 0.4 euro/kg, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rillogaritur; në këto kushte është e pamundur të përlllogaritet detyrimi i llogaritur nga DD Tiranë.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 38 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,763,682 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklaratave.

- Për praktikatat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 39 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 10,058,155 lekë, ndërsa nga DD Tiranë

pretendohet se është ndërhyrë me vendimmarrje në 7 raste, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rilogaritur; në këto kushte është e pamundur të përlllogaritet detyrimi i llogaritur nga DD Tiranë.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 40 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,776,513 lekë, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklarave.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 41 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 130,777,780 lekë, ndërsa nga DD Tiranë janë dërguar shkresa për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor lidhur me deklaratat përkatëse, të cilat janë në proces shqyrtimi.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 42 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,464,568 lekë (detyrim doganor shtesë në vlerën 2,232,234 lekë dhe propozohet penalitet sa një fish i diferencës), ndërsa nga Grupi i Punës për deklaratat R 370, R 345, R 122121, R 57942, R 100725, R 108170, R 34616, R 87332, diferencat e detyrimit të ri llogaritura janë 121,123 lekë dhe për shkeljen administrative të konstatuar, u vendos penalitet sa një fish i detyrimit të papaguar.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 43 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 17,856,716 lekë nga të cilat 8,928,358 lekë detyrim doganor dhe shuma 8,928,358 lekë sanksion, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklarave.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 44 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 6,224,617 lekë dhe propozohet penalitet sa një fish i diferencës, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklarave.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 45 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 8,849,896 lekë dhe propozohet penalitet sa një fish i diferencës, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklarave..

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 46 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 4,449,251 lekë. Për praktikat doganore që i përkasin importit të artikullit “*aditivë të ndryshëm*” të klasifikuar në Kreun 3811, DD Tiranë ka kërkuar interpretim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe në varësi të konfirmimit pretendon se *do të rishikohen* detyrimet doganore shtesë të ri llogaritura për pagesën e akcizës së artikullit. Për deklaratat doganore me importues Subjektin “T.- O.” dhe “A.M.C.”, për diferencën e akcizës së produktit të klasifikuar në kodin tarifor 3403 19 80, Grupi i Punës ka mbajtur procesverbalet e kundërvajtjes administrative, diferencat e detyrimit të ri llogaritura janë 1,801,464 dhe 22,455 lekë sipas shumave të evidentuara në RPA dhe për shkeljen administrative të konstatuar, është vendosur penalitet sa një fish i detyrimit të papaguar.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 47 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 1,666,488 lekë, ndërsa nga Grupi i Punës janë hartuar “Formularët e Rivlerësimit” ku janë përlllogaritur diferenca të detyrimit në vlerën gjithsej 302,474 lekë.

- Për praktikat doganore të evidentuara në Tabelën nr. 48 të Aneksit 2.2 të RPA, nga KLSH është llogaritur detyrim doganor shtesë në vlerën 65,335,000 lekë dhe propozohet penalitet sa një fish i diferencës, ndërsa nga DD Tiranë nuk ka rezultuar diferencë detyrimi pas verifikimit të deklarave.

Në Tabelën nr. 2 të këtij Projekt Raporti janë paraqitur detyrimet shtesë doganore të përlllogaritura nga grupi i auditimit të KLSH dhe nga DD Tiranë, ku specifikohet dhe vendimi

i marrë nga DD Tiranë pas verifikimit për përlogaritjen e detyrimit. Në total, nga DD Tiranë janë rillogaritur detyrime shtesë në vlerën 12,515,681 lekë.

Tabela nr. 3: Detyrime doganore të përlogaritura nga KLSH dhe nga DD Tiranë

Në lekë

Sipas RPA	Detyrim doganor shtesë sipas KLSH	Detyrim shtesë i përlogaritur nga DD Tiranë	Diferenca DD Tiranë - KLSH
Tabela 1	107 000	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(107 000)
Tabela 2	2 362 500	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(2 362 500)
Tabela 3	1 225 000	315 000	(910 000)
Tabela 4	472 000	472 000	-
Tabela 5	5 189 500	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(5 189 500)
Tabela 6	997 500	785 359	(212 141)
Tabela 7	1 870 000	157 980	(1 712 020)
Tabela 8	3 995 106	290 473	(3 704 633)
Tabela 9	1 100 231	948 212	(152 019)
Tabela 10	63 854	40 604	(23 250)
Tabela 11	63 959	47 441	(16 518)
Tabela 12	4 163 154	1 190 985	(2 972 169)
Tabela 13	15 137 976	19 776	(15 118 200)
Tabela 14	1 791 773	21 191	(1 770 582)
Tabela 15	1 508 646	49 604	(1 459 042)
Tabela 16	3 675 896	895 827	(2 780 069)
Tabela 17	4 790 023	548 626	(4 241 397)
Tabela 18	4 421 486	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(4 421 486)
Tabela 19	7 260 337	77 253	(7 183 084)
Tabela 20	3 485 139	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(3 485 139)
Tabela 21	171 447	103 934	(67 513)
Tabela 22	4 279 532	445 929	(3 851 603)
Tabela 23	542 351	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(542 351)
Tabela 24	100 990	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(100 990)
Tabela 25	1 515 587	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 515 587)
Tabela 26	102 927	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(102 927)
Tabela 27	12 579 594	837 503	(11 742 091)
Tabela 28	1 990 933	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 990 933)
Tabela 29	925 101	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(925 101)
Tabela 30	2 465 199	563 374	(1 901 825)
Tabela 31	8 580 145	512 052	(8 068 093)
Tabela 32	15 528 571	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(15 528 571)
Tabela 33	2 471 697	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(2 471 697)
Tabela 34	7 497 436	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(7 497 436)
Tabela 35	1 655 810	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 655 810)
Tabela 36	5 504 718	I pamundur shqyrtimi nga ana e DD Tiranë	(5 504 718)
Tabela 37	8 231 899	Vendimmarrje në 24 raste, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rillogaritur	(8 231 899)
Tabela 38	1 763 682	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 763 682)
Tabela 39	10 058 155	Vendimmarrje në 7 raste, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rillogaritur	(10 058 155)
Tabela 40	1 776 513	I pamundur shqyrtimi nga ana e DD Tiranë	(1 776 513)
Tabela 41	30 777 780	Dërguar deklaratat për verifikim pranë DOH	(30 777 780)
Tabela 42	4 464 568* ¹	242 246*	(4 222 322)
Tabela 43	17 856 716*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(17 856 716)
Tabela 44	12 449 234*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(12 449 234)
Tabela 45	17 699 792*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(17 699 792)
Tabela 46	8 899 092*	3 647 838*	(5 251 254)
Tabela 47	1 666 488	302 474	(1 364 014)
Tabela 48	126 670 000	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(126 670 000)
Totali	371 750 037	12 515 681	(359 391 356)

Burimi: Dega Doganore Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit

Statusi: Në proces zbatimi

¹ Shënim: * - Përlogaritje ku është përfshirë detyrimi doganor shtesë së bashku me penalitetin sa njëfishi i këtij detyrimi.

1.2. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të saktësojë, të analizojë dhe të nxjerrë vendimet e arkëtojnë detyrimet doganore shtesë për:

- praktikat doganore R-47141, 25.05.2021 dhe R 35122, 21.04.2021 të subjektit “B.” në vlerën 178,000 lekë dhe 372,500 lekë;

- praktikat doganore R-69638, datë 21.07.2021 të subjektit “XH. & B.” në vlerën 202,000 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: DD Tiranë ka marrë masat për verifikimin e deklaratave R-47141, 25.05.2021 dhe R-35122, 21.04.2021 të subjektit “B.” nga ku ka dalë në përfundimin “*Transaksion, dokumente shtesë, deklaratë eksporti, shtëft, vlera e deklaruar e njëjtë me subjekte të tjera nga i njëjti vend origjine*”, duke mos kontabilizuar dhe arkëtuar detyrim doganor.

Në rastin e verifikimit të deklaratës R-69638, datë 21.07.2021 të subjektit “XH.& B.”, DD Tiranë ka dalë me Vendimin nr. 893, datë 31.1.2023 se sipas rivlerësimit të deklaratës doganore subjekti duhet të paguajë detyrim doganor shtesë prej 202,000 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të marrë masat për operatorët ekonomikë që disponojnë autorizime të magazinave doganore të dorëzojnë e inventarët e gjendjes kontabël të artikujve të importuar periodikisht si dhe nxjerrë vendimet e arkëtojnë, gjobat për operatorët përkatësisht në Tabelën nr. 1 të detajuar në pjesën V. Aneks, për Pikën 2.3 të pjesës III. Përshkrimi i auditimit në Raport në shumën 680,000 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: Lidhur me këtë rekomandim, nga DD Tiranë janë shqyrtuar dosjet përkatëse ku sipas qëndrimit të subjektit, inventarët janë pjesë e dosjes dhe ndaj nuk ka konkluduar në vendime mbi arkëtimin e gjobave.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.2. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë, të shqyrtojë rastet e evidentuara, kur malli në regjimin e përpunimit aktiv nuk i është dhënë destinacioni konform afateve të përcaktuara në autorizim; kur është riekportuar një sasi malli më tepër se ajo e lejuar në autorizim; kur janë kryer deklarime të mallrave të natyrës “Mallra dhe Mbetje” në vlera të ulëta për artikullin “mbetje metali”, “Letër/dalje nga RPA”, “produkt dytësor prej druri” dhe “mbetje alumini” krahasuar këto me çmimet e bursës të publikuara të artikullit “skrap” për artikullin “mbetje metali” dhe çmimeve alternative të pranuar; përkatësisht nga Tabela nr. 2 në Tabelën nr. 4 të detajuar në pjesën V. Aneks, për Pikën 2.3 të pjesës III. Përshkrimi i auditimit në Raport në shumën totale 116,150,932 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: DD Tiranë ka shqyrtuar rastet e tabelave nr. 3 dhe 4 të Aneksit të RPA dhe aplikuar penaltete për 20 subjekte mbajtës të autorizimeve të RPA, në totalin prej 24,666,184 lekë, pasqyruar dhe në tabelat nr. 4 dhe 5 të këtij Projekt Raporti.

Tabela nr. 4: Penaltete të aplikuara lidhur me mallra në regjimin e përpunimit aktiv

Në lekë

Subjekti	NIPT	Autorizim	Gjendje Malli (kg) pa riekportuar dhe tejkalim të afateve autorizuese	Vlera	Detyrimi	Gjoba
A. C.	1	20190611/12088/2	0	0	0	50,000
E. I.	2	20190916/18742/1	48,985	3,057,475	611,495	611,495
E.-M.	3	20190620/13522/1	330	951,755	190,351	190,351
EX.	4	20190517/12056/1	145	1096	31,784	31,784
G. 2019	5	20190207/2758/1	101	39,275	7,855	7,855
G.2019	6	20220212/368/1	-	-	-	-
G. GROUP	7	20190207/2546/1	17,279	37,098,090	7,419,618	7,419,618
L. F.	8	20200720/11276/1	12,466	6,162,005	1,232,401	1,232,401
P. E.	9	20200128/246/1	9,339	8,250,225	1,650,045	1,650,045

R.S.	10	20191125/28595/1	76	123,36	24,672	24,672
S.	11	20190503/10265/1	2222	137	60,883	60,883
S.-F.	12	20190703/16660/1	28843	2.365.945	627,995	627,995
T-C	13	20191002/24419/1	1463	964	282,066	282,066
T. T.	14	20190605/12825/1	1858	31	18,952	18,952
				Shuma	12,158,067	12,208,117

Burimi: Dega Doganore Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela nr. 5: Penalitete të aplikuara lidhur me mallra në regjimin e përpunimit aktiv

Në lekë					
Nr.	Subjekti	NIPT	Autorizim	Exportuar me tepër/sasi/kg	Gjoha
1	D. T.	1	20200625/10929/1	-320	50,000
2	F. MARS 19	2	20190415/8999/1	-237	50,000
3	L.P. E.	3	20191002/22577/1	-578	50,000
4	M.-K.	4	20190426/10161/1	-248	50,000
5	S.	5	20190717/17651/1	-2948	50,000
6	T. & F.	6	20200504/5364/1	-271	50,000
				TOTAL	300,000

Burimi: Dega Doganore Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit

Ndërsa për subjektet e tjera ku nuk janë aplikuar penaltitetet sipas tabelave të Aneksit të RPA, DD Tiranë ka kryer analiza/verifikime lidhur me secilin prej subjekteve:

- Subjekti “Al. Sh.” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190301/4131/1, sipas KLSH në tabelën nr. 3, ka gjendje një sasi 4.031 kg të pa eksportuar, ndërsa në tabelën nr. 4 për të njëjtin regjim citohet se: “ka 6,076 kg dhe nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se sasia 4,031 kg është transferuar me deklaratën R-26611, date 23.04.2020, në regjimin pasues 20200303/3771/2 dhe gjendja rezulton zero”.

- Subjekti “A. T3” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20191028/26241/ 2, sipas KLSH ka gjendje një sasi 1,112 kg të pa eksportuar, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se kjo sasi është transferuar me deklaratën R-37816, datë 19.04.2022, në regjimin 20211025/5100/1.

- Subjekti “Al.Al.” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190104/30228/1, sipas KLSH ka gjendje një sasi negative 6,355 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se subjekti ka mallra shqiptarë 24,904 kg si dhe ka transferuar me deklaratën R-9898, datë 07.02.2019, R-39307, datë 07.05.2019 dhe R-96824, datë 05.11.2019, në regjimin 20181107/24856/1 të mbajtur nga subjekti “M.D.S” SHPK me NIPT X dhe gjendjen e ka zero.

- Subjekti “D. T.” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190605/13049/1, sipas KLSH ka gjendje një sasi 60 kg të pa eksportuar, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8 nr. 5748 prot., datë 28.06.2021 me gjendje zero.

- Subjekti “A.C.” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190611/12088/ 2, sipas KLSH ka gjendje një sasi 48,185 kg të pa eksportuar. Subjekti ka paraqitur observacion pranë DD Tiranë lidhur me problemet që ka patur me klientët dhe me pamundësinë për të eksportuar mallrat brenda afatit të përcaktuar në regjim. Lidhur me këtë, DD Tiranë ka penalizuar subjektin në shumën 50.000 lekë sipas Vendimit nr. 54 prot., datë 24.01.2023, si dhe subjekti u dha destinacion mallrave me Import 4, me R-6301, datë 25.01.2023, R-6305, datë 25.01.2023, R-6307, datë 25.01.2023 dhe R-6308, datë 25.01.2023, duke paguar të gjitha detyrimet doganore dhe duke mbyllur regjimin me Aneksin nr. 8.

- Subjekti “T. F.” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190221/3102/1, sipas KLSH ka gjendje një sasi negative - 666 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr. 16842 prot., datë 30.12.2019, me gjendje zero.

- Subjekti “D & D” SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190711/17137/1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative 8,182 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr. 7112/1 Prot., datë 27.07.2022 me gjendje zero.

- Subjekti "I." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20191213/29848/1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative 260 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, Nr. 5740 prot., datë 28.06.2021 me gjendje zero.
- Subjekti "T.A.K." SHPK, me X, për regjimin 20201124/ 12090/1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative -555 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr.9985/1 prot., datë 24.10.2022, me gjendje zero.
- Subjekti "G." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20200330/10460/1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative 11,017 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar një diferencë në sasinë 3,983 kg, e cila është transferuar me R-34990, datë 20.04.2021 në regjimin pasues 20210323/22801/1, ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr. 5566 prot., datë 21.06.2021, me gjendje zero.
- Subjekti "B & F C." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190104/30413/ 1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative 16,373 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr. 8883 prot., datë 30.09.2020, me gjendje zero.
- Subjekti "A. K." SHPK, me NIPT ., për regjimin 20201013/11861/1, sipas KLSH ka gjendje një sasi negative - 340 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me gjendje zero.
- Subjekti "KM." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20190628/16037/2, sipas KLSH ka gjendje sasi negative – 20,977 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr. 10132 prot., datë 28.10.2020, me gjendje zero.
- Subjekti "C. S." SHPK, me NIPT X, për regjimin me procedurë të thjeshtuar 20210208/1169, sipas KLSH ka gjendje sasi 7,740 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se është importuar një kamion i përdorur për riparim me R-10608, date 10.02.2021 dhe ky kamion i riparuar është eksportuar me R-31252, datë 09.04.2021, ndaj ky regjim ka gjendje zero.
- Subjekti "M. 7" SHPK, me X, për regjimin 20190603/12933/1, sipas KLSH ka gjendje sasi 52,837 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se kjo sasi është transferuar me R-6731, date 31.01.2020, në regjimin 20191003/24391/1, të mbajtur nga subjekti "A. K." SHPK me NIPT X.
- Subjekti "A. K." SHPK me NIPT X, për regjimin 20201013/11861/1, sipas KLSH ka gjendje negative sasinë 340 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është mbyllur me aneks 8, nr.3206 prot., datë 04.04.2022, me gjendje zero.
- Subjekti "L. S." SHPK me NIPT X, për regjimin 20200424/10603/1, sipas KLSH ka gjendje sasi negative 350 kg, ndërsa nga verifikimi i kryer nga DD Tiranë ka rezultuar se ky regjim është me gjendje zero.

Nga verifikimet e DD Tiranë në sistem ka rezultuar se subjektet "A." SHPK, me NIPT X, me regjim 20190306/4820/1, "E." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210716/2663/1, "K.K." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210602/23279/1, "L. C." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210525/23244/1, mbikëqyren nga DD Durrës; ndërsa subjekti "G. E." SHPK, me NIPT X, me regjim 20210423/23041/1 dhe 20200427/10598/1, mbikëqyret nga Dega Doganore Kakavijë.

Nga verifikimet e DD Tiranë ka rezultuar se subjektet në vijim kanë ende mallra në përpunim dhe regjimet janë ende aktive: "U.T." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210722/2766/1, "P.P." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210302/22590/1, "N." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20210708/2194/1, "N.D A." SHPK, me NIPT X, për regjimin 20211013/4675/1.

Statusi: Në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të marrë masat për operatorët ekonomikë artikujt e të cilëve trajtohen me ligjin e akcizës, të kalibrojnë enët mbajtëse të tyre, (depozitat, siloset), pajisin ato me Certifikatat e Kalibrimit si dhe nxjerrë vendimet e arkëtojnë, gjobat për operatorët

përkatësisht nga Tabela nr. 1 në Tabelën nr. 3 të *detajuara në pjesën V. Anekse, për Pikën 2.4 të pjesës III. Përshkrimi i auditimit* në Raport në shumën totale 4,891,020 lekë.

Nga auditimi ka rezultuar: Referuar shkresës së DPD nr. 23617/3 prot., datë 04.11.2014, ku specifikisht pika 2 citon se “brenda një periudhë sa më të shkurtër të plotësojnë detyrimin ligjor që pajisjet dhe depozitat që ata disponojnë të jenë të kalibruara të paktën një për tip”, DD Tiranë ka kryer njoftime periodike për këtë çështje për periudhën Tetor 2012 e në vazhdim, duke ju kërkuar depozituesve plotësimin e detyrimit ligjor të sipërcituar. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DD Tiranë sa u takon këtyre operatorëve, rezulton se pjesa më e madhe e tyre e kanë plotësuar kushtin e mësipërm. Gjithashtu nga DD Tiranë lidhur me këtë çështje pretendohet se subjektet e akcizës janë penalizuar vitin paraardhës.

Megjithatë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa për nxjerrjen e vendimeve dhe arkëtimin e gjobave të operatorëve të cituar në rekomandim në vlerën 4,891,020 lekë ndaj rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për shqyrtimin, analizimin dhe ndryshimin e 74 vendimeve me shkelje procedurale, për rivlerësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e sanksioneve të përshkruara në Tabelën nr. 1 e *detajuar në pjesën V. Anekse, për Pikën 2.5 të pjesës III. Përshkrimi i auditimit* në Raport në shumën totale 6,851,874 lekë.

Statusi: Pa pranuar

4. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar masa disiplinore për 55 punonjës, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të shkeljeve të konsideruara nga ana Jonë, sipas pikës 1 shkronja a dhe b të nenit 57 të Ligjit Nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave disiplinore për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58 të Ligjit, shkronjat b, c dhe ç të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil datë 30.05.2013”, konkretisht:

I. Nga niveli i masës nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit me detyra funksionale pranë Sektorit të Vlerës në Qendër (SVQ) dhe Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit (5 Ditor) (SKAO) në DDD për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021 si më poshtë:

- 1- Z. I.R, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 2- Znj S.D, me detyrë përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 3-Z. K.B, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SVQ-se.
- 4-Z. J.C, me detyrë përgjegjës i sektorit të kontrollit dokumentar pranë SKAO-se
- 5- Znj. K.S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 6- Znj. K.X, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 7- Znj. G.G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 8- Z. L.X, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 9- Z. J.S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.

- 10- Z. B.D, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 11- Z. R.M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 12- Z. A.H, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 13- Znj. M.H , me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 14- Znj. A.B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 15- Znj E.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 16- Z. I.Ç, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 17- Znj. B.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 18- Znj.R.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 19- Z. R.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 20- Z. S.S, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 21- Z. R.Z, me detyrë ish doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 22- Znj. E.G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 23- Znj. L.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 24- Z. E.N, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 25- Znj. L.G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 26- Z. O.H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 27- Znj.E.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 28- Znj.A.M , me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 29- Znj.J.T, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 30- Znj.E.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 31- Znj. K.H , me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 32- Znj.E.X, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 33- Z. A.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 34- Z. D.H, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 35- Znj T.S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 36- Z. I.M, me detyrë ishdoganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 37- Z. R.M me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 38- Z. E.M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ.
- 39-Znj. K.A, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 40- z. E.G, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 41-z. A.V, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.
- 42- Znj. E.T, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SKAO.

II. Nga niveli i masës nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, për punonjësit me detyra funksionale pranë Sektorit të Vlerës në Qendër (SVQ) në DDD për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021 si më poshtë:

- 1-Z.A.S, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 2-Z.A.V, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 3-Znj.O.V, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 4-Z. S.T, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 5-Z.H.M, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 6-Z.J.C, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 7-Z.M.K, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 8-Z.A.B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 9-z. R.B, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 10-Z. N.Y, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 11-Z. E.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 12-Z. A.N, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ
- 13-Z. A.D, me detyrë doganier i klasifikim/vlerësim në SVQ

Nga auditimi ka rezultuar: DD Tiranë, përmes shkresës nr. 9586/3 i ka përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm, materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH. Duke qenë se vendimmarrja lidhur me rastet e mësipërme i takon DPD, konstatohet se nga ana e DD Tiranë janë marrë masat për njoftimin e DPD në cilësinë e organit kompetent për masat disiplinore në administratën doganore, si dhe nuk ka informacion nëse DPD ka dalë në vendimmarrje, ndaj rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Statusi: Në proces zbatimi

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 886/28, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

4.4.Rekomandime

Për sa më sipër, ri kërkojmë:

4.1. Rekomandim: Kryetari i Degës Doganore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përshejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 66-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të mundësojë përditësimin e të dhënave të transportit me kontejner të mallrave sipas të dhënave në bursë apo çmimeve të deklaruar të transportit me kontejnerë të cilat janë të publikuara në çdo kohë në faqet zyrtare të kompanive ndërkombëtare të transportit.

Deri më datë 31.03.2024

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën e Doganës Tiranë dhe degët e tjera doganore të hartojë udhëzim për zbatimin praktik për klasifikimin e shkeljeve dhe sanksioneve doganore si dhe të unifikojnë qëndrimin në zbatimin e tyre pa cenuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Deri më datë 31.03.2024

7.2. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të përgatisë dosje të rekomandimeve të shqyrtuara rast pas rasti me dokumentacionin argumentues, persona përgjegjës dhe vendimin e marrë si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të rishikojë profilin e riskut

për të gjithë artikujt e kreut 0206 për ekzaminim fizik e laboratorik, si në rastin e vajrave lubrifikantë.

Deri më datë 31.03.2024

Masa shpërblim dëmi ekonomik, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit:

3.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të marrë masat për operatorët ekonomikë artikujt e të cilëve trajtohen me ligjin e akcizës, të kalibrojnë enët mbajtëse të tyre, (depozitat, siloset), pajisin ato me Certifikatat e Kalibrimin si dhe nxjerrë vendimet e arkëtojnë, gjobat për operatorët përkatësisht nga Tabela nr. 1 në Tabelën nr. 3 të detajuara në pjesën V. Aneksë, për Pikën 2.4 të pjesës III “Përshkrimi i auditimit” në Raport në shumën totale 4,891 mijë lekë.

Deri më datë 31.03.2024

4.5. Aneksë

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	11	-	11	100	3	4	4	-
Masa shpërblim dëmi	6	1	5	83	2	-	2	1
Masa disiplinore	1	-	1	100	-	-	1	-
Totali	18	1	17	94	5	4	7	1

Burimi i të dhënave DD Tiranë, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

5. SHOQËRIA “A.” SHA

5.1. Konkluzioni i auditimit

Në përfundim të auditimit të ushtruar në Shoqërinë “A.” SHA, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/13, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **Shoqëria “A.” SHA, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje me statusin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre. Nga Shoqëria “A.” SHA, nuk është përcjellë në KLSH raportimi mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30. Nga auditimi ka rezultuar nivel i lartë i pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve. Nuk është pranuar vetëm një rekomandim, për të cilin janë dhënë argumente ligjore nga subjekti. Nga Shoqëria “A.” SHA, pavarësisht mos raportimit në KLSH, mbi ecurinë zbatimit të rekomandimeve përgjithësisht ishin marrë masat e duhura për zbatimin e tyre. Tre rekomandimet me status “Zbatuar pjesërisht”, rezultojnë të tilla për shkak të mosveprimit nga ana e Këshillit Administrativ të Shoqërisë “A.” SHA.

Nga “A.” SHA janë pranuar 35 rekomandime nga 34 të lëna për zbatim, ose 97 % e tyre. Nga 34 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 25 rekomandime ose 74 % e tyre, janë në proces zbatimi 6 rekomandime ose 17 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime ose 9 % e tyre.

- Rekomandimet “Masa organizative” janë lënë 28, janë pranuar 27, ose 96.4 % e tyre. Nga rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 22 rekomandime, ose 81 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, ose 8 % e tyre, si dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime, ose 11 %.
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi”, janë lënë për zbatim 3 rekomandime, janë pranuar në masën 100 %, si dhe rezultojnë proces zbatimi 3 rekomandime, ose 100 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa për përdorimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike (3-E)”, janë lënë 3 rekomandime dhe janë pranuar 3, ose 100 % e tyre. Nga 3 rekomandimet e pranuar, 2 rekomandime, ose 67 % e tyre janë realizuar plotësisht dhe 1 rekomandim ose 37 % e tyre është realizuar pjesërisht.
- Masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, është dhënë 1 masë, për 6 punonjës të “A.” SHA, janë zbatuar në masën 100 %.

5.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/7, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.886/13 prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Shoqërinë “Agrokredit” SHA, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, në përfundim të të cilit u mbajt Akt konstatimi nr. 4, datë 26.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 3433/4, datë 27.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/26 prot., datë 10.11.2023.

Auditimi u krye nga:

- B. Z.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 27.10.2023.

5.3. Përshkrimi i auditimit

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 1259/11 prot., datë 23.06.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Shoqërinë “Agrokredit” SHA, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2019-31.10.2021, protokolluar në subjekt me nr. 5171/17 prot., datë 07.06.2022, janë rekomanduar për zbatim 28 rekomandime “Masa organizative”; 3 rekomandime “Masa për shpërblim dëmi”, 3 rekomandime “Masa përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike”, si dhe masa disiplinore lënë në kompetencë të titullarit për 6 punonjës.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”, subjekti i audituar me shkresën nr. 5117/18 prot., datë 28.07.2022 ka hartuar Plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuar me Urdhrin nr. 13, protokolluar me nr. 5171/19, datë 28.07.2022, dhe ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 5171/20, datë 28.07.2022, me 10 ditë vonesë nga marrja e RPA;
- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”, **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Administratori i “Agrokredit” SHA, z. E. B..

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 28 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës (KM) të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesën e hartimit të planit të veprimit dhe të raportimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, si dhe të marra të gjitha masat nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të papranuara, të pazbatuara apo të zbatuara pjesërisht.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit “Agrokredit” SHA, duhet të paraqiste në KM, Raportin dhe rekomandimet e KLSH-së, për shqyrtim. Nga ana e KM të “Agrokredit” SHA nuk është shqyrtuar dhe analizuar zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH i paraqitur nga Administratori i “AK” SHA me e-mail e datës 02.08.2022 (bashkëngjitur Raporti dhe rekomandimet e KLSH-së), ku i është kërkuar KM të caktojë dhe njoftojë për mbledhjen e tij me qëllim diskutimin e Raportit të KLSH dhe planit të veprimit të hartuar nga shoqëria për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Gjithashtu nuk është shqyrtuar dhe analizuar nxjerrja e përgjegjësive për mos dërgim në KLSH të Plan veprimit dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të nenit 15 dhe 30 të Ligjit nr. 154 të vitit 2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” e evidentuar edhe në auditimin e radhës, pasi nuk është dërguar në KLSH, informacion mbi nivelin dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

Rekomandimi 2.1. Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të analizuar rregullisht në vijimësi treguesit e shoqërisë mbi baza tremujore dhe vjetore, referuar dhe treguesve financiare të shoqërisë, të miratojë në afat programet ekonomike, të analizojë largimet nga puna, me vlerë të shpenzimeve gjyqësore në shumën totale 7,382,788 lekë, duke nxjerrë përgjegjësit konkrete dhe shmangien në të ardhmen të efekteve financiare negative për buxhetin e shoqërisë, të marrë në analizë raportet e KLSH dhe të dalë me vendimmarrjen

përkatëse, të shmangë marrjen e vendime qarkulluese për çështje të rëndësishme, të marrë masa të bëjë analizë të thelluar mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të huave mbi të cilin gjenerohet portofoli i huave për klientët, duke dalë në masa konkrete për përmirësimin e sistemit dhe eliminimin e risqeve në të ardhmen.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit “Agrokredit” SHA, duhet të paraqiste në mbledhjen më të afërt të KM, materialet mbi treguesit ekonomiko-financiarë. Nga ana e KM të “AK” SHA, nuk janë miratuar treguesit ekonomiko financiarë të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, si dhe miratimi i Pasqyrave financiare, pasi nuk janë miratuar dhe certifikuar ende nga auditi ligjor. Nga “AK” SHA, është paraqitur në KA për shqyrtim treguesit financiarë më bazë 8 mujore.

Në lidhje me analizimin e treguesve ekonomiko financiarë nga Administratori me e-mail e datës 15.12.2022 ishin paraqitur KM për shqyrtim dhe miratim dokumentet e mëposhtme, por nga ana e tij nuk janë shqyrtuar pasi nuk është mbledhur në lidhje me këtë çështje.

- Raportim për sulmin kibernetik dhe rikuperimi prej tij;
- Raportim për situatën financiare të 8 mujorit;
- Raportim për sistemin IMPRO;
- Miratim i ndryshimeve në kartën dhe produktet e shoqërisë;
- Miratim i materialeve të auditit të brendshëm, etj..

Sa më sipër, rezulton se nga ana e “AK” SHA ky rekomandim është zbatuar, ndërsa nga KM nuk është zbatuar.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

Rekomandimi 3.1. Administratori i shoqërisë “Agrokredit” SHA, të marrë masa të menjëhershme për implementimin e një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm me të pesë komponentët kryesorë dhe rishikimin e akteve të brendshme rregullative në funksion të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimit financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të hartojë analizat tremujore për realizimin e treguesve ekonomikë të shoqërisë dhe analizat 6 mujore për kreditë jashtë bilancit, të përgatisë e paraqesë në kohë programet ekonomike të shoqërisë, raportin mbi rezultatin financiar dhe raportin e ekspertëve kontabël, për miratim si nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Aksionari, raportin mbi rezultatin financiar dhe raportin e ekspertëve kontabël, konform kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli III, pika 6.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit “Agrokredit” SHA, të gjitha departamentet duhet të paraqisnin raportime dhe analiza mbi treguesit ekonomiko financiarë dhe risqet. Nga ana e Administratorit të AK ishin shqyrtuar analizat për realizim objektivash dhe vlerësim risqesh. Konkretisht gjatë vitit 2023 ishin kryer analiza të treguesve nga Departamenti i Përputhshmërisë dhe Riskut. Konkretisht, nga Njësia e rikuperimit dhe Njësia Collection ishte dërguar Raport performance për periudhën 6 mujori i dytë 2022 dhe 3 mujori parë 2023; Departamenti i Raportimit dhe Përputhshmërisë ka paraqitur analizë për 6 mujorin, 9 mujorin e viti 2023; Analizë risku e dosjeve në përmbardim plan veprimi dhe objektiva për vitin 2023.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 4.1. Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me Departamentin Risk & Collection dhe Këshillin Mbikëqyrës të marrë masa për krijimin e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe krijimin e një sistemi të brendshëm për administrimin e rrezikut operacional, si dhe nga ana e Administratorit, e Departamentit Risk & Collection, Drejtuesve të Degëve dhe Oficerëve të kredisë të merren masa që kreditë e aprovuara të jenë brenda misionit themelor të shoqërisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit Departamenti i Risk Collection dhe Rikuperimit duhet të hartojë Rregulloren për menaxhimin e risqeve. Ky departament ishte duke hartuar “Draft Rregulloren për menaxhimin e risqeve”, e cila ishte ende në proces. Sipas raportimit të subjektit do të paraqitetet në mbledhjen e radhës se KM për miratim.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 5.1. Departamenti i financës të marrë masa që për kreditë e lëvruara deri në shumën e kredive që përkufizohen si mikrokredi, të krijojë fondin rezervë për mbulimin e humbjeve, sipas kriterëve dhe normave të përcaktuara në institucionet financiare të mikrokredisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit Departamenti i Financës dhe Departamenti i Risk & Collection, duhet të marrin masa për krijimin e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve. Nga “Agrokredit” SHA është argumentuar se: *“Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë për institucionet Financiare jo banke ato kanë përcaktuar normat që duhen aplikuar për çdo institucion duke na dhënë formularët e plotësimit të përcaktuara për “Agrokredit” SHA. Për këtë arsye është bërë korrigjimi nga jashtë në Pasqyrat Financiare të Vitit ushtrimor duke llogaritur nga jashtë provigjionet sipas IFRS 9 duke parashikuar çdo humbje Financiare të kredive duke filluar nga viti 2019-2022. Këto rezerva janë shumë më të larta, do të aplikohen çdo vit dhe përfshijnë të gjithë portofolin e kredive në deklaratimet tatimore.*

Me vendimin e KM nr. 12, datë 11.04.2022 “Manuali operacional” ishin miratuar normat për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë referuar në Rregulloren nr. 2, datë 17.01.2013 të Bankës së Shqipërisë për institucionet financiare të mikro kredisë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 6.1. Departamenti i Risk & Collection në bashkëpunim me Departamentin e financës të marrë masa që përveç klasifikimit të kredisë, për kategoritë e kredisë nën standarde, e dyshimtë dhe e humbur të cilësojë dhe përqindjen e normës së fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit Departamenti i Financës dhe Departamenti i Risk & Collection, duhet të marrin masa për caktimin e normës. Departamenti i Financës raporton se ka aplikuar përqindjen e normës së fondit rezervë bazuar në vendimin e KM nr. 12, datë 11.04.2022 “Manuali operacional”, ku ishin miratuar normat për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë nën standard, të dyshimta dhe të humbura, ku në klasifikim përveç ditë vonesave do të merrej në konsideratë dhe aftësia paguese e klientit, referuar kjo dhe në Rregulloren nr. 2, datë 17.01.2013 të Bankës së Shqipërisë për institucionet financiare të mikro kredisë. Përsa ju përket ndryshimit të normave të provigjionit do të implementohen nga subjekti i audituar është argumentuar se me sistemin e ri të menaxhimit të kredive, do të aplikohen bazuar në normat e matricës së IFRS-9.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 7.1. Administratori, Këshilli Mbikëqyrës dhe Departamenti i Financës të marrë masa që të hartojnë dhe miratojnë procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi dhe që të jenë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Plan veprimit Departamenti i Shitjes dhe Operacioneve, Departamenti i Financës dhe Departamenti Ligjor, duhet të zbatojnë rekomandimin e mësipërm.

Sipas informacionit të dhënë nga subjekti, Shoqëria “AK” SHA në vitin 2019 ka nënshkruar kontratën për rivlerësimin e AMSH sipas vendimit të Asamblesë së Aksionerit, por aktualisht organet drejtuese nuk kanë miratuar raportin e rivlerësimit. Nga ana e KM në mbledhjen e datës 28.07.2023 sipas Procesverbalit me nr. Prot., 2280, datë 28.07.2023, është diskutuar në lidhje me provigjionet, ku nga Kryetari i KM është cilësuar se: *“Aktualisht është ngritur një strukturë e posaçme ku do të transferohen për shitje të gjitha pronat”*. Deri në zgjidhjen e kësaj situate për transferimin e pronave, fondet për provigjionet do të impaktojnë rezultatin financiar.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 8.1. Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për përditësimin e dokumentit “Manuali i Administrimit të Burimeve Njerëzore”, dhe përgatitjen e një raporti vlerësimi të brendshëm për evidentimin e shkaqeve të detajuara të cilat kanë shkaktuar vakancat në strukturë. Në vijim të përgatitet një plan masash për plotësimin e vendeve vakante në të ardhmen ku të përcaktohen detyra dhe afate konkrete. Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të marrin masa që për çdo rekrutim, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë të dokumentohet e plotë e gjithë procedura e ndjekur që nga shpallja e vendit të lirë të punës deri në përzgjedhjen e kandidatëve për punësim. Gjithashtu, Departamenti i Burimeve Njerëzore të marrë masa për të plotësuar me dokumentacion dosjet individuale të punonjësve sipas përcaktimeve të manualit të drejtimit të burimeve njerëzore si dhe që listë prezencë e oficerëve të kredisë të dokumentohet nga përgjegjësit e zyrave përkatëse rajonale në bazë ditore dhe të raportohen tek drejtori rajonal çdo ditë, i cili duhet ti paraqesë ato pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga subjekti na është vënë në dispozicion Manuali i Administrimit të Burimeve Njerëzore i përditësuar dhe miratuar me Vendimin nr. 3, datë 28.02.2022.

Për sa i përket plotësimit të vendeve vakante nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, ishin marrë masa për plotësimin e vakancave nëpërmjet njoftimeve në rrjete sociale, portale punësimi dhe APP, por përgjithësisht ka rezultuar se ka mungesë interesi e pasqyruar kjo dhe në vakancat aktuale në “AK” SHA.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar se, dosjet individuale të punonjësve janë plotësuar me dokumentacion sipas përcaktimeve të bëra paraprakisht në manual, si dhe nga këqyrja me zgjedhje të listë prezencave ka rezultuar se janë dokumentuar në fillim muaji nga përgjegjësit e degëve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 9.1. Titullari i autoriteti kontraktor, “Agrokredit” SHA të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë llogaritjen e fondit limit bazuar në dokumentacionin justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, si dhe informacione të tjera nga burime alternative, kontrata të ngjashme të realizuara në institucione të tjera, eksperte apo autoritete kompetente të pavarura. Për llogaritjen e fondit limit të ngarkohet një grup/komision i posaçëm apo një specialist i fushës, me qëllimin hartimin e fondit limit në përputhje me nevojat reale për punë, shërbime dhe mallra.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga ana e “AK” SHA, ishin marrë masa për argumentimin e përcaktimit të fondit limit në procedurat e ndjekura në vijimësi. Konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti ka rezultuar se për llogaritjen e fondit limit në prokurimin “Shërbim Printimi”, viti 2022 referuar proces verbalit nr.3662/2 prot., datë 27.09.2022, ku janë pasqyruar nevojat për këtë shërbim sipas të gjitha degëve, si dhe janë

dhënë argumentet duke ju referuar specifikimeve dhe kriterëve të kualifikimit, si dhe rregullave të prokurimit publik, bazuar në VKM nr. 285/2021.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 10.1. Titullari i autoriteti kontraktor, “Agrokredit” SHA, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit, të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “AK” SHA, ishin marrë masa në procedurat e ndjekura në vijimësi për argumentimin teknik dhe hartimin e specifikimeve teknike si dhe për kriteret e kualifikimit. Konkretisht në procedurat e prokurimit: “Blerje karburanti”, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike janë paraqitur në Proces verbalin Nr. 3573/5 datë 13.09.2022; “Shërbimi i printimit”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike ishin paraqitur në Proces verbalin nr.3662/2 prot., datë 27.09.2022; “Blerje materiale IT”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike ishin paraqitur në procesverbalin nr.3666/7 prot., datë 26.09.2022, duke reflektuar rekomandimin e lënë nga KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 11.1. Për prokurimet publike llogaritja e fondit limit dhe nevojave të bëhet bazuar në të dhëna të dokumentuara dhe analiza, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “AK” SHA, ishin marrë masa në procedurat e ndjekura në vijimësi për llogaritjen e fondit limit dhe nevojave të bëhet bazuar në të dhëna të dokumentuara dhe analiza, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike. Konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në procedurën e prokurimit: “Blerje karburanti”, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike, ishin paraqitur në Proces verbalin nr. 3573/5 datë 13.09.2022, duke reflektuar rekomandimin e dhënë nga KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 12.1. Titullari i autoriteti kontraktor, “Agrokredit” SHA, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit, të kualifikojë dhe shpallë fitues vetëm ata operatorët ekonomik që plotësojnë të gjitha kriteret për kualifikim, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Sipas informacionit të dhënë nga subjekti, janë marrë masa që në procedurat e ndjekura në vijimësi, të reflektohet mbi rekomandimin e dhënë nga KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 13.1. Titullari i autoriteti kontraktor, “Agrokredit” SHA të marrë masa në vijimësi në organizimin e procedurave të prokurimit, në fazën e ndjekjes dhe zbatimit të kontratës si dhe marrjen në dorëzim, të respektojë kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në DST dhe kërkesat ligjore, me qëllim furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara, si dhe të caktohet të paktën një specialist i fushës në grupet e punës gjatë

fazave të kryerjes së procedurave të prokurimit dhe në përputhje me objektin e kontratës gjatë zbatimit të saj.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “AK” SHA ishin marrë masa për plotësimin e dokumentacionit sipas rekomandimeve të lëna në procedurat e ndjekura në vijimësi. Konkretisht Administratori i “AK” SHA ka nxjerrë:

Urdhri nr. 3299/10 prot., datë 06.10.2023 “Për monitorimin dhe zbatimin e kontratës me objekt “Shërbim prinitimi”, ku ka ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri dhe grupin e punës të përbërë me 3 anëtarë;

Urdhri nr. 152/7 prot., datë 23.01.2023 “Për monitorimin dhe zbatimin e kontratës me objekt “Blerje ujë i pijshëm”, ku ka ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri një specialist;

Urdhri nr. 4121/2 prot., datë 21.10.2022 “Për monitorimin dhe zbatimin e kontratës me objekt “Marrja e shërbimit GPS për automjetet e Agrokredit SHA”, ku ka ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri një specialist, etj..

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 14.1. Administratori i shoqërisë dhe zyrtari përgjegjës për prokurimet, të marrin masa që dokumentacioni i hartuar nga grupet e punës të ngritur me urdhra të posaçëm gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi të konsiderohet i vlefshëm vetëm në rast se ai më parë është protokolluar pranë zyrës së protokoll-arkivit të shoqërisë në përputhje me legjislacionin përkatës mbi arkivat.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Sipas dokumentacionit të mbajtur nga grupet e punës në lidhje me procedurat e prokurimit publik ka rezultuar se grupet e punës të ngritur me urdhra të posaçëm gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi procedurat ne vijim ishin protokolluar pranë zyrës së protokoll-arkivit të shoqërisë në përputhje me legjislacionin përkatës mbi arkivat, sipas informacionit të vënë në dispozicion me shkresën nr. 3433/2, datë 23.10.2023 të Personit Përgjegjës për prokurimet dhe Drejtorit të Departamentit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 15.1. Nga personi përgjegjës për prokurimet, të merren masa që dokumentacioni i hartuar nga grupet e punës të ngritur me urdhra të posaçëm gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi të konsiderohet i vlefshëm vetëm në rast se grupet e punës kanë nënshkruar më parë deklaratën e konfliktit të interesit, sikurse përcakton legjislacioni në fuqi që rregullon prokurimet publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Për procedurat e prokurimit ne vijimësi ishin nënshkruar më parë deklarata e konfliktit të interesit, sikurse përcakton legjislacioni si dhe duke reflektuar mbi rekomandimin e dhënë nga KLSH. Konkretisht si shembull, në procedurën e prokurimit sipas urdhrit të prokurimit nr. 3666/5 prot., datë 23.09.2022, kishin plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit të gjithë anëtarët e komisioneve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 16.1. Zyrtari përgjegjës për prokurimet dhe të gjithë punonjësit që mund të ngarkohen për të qenë pjesë e njësisë së prokurimit për procedurat e prokurimit publik të llojit “Kërkesë për propozim”, të merren masa që në çdo rast të dokumentohet argumentimi dhe arsyetimi i përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që ftohen për paraqitjen e propozimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Referuar informacionit të paraqitur nga subjekti, rekomandimi është pranuar dhe do të zbatohet në vijimësi. Pas rekomandimit të dhënë nga KLSH, nuk është kryer asnjë procedurë kërkesë për propozim, por do të konsiderohet në procedurat që do të zhvillohen në vijimësi. Referuar regjistrimit të prokurimeve të vënë në dispozicion nga subjekti gjatë vitit 2023 janë parashikuar vetëm 3 procedura blerje e vogël dhe 9 procedura nën 100,000 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 17.1. Administratori i shoqërisë të marrë që në të ardhmen për të gjithë kontratat që do të lidhen me palë të treta nga shoqëria, grupet e punës që do të ngrihen për marrjen në dorëzim apo për ndjekjen e zbatimit të kontratave të përcaktohen me emër të përveçëm të gjithë anëtarët e grupit të punës. Gjithashtu, grupet e punës që do të ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të kontratave që lidhen me implementim ose konfigurime të sistemeve IT të dokumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjithë elementët teknikë dhe mënyrat apo skemat e komunikimit dhe lidhjes së pajisjeve. Një kopje e këtij dokumentimi ti bashkëlidhet dosjes së prokurimit dhe një kopje të dorëzohet në zyrën e protokoll-arkivit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga AK në vitin 2022-2023 janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi, si dhe kanë dalë urdhrat nga Titullari për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave. Urdhri nr. 3299/10, datë 06.10.2023; Urdhri nr. 152/7, datë 23.01.2023; Urdhri nr. 4121/2, datë 21.10.2022; Urdhri nr. 3256/2, datë 22.09.2023; Urdhri nr. 4145/24, datë 13.12.2022 dhe Urdhër nr. 3704/19, datë 12.12.2022.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 18.1. Nga “Agrokredit” SHA të merren masa që ana e grupeve të punës që do të ngrihen në të ardhmen për përcaktimin e specifikimeve teknike apo hartimin e kriterëve të vlerësimit për procedura të prokurimit që lidhen me konfigurime apo mirëmbajtje të sistemeve IT, të merren masa për minimizimin e rasteve kur shërbimi i kërkuar të parashikohet për t’u kryer nga OE në distancë. Në ato raste kur kjo metodë e ofrimit të shërbimit mund të jetë e pamshangshme ose sjell kursim të fondeve për shoqërinë, të merren masa që të përcaktohet dhe dokumentohet një procedurë e detajuar për mënyrën dhe rrjedhën logjike të punës se si do të ofrohet ky shërbim nga kontraktuesi dhe si do të monitorohet nga autoriteti kontraktor me qëllim minimizimin e riskut të sigurisë së informacionit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Departamenti IT, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “AK” SHA në vitin 2022-2023 ishin marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi, si dhe kanë dalë urdhrat nga Titullari për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave. Konkretisht:

- “Shërbimi i printimit”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike janë paraqitur në Proces verbalin nr.3662/2 prot., datë 27.09.2022;
- “Blerje materiale IT”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike janë paraqitur në procesverbalin nr.3666/7 prot., datë 26.09.2022, duke reflektuar rekomandimin e lënë nga KLSH, etj..

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 19.1. Administratori i shoqërisë dhe grupet e punës për përcaktimin e specifikimeve teknike, në hartimin e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit që

lidhen me mallra dhe shërbime IT të paraqesin të gjithë elementet që ndikojnë në paraqitjen e kushteve që mundësojnë operatorët ekonomikë në paraqitjen e ofertave sa më objektive dhe të mbajnë në konsideratë të veçantë garantimin e sigurisë së informacionit. Nga administratori i shoqërisë të merren masa për analizimin e situatës dhe të kërkohet nga grupet e punës argumentim teknik dhe ligjor mbi arsyet e vlerësimit që kanë bërë komisionet e vlerësimit të ofertave sipas procedurave përkatëse. -Administratori i shoqërisë, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të përbërë nga specialistë IT për analizimin e situatës. Grupi i punës të konkludojë analizimin me një raport të detajuar për situatën dhe të përcaktojë nëse e veprimet e përshkruara më sipër kanë sjellë rritje të fondit duke dëmtuar buxhetin e shoqërisë, për procedurën e prokurimit “Implementimi i software core banking për nevoja të Agrokredit SHA”, viti 2021. Nëse grupi i punës konkludon se mënyra e llogaritjes së fondit limit ka sjellë fryrje të tij duke dëmtuar kështu buxhetin e shoqërisë, administratori i shoqërisë të marrë të gjithë masat administrative dhe disiplinore që parashikon kuadri rregullator dhe ligjor në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Sipas informacionit të marrë në subjekt ishin marrë masa që në procedurat e ndjekura në vijimësi, të zbatohet rekomandimi i lënë nga KLSH. Konkretisht është reflektuar rekomandimi i KLSH në:

- “Blerje karburanti”, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike ishin paraqitur në Proces verbalin nr. 3573/5 date 13.09.2022;
- “Shërbimi i printimit”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike ishin paraqitur në Proces verbalin nr. 3662/2 prot., datë 27.09.2022;
- “Blerje materiale IT”, viti 2022, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike ishin paraqitur në Proces verbalin nr. 3666/7 prot., datë 26.09.2022, duke reflektuar rekomandimin e lënë nga KLSH, etj.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 20.1. Administratori i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen, grupet e shqyrtimit të ankesave të mundshme në procedurat e prokurimit të jenë gjithmonë të përbëra nga 3 punonjës, ku të paktën njëri të jetë specialist i fushës, nisur nga fakti që shoqëria ka në strukturë personel të mjaftueshëm për shumicën e fushave në të cilat shoqëria realizon procedura prokurimi.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “AK” SHA, në lidhje me këtë rekomandim është arsyetuar se është zbatuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 101, pika 1 ku cilësohet: *“Titullari i AK me urdhër të veçantë cakton një person ose ngre një komision me të paktën 3 persona për shqyrtimin e ankesës”*

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 21.1. Nga grupet e punës që do të ngrihen në të ardhmen për shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimin e ofertave, të mbahet parasysh parimi i ekonomicitetit me qëllim kursimin e fondeve të shoqërisë për ato raste kur është e mundur për devijime që mund të konsiderohen të vogla, pa cenuar barazinë, transparencën, objektivitetin dhe vërtetësinë në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Plan veprimi është specifikuar se për procedurat që do të zhvillohen në të ardhmen do të orientohen

grupet e punës për të patur në konsideratë gjatë shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ofertave, rekomandimin e dhënë nga KLSH.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 22.1. Administratori i shoqërisë të marrë masa për analizimin e situatës dhe të sigurojë që Urdhrat e Prokurimit për procedurat që zhvillon shoqëria të mos ngrihen asnjëherë për procedura me objekt të njëjtë me procedura që shoqëria ka në proces prokurimi apo që ka lidhur kontrata.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga “Agrokredit” SHA gjatë 6 muajve të vitit 2022 dhe në vazhdimësi nuk ka patur raste të copëzimit të fondeve për mallra dhe grup mallra të njëjtë, kjo referuar regjistrin të prokurimeve të vitit 2023 të vënë në dispozicion nga subjekti.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 23.1. Drejtori i Financës i “Agrokredit” SHA, të marrë masat e duhura që, të bashkëlidhë ndaj çdo urdhër-transferte dokumentacionin shoqërues (listë-pagesën dhe urdhër transfertën) me qëllim justifikimin e shpenzimit dhe garantimin e gjurmës së auditit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Financës do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti rezulton se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Përmbledhëse;
- Listë prezencë;
- Bordero ku është plotësuar sipas elementëve përbërës të pagës;
- Deklarata tatime e listë pagesës se kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale të “Agrokredit” SHA.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 24.1. Asambleja e ortakëve, Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, Administratori i Shoqërisë, Drejtori i Financës, të marrin masat e duhura që, shqyrtimi, miratimi, auditimi dhe dorëzimi në organet përkatëse të pasqyrave financiare të kryhet brenda afateve të përcaktuara, me qëllim njohjen e situatës financiare në kohë nga përdoruesit e tyre dhe shmangien e pasojave financiare ndaj buxhetit të shoqërisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Financës do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori i “Agrokredit” SHA ishte lidhur kontrata me Audituesit ligjorë nr. 441/1, datë 07.04.2023 për Auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2022. Në nenin 4 të saj cilësohet se: “Në kushtet normale të punës afati i realizimit të kësaj kontrate do të jetë 2 muaj nga data e dorëzimit të PF”. Aktualisht nuk është dorëzuar raporti i audituesve ligjorë. Nga Departamenti i Financës Pasqyrat financiare janë dorëzuar në sipas e-malit të datës 12.09.2023, si dhe duke marrë në konsideratë afatin e përcaktuar në kontratë dorëzimi i raportit të audituesit ligjor është 12.11.2023.

Në lidhje me mbylljen e llogarive vjetore të vitit 2022, kanë rezultuar vonesa, nga Departamenti i Financës, të cilat sipas argumentimit të dhënë nga subjekti janë shkak i implementimit të sistemit të ri, i cili ka sjellë vonesa në migrimin e të dhënave si dhe të futjes së moduleve të reja. Sa më sipër, ende nuk kanë kaluar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës “Pasqyrat financiare të vitit 2022” dhe Raporti i Audituesit ligjor “Mbi pasqyrat financiare të “Agrokredit” SHA për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022”.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 25.1. Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura që, në hartimin e kontratave me Audituesit ligjorë (AL), të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e kontraktorit, me qëllim marrjen në kohë të informacionit mbi Raportimin Financiar dhe dërgimin brenda afateve në Asamblenë e Ortakëve, të parashikohen penalitetet për vonesat.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit Departamenti i Financës do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori i “Agrokredit” SHA është lidhur Kontrata nr. 441/1, datë 0704.2023 Mbi Auditimin e Pasqyrave financiare të shoqërisë dhe përgatitjen e Raportit nga ana e tyre, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare Raportimit Financiar (SNRF). Në nenin 4 është përcaktuar afati i AL për dorëzimin e Raportit të auditimit, si dhe në Aneksin III të kontratës janë përcaktuar: “Përgjegjësia e Auditimit” dhe “Përgjegjësia e Menaxhimit”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 26.1. Drejtori i Financës, të hartojë dhe përpilojë formatin e shënimeve shpjeguese për Pasqyrat Financiare, me qëllim dhënien e sqarimeve përkatëse ndaj përdoruesve për analizën dhe krahasimin e të dhënave sipas periudhave kontabël.

Nga auditimi ka rezultuar: Sipas Planit të veprimit, Departamenti i Financës do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Departamenti i Financës nuk është pranuar gjetja dhe rekomandimi i mësipërm, me argumentimin e mëposhtëm:

Shënimet shpjeguese janë kryer në bazë të ligjit nr 25/2018 për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Neni 161. Shënimet shpjeguese, si rregull, paraqiten sipas renditjes me të cilën janë paraqitur zërat në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës...Referuar SNK 1:..Për të vlerësuar në se një mungesë apo anomali mund të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, si rrjedhim të jetë materiale, kërkon të merren parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve. Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e PF parashikon në paragrafin 252 se “Përdoruesit supozohet se kanë njohje të arsyeshme të veprimtarisë ekonomike dhe biznesit dhe të kontabilitetit dhe një dëshirë për të studiuar informacionin me kujdesin e duhur. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të marrë parasysh se si përdoruesit me attribute të tilla mund të pritët që të ndikohen në marrjen e vendimeve ekonomike.Shënimet shpjeguese përmbajnë informacion shtesë krahasuar me atë të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar...Shënimet shpjeguese japin përshkrime narrative ose shpërndarje të zerave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacion mbi zërat të cilat nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra. ...Shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese...Pasqyrat dhe shënimet shpjeguese të paraqitura për vitet 2019,2020 janë kryer në përputhje të plotë sipas Ligjit nr 25/2018 dhe Standarteve Ndërkombëtare për përpilimin e tyre.Pasqyrat e shoqërisë kanë informacion krahasues për sa kohë që ka dy vite radhazi të paraqitura në to.

Statusi: Pa pranuar

Rekomandimi 27.1. Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë në regjistrimin dhe verifikimin e aseteve, si dhe Administratori i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, Departamenti i Financës, të marrë masat e duhura që të kryejë procesin e hartimit të regjistrimit të të gjithë aktiveve, duke plotësuar të gjitha kërkesat sipas formatit të aprovuar, si dhe të kryejë një proces verifikimi dhe vlerësimi për të gjithë aktivet e Shoqërisë, në sasi dhe në vlerë, me qëllim evidentimin e aseteve të saj dhe evidentimin e vlerës së drejtë në pasqyrat financiare.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti i Financës dhe Departamenti i Shitjeve dhe Operacioneve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori ishin marrë masat për administrimin e aseteve. Ishte ngritur Urdhri nr. 28, datë 16.12.2022 nr. 4794 prot., datë 16.12.2022 “Për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2022” si dhe janë përcaktuar komisionet përkatëse të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi të AM-ve, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 28.1. Departamenti i Financës, duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi. Anëtarët të cilët marrin pjesë në procesin e inventarizimit, të kryejnë me përgjegjshmëri detyrën e ngarkuar deri në nënshkrimin e plotë të fletëve të inventarit. Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, të marrë masat e duhura në vijimësi për procesin e inventarizimit ku, përbërja e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të jetë i ndryshëm me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Gjithashtu në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin rregullator ligjor. Të hartojë gjurmën standarde të Auditit, me qëllim, ndjekjen dhe dokumentimin e aktiveve gjatë proceseve të inventarizimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti i Financës dhe Departamenti i Shitjeve dhe Operacioneve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori ishin marrë masat për administrimin e aseteve. Ishte ngritur Urdhri nr. 28, datë 16.12.2022 nr. 4794 prot., datë 16.12.2022 “Për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2022” si dhe janë përcaktuar komisionet përkatëse të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi të AM-ve, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime. Gjithashtu është mbajtur Regjistri i AM, si dhe i pronave të marra në dorëzim, ku ishin përcaktuar të dhëna mbi marrjen në pronësi; të dhëna mbi lirim dorëzimin; të dhëna nga kontabiliteti; të dhëna mbi provigjionet, mbi shitjet etj..

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi, për shumën 367 mijë lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

Rekomandimi 1.1. Nga Administratori i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën 35,313 lekë pa TVSH nga OE fitues “G. C.” SHPK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti Ligjor, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori i AK SHA, ka dalë shkresa “Kërkesë për shpërblim dëmi”, drejtuar subjektit G. C. SHPK, me nr. 1441 prot., datë 12.05.2023, por nuk është vijuar me ndërmarrjen veprimeve të mëtejshme.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 2.1. Nga Administratori i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën 79,849 lekë pa TVSH nga OE fitues, BOE “U.R.” SHPK & “F.R.”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti Ligjor, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori i AK SHA, ka dalë shkresa “Kërkesë për shpërblim dëmi”, drejtuar subjektit

“U. R.” SHPK, me nr. 1444 prot., datë 15.05.2023, por nuk është vijuar me ndërmarrjen veprimeve të mëtejshme.

Statusi: Në proces zbatimi

Rekomandimi 3.1. Nga administratori i shoqërisë “Agrokredit” SHA të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, dhe arkëtimin në vlerën 251,990 lekë pa TVSH nga kontraktori “C.P.” SHPK, por nuk është vijuar me ndërmarrjen veprimeve të mëtejshme.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti Ligjor, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga Administratori i AK SHA, ka dalë shkresa “Kërkesë për shpërblim dëmi”, drejtuar subjektit C. P. SHPK, me nr. 1440 prot., datë 12.05.2023.

Statusi: Në proces zbatimi

4. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 3 masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

Rekomandimi 1.1. Titullari i autoriteti kontraktor, Agrokredit SHA të marrë masa në vijimësi në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë hartimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve publike në të ardhmen.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti i Financës do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, rezulton se nga Titullari i AK, ishin marrë masa për zbatimin e rekomandimit në procedurat e ndjekura në vijimësi për llogaritjen e fondit limit, psh. në prokurimin “Shërbim Printimi”, viti 2022 referuar proces verbalit nr.3662/2 prot datë 27.09.2022, përllogaritja e fondit limit ishte kryer nga komisioni me tre anëtarë, nga të cilët 2 specialistë të fushës së IT. Komisioni kishte vendosur që për përcaktimin e fondit limit t’ju drejtohet 3 OE të cilët kanë objekt veprimtarie objektin e prokurimit, bazuar në nenin 80 të VKM nr. 285/2021 “Për procedurat e prokurimit publik”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 2.1. Administratori i shoqërisë të marrë masa nxjerrjen e përgjegjëseve përkatëse dhe arsyet e mos-arritjes së objektivit për të trajnuar oficerët e kredisë. Gjithashtu të marrë masa që të analizojë situatën, dhe në rast se gjykohet se materialet e përfituara nga institucioni përmes kësaj procedure janë ende të vlefshme për zhvillimin e kapacitetit profesional të oficerëve të kredisë, të caktojë një grup pune i cili të realizojë procesin e përcjelljes së materialeve të trajnimeve për oficerët e kredisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Departamenti i Shitjeve dhe Operacioneve, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Nga AK ishin marrë masa për kryerjen e trajnimeve të oficerëve të kredisë, kështu në vitin 2023 ishte planifikuar sipas shkresës nr. 2284 prot., datë 28.07.2023, kryerja e trajnimeve për Departamentin e Shitjeve dhe Operacioneve, në periudhat shtator dhe nëntor 2023, në lidhje me Hyrje në “Agrokredit”; Traget grupi; Karta e produkteve; Manualët

dhe Teknikat e shitjes. Sipas ndarjes në grupe në shtator 2023 ishin trajnuar 27 oficerë kredie përfaqësues të 27 degëve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Rekomandimi 3.1. Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë situatën e krijuar si rezultat i largimeve të paligjshme nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, dhe në bashkëpunim me Administratorin e Shoqërisë, Drejtorinë e Burimeve njerëzore, të marrin masa për shmangien e pasojave financiare ndaj buxhetit të Shoqërisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas Planit të veprimit, Administratori dhe KM, do të zbatojë rekomandimin e mësipërm. Administratori i “Agrokredit” SHA, i ka paraqitur KA me emalin e datës 02.08.2022, për shqyrtim dhe analizim Raportin dhe rekomandimet e lëna nga KLSH. Është evidentuar se KA nuk është mbledhur dhe nuk ka diskutuar në asnjë mbledhje mbi rezultatet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH, për rrjedhojë dhe për rekomandimin e mësipërm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

5. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i mëparshëm është rekomanduar marrja e masave disiplinore për 6 punonjës, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë:

Rekomandimi nr. 1. Mbështetur në nenin 154, pika c të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në VKM nr. 570, datë 3.10.2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” dhe të Statutit të “Agrokredit” SHA, neni 13, i rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës, të analizojë mangësitë dhe shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe në raport me to të japë masa disiplinore ndaj administratorit të shoqërisë.

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë” miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 13.03.2017, ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 31.07.2017, neni 25 dhe neni 31, pika 8, si dhe në “Kontratat Individuale të Punës”, i rekomandojmë Administratorit të shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga: “Paralajmërim për ulje në detyrë” deri në “Pushim nga puna”, në raport me shkeljet e kryera dhe efektet e shkaktuara për shoqërinë, ndaj punonjësve, shkeljet e të cilëve janë konstatuar më tepër se në dy raste, konkretisht:

1. Z. A.Gj., në cilësinë anëtarit të Njesisë së Prokurimit e hartimit të kritereve të kualifikimit dhe KVO-së;
2. Z. G. R., në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
3. Zj. I.K., në cilësinë e anëtarit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
4. Zj. I. H., në cilësinë e anëtarit të KVO-së dhe Komisionit për marrjen në dorëzim të mallit;
5. Z. E. B., në cilësinë anëtarit të Njesisë së Prokurimit e hartimit të kritereve të kualifikimit dhe Komisionit për marrjen në dorëzim të mallit;
6. Z. A. P., me detyrë Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i “Agrokredit” SHA, ka nxjerrë Urdhrin nr. 5171/21, datë 04.08.2022 “Për dhënie mase disiplinore” për punonjësit e cilësuar në rekomandimin e mësipërm. Sipas këtij urdhri nga Administratori i “AK” SHA është dhënë masa disiplinore “Paralajmërim me shkrim”, për 6 punonjësit e mësipërm.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 886/26, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

5.4. Rekomandime

Për sa më sipër ri kërkojmë:

1. Rekomandim: Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, të marrin masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

1.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës (KM) të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesën e hartimit të planit të veprimit dhe të raportimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, si dhe të marra të gjitha masat nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të papranuara, të pazbatuara apo të zbatuara pjesërisht..

Deri më datë 31.03.2024.

2.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të analizuar rregullisht në vijimësi treguesit e shoqërisë mbi baza tremujore dhe vjetore, referuar dhe treguesve financiare të shoqërisë, të miratojë në afat programet ekonomike, të analizojë largimet nga puna, me vlerë të shpenzimeve gjyqësore në shumën totale 7,382,788 lekë, duke nxjerrë përgjegjësit konkrete dhe shmangien në të ardhmen të efekteve financiare negative për buxhetin e shoqërisë, të marrë në analizë raportet e KLSH dhe të dalë me vendimmarrjen përkatëse, të shmangë marrjen e vendime qarkulluese për çështje të rëndësishme, të marrë masa të bëjë analizë të thelluar mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të huave mbi të cilin gjenerohet portofoli i huave për klientët, duke dalë në masa konkrete për përmirësimin e sistemit dhe eliminimin e risqeve në të ardhmen.

Deri më datë 31.03.2024.

Masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve:

Rekomandimi 3.1. Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë situatën e krijuar si rezultat i largimeve të paligjshme nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, dhe në bashkëpunim me Administratorin e Shoqërisë, Drejtorinë e Burimeve njerëzore, të marrin masa për shmangien e pasojave financiare ndaj buxhetit të Shoqërisë.

Deri më datë 31.03.2024

5.5. Aneke:

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	28	1	27	96.4	22	2	3	-
Masa shpërblim dëmi	3	-	3	100	-	-	3	-
Masa 3-E	3	-	3	100	2	1	-	-
Masa disiplinore 6 punonjës	1	-	1	100	1	-	-	-
Totali	35	1	34	97	25	3	6	-

Burimi i të dhënave Agrokredit SHA, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

6. AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT (AMLF)

6.1. Konkluzioni i auditimit:

Në përfundim të auditimit të ushtruar në AMLF, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/12, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **AMLF përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje me statusin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre. Nga AMLF, nuk janë përcjellë në KLSH dy raportimet, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15 dhe neni 30. Nga 22 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar të gjitha, ose 100 % e tyre. Nga 22 rekomandimet e pranura, janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, ose 59.1 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime, ose 13.62 % e tyre; është në proces zbatimi 1 rekomandim, ose 4.55 % e tyre, si dhe rezultojnë pa zbatuar 5 rekomandime, ose 22.73 % e tyre.

- Rekomandimet “Për përmirësim legjislacioni”, është lënë 1 rekomandim i cili është zbatuar plotësisht, ose në masën 100 %;
- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 18 rekomandime, janë zbatuar plotësisht 10 rekomandime, ose në masën 56 %; janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime, ose në masën 17 % si dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime, ose në masën 28 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa shpërblim dëmi”, janë lënë 2 rekomandime, është zbatuar plotësisht 1 rekomandim, ose 50 % e tyre, si dhe është në proces zbatimi 1 rekomandim, ose në masën 50 % e tyre;
- Rekomandimet “Masa disiplinore”, është lënë 1 rekomandim i cili është zbatuar plotësisht, ose në masën 100 %.

6.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/5, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/12 prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Autoritetin e Mbiqëqyrjes së Lojërave të Fatit”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të

KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 2, datë 18.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 1819/1, datë 18.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/25 prot., datë 10.11.2023.

Auditimi u krye nga:

- E.B.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 18.10.2022.

6.3. Përshkrimi i auditimit

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 290/15 prot., datë 09.09.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2017-31.12.2021, protokolluar në subjekt me nr. 442/21 prot., datë 13.09.2022, janë rekomanduar për zbatim: 1 rekomandim “Për përmirësim ligjor”, 18 rekomandime “Masa organizative”, 2 rekomandime “Shpërblim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe “Masa disiplinore” për punonjës të AMLF.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar **nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditë** nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, gërma (j) ku cilësohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.
- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: **Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, z. Zh. Ç..

2. Mbi zbatimin e rekomandimeve për përmirësimet në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 1 masë për përmirësim në legjislacionin në fuqi, realizimi i së cilës paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF për intensifikimin dhe bashkëpunimin me MFE me qëllim amendimin e nenit 59, gërma “c” të Ligjit nr. 155/2015 “Për Lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) në lidhje me procedurën për konfiskimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mjeteve të lojërave të fatit.

Nga auditimi ka rezultuar:

AMLF në bashkëpunim me MFE kishte propozuar për ndryshimin e nenit 59, gërma “c” të Ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në lidhje me konfiskimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mjeteve të lojërave të fatit. Propozimet ishin pasqyruar në Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), më konkretisht në nenin 30: “Në nenin 59, pas pikës 3, shtohet pika 4 si më poshtë:

“4” Ngarkohet ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e udhëzimit për përcaktimin e procedurave të konfiskimit, magazinimit dhe shkatërrimit të mjeteve të lojërave të fatit”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuara dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 18 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

Rekomandimi 1.1: AMLF të marrë masat e nevojshme për argumentimin e projektbuxheteve që i paraqiten MFE, si dhe të planifikojë të ardhura dhe shpenzime të bazuara, në bazë të rrethanave konkrete, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës, me qëllim analizën dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zbatimin e disiplinës buxhetore.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 1562 prot, datë 28.09.2022 “Parashikimi i shpenzimeve dhe i të ardhurave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për vitin 2023”, AMLF kishte përcjellë në MFE Relacionin shpjegues për parashikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave për vitin 2023, në të cilin kishin bashkëngjitur:

- Parashikimi i shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2023;
- Të ardhura të pritshme për vitin 2023;
- Përmbledhëse e shpenzimeve të pritshme për pagat e vitit 2023;
- Të ardhura faktike nga 0.5% dhe 3% për periudhën 01.01.2022-20.09.2022;
- Përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2022-2023 (plan, fakt, propozim).

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se parashikimet për buxhetin e vitit 2023, ishin llogaritur për 25 punonjës, bazuar në strukturën e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 61, datë 07.05.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Lojërave të Fatit”. Ky urdhër nuk ishte vënë në zbatim për shkak të mos përfundimit të procesit të ristrukturimit të institucionit. Ndërsa shpenzimet faktike për të tretin vit radhazi i kishin bërë sipas strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 234, datë 03.12.2013, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Lojërave të Fatit”, me 42 punonjës. Me shkresën nr. 17858/3 prot, datë 30.12.2022 “Mbi buxhetin për Janar-Dhjetor të vitit 2023”, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kishte miratuar planin e shpenzimeve për Janar-Dhjetor të vitit 2023, në përputhje me propozimin e AMLF.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për përditësimin e Rregullores së brendshme, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve ligjore si dhe të strukturës organike me emërtimet përkatëse, të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 61, datë 07.05.2020.

Nga auditimi ka rezultuar:

Struktura e AMLF ishte miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 61, datë 07.05.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Lojërave të Fatit”, ku numri total i punonjësve është 25.

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 149, datë 26.09.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 61, datë 07.05.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Lojërave të Fatit”, numri total i punonjësve nuk kishte ndryshuar. Kjo strukturë nuk ishte vënë në zbatim, për shkak të mos përfundimit të procesit të ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimeve ligjore të propozuara në Projektligjin e ri, në ndryshim të disa pikave në Ligjin nr. 155/2015 “Për lojrat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, për pasojë dhe Rregullorja e brendshme nuk ishte përditësuar.

Statusi: Pa zbatuar

3.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF që të bëhen përmirësimet ligjore në Rregulloren e brendshme me qëllim që praktikën e kontrollit të unifikohen duke bashkëlidhur gjurmën (kopje të sistemit të dhënave/print screen) për të siguruar lidhjen/përputhjen e të dhënave të nxjerra nga kontrolli me ato të sistemit qendror të dhënave.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrenguese në AMLF, kishte marrë masa në praktikën e kontrolleve të ushtruara në terren. Ata i kishin bashkëlidhur (kopje të sistemit të dhënave/print screen) duke siguruar lidhjen/përputhjen e të dhënave të nxjerra nga kontrolli me ato të sistemit qendror të të dhënave. Përmirësimet ligjore në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk ishin reflektuar.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

3.2. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF për krijimin e një baze të dhënash (data base) të konsoliduar për gjobat e vendosura, i cili të përmbajë dhe të përditësojë gjithë elementët e saj, duke krijuar një historik për çdo gjobë dhe sigurimin e një informacioni në kohë reale me qëllim që ndjekja e gjobave, kamatëvonesave nga sektorët përkatës të jetë më efektiv.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit në AMLF kishte marrë masa duke krijuar bazën e të dhënash (data base), për gjobat e vendosura nga Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrenguese (DKMSH), e cila ishte e aksesueshme nga Sektori i Financës, Sektori Juridik, DKMSH dhe Shërbimet Mbështetëse në AMLF.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF në bashkëpunim me DAP për plotësimin e Komisionit të Ristrukturimit me përfaqësuesin e saj, si dhe të intensifikohet bashkëpunimi me MFE, me qëllim që të vihet në lëvizje dhe përfundojë procesi i ristrukturimit të këtij institucioni.

Nga auditimi ka rezultuar:

Pas korespondencës në formë elektronike të AMLF me MFE, në lidhje me kërkesën për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, më datë 10.10.2023 nga ana e MFE ishte dërguar një kërkesë tip, që AMLF duhet t'i adresojë Departamentit të Administratës Publike, për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit. Kjo shkresë kishte mbetur draft nga ana e AMLF.

Statusi: Pa zbatuar

5.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF për plotësimin e mangësive dhe parregullsive të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti “R.T.” SHA.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr.1632, datë 10.10.2022 protokolluar në AMLF, shoqëria aksionare “R. T.” SHA, kishte depozituar bilancin e njësuar të vitit 2019-2020 për “T.P. Center” SHPK, bilancet e njësuara për vitet 2017-2019 për “T.P. Center” SHPK, si dhe 2017-2019 për “R. T”. Bashkëngjitur bilanceve ishte depozituar edhe shkresa “Konfirmim Bilanci” me nr. 843 prot, datë 27.09.2022, i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për analizimin e mangësive dhe parregullsive të konstatuara nga KLSH në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti “T. S.” SHA, për hapje të NIPT-e sekondare, sipas kërkesës nr. 1075 prot., datë 27.02.2018, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë në pranimin e dokumentacionit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Subjektit “T. S.” SHA, i kishte përfunduar afati i vlefshmërisë së ushtrimit të aktivitetit (lejes) më datë 31.12.2018, bazuar në Ligjin 75/2018 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”. AMLF kishte marrë masa dhe nga verifikimi i kryer, adresa sekondare kishte rezultuar e mbyllur.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.2. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF, që të bëhen përmirësimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të saj, duke saktësuar dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet në rastet e hapje/mbyllje të pikave të shitjes së biletave të Lotarisë Kombëtare, me qëllim saktësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Nga auditimi ka rezultuar:

AMLF nuk kishte marrë masa për kryerjen e përmirësimeve në Rregulloren e brendshme të saj, sipas rekomandimit të dhënë nga KLSH.

Statusi: Pa zbatuar

7.1. Rekomandimi: Të merren masa nga njësia përgjegjëse për ushtrimin e kontrolleve në terren në AMLF, për hartimin e planifikimeve periodike të qarta e me objektiva të matshëm, ku të specifikohen detyrat e njësisë dhe të bëhet i mundur vlerësimi i realizimit të objektivave në fund të çdo muaji, duke vepruar brenda kompetencës ligjore në subjekte që organizojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrënguese kishte marrë masa në hartimin e planeve mujore të punës, lidhur me ushtrimin e kontrolleve në terren, ku parashikonin detyrat e inspektorëve, periudhën e kontrollit, si dhe kontrollin e sallave fizike, magazinave dhe selive administrative të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në kategorinë “Kazino” dhe “Kazino të vendosur në hotele me 5 Yje”, Bingo Televizive, verifikimin e shkresave/ankesave të ardhura në rrugë shkresore apo elektronike (nga portali i bashkëqeverisjes) gjatë muajit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1. Rekomandimi: Të merren masa nga njësia përgjegjëse për ushtrimin e kontrolleve në terren në AMLF për krijimin e një data baze, ku të jenë të evidentuara qartazi të gjitha të dhënat e kontrolleve të ushtruara nga kjo njësi, me qëllim vlerësimin e riskut të subjekteve dhe rritjen e forcës kontrolluese në drejtim të disiplinimit të kësaj veprimtarie.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrënguese kishte marrë masa në krijimin e data bazës lidhur me kontrollin/verifikimet që kryen gjatë muajit. Në këtë databazë ishin përcaktuar urdhri i shërbimit me datë e numër protokollit, inspektorët që kanë qenë pjesë e urdhër-shërbimit, numrin e kontroleve të kryera, si dhe masat administrative që ishin marrë ndaj subjekteve në të cilat ishin evidentuar shkelje.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1. Rekomandimi: Njësia përgjegjëse për ushtrimin e kontroleve në terren në AMLF të marrë masa që, në urdhër shërbimet e paraqitura për miratim të përcaktohen qartë dhe në mënyrë të matshme detyrat e grupeve të kontrollit, në përputhje me formatin e miratuar sipas rregullores së brendshme, dhe në përfundim të procesit, grupi i kontrollit të paraqesë dokumentacion vërtetues, mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në urdhër-shërbim.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrënguese ishin marrë masat që në urdhër-shërbimet e miratuara nga Titullari i Institucionit, të ishin specifikuar emrat e inspektorëve që do të ishin pjesë e grupit të punës, subjektet objekt-kontrolli me NIUS, adresë të selisë apo sallës ku do të ushtrohej kontrolli. Bashkëngjitur çdo kontrolli të ushtruar ishte mbajtur akt konstatimi përkatës dhe raport kontrolli për kontrollin e ushtruar nga grupi i punës i Njesisë përgjegjëse.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.1. Rekomandimi: Titullari i AMLF dhe njësia përgjegjëse për ushtrimin e kontroleve të marrin masa për administrimin dhe ruajtjen e këtij dokumentacioni, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me qëllim ruajtjen e gjurmës së auditimit për aktivitetin e njesisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtoria e Kontrollit & Masave Shtrënguese, ishin marrë masa që akt konstatimet e mbajtura gjatë kontroleve, të ishin nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit dhe ishin ndjekur numrat serial të tyre duke ruajtur gjurmën e auditimit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.1. Rekomandimi: Nga ana e AMLF të vendosen masa shtrënguese për vjeljen e gjobave/kamatë-vonesave për subjektet “A. D”, “M.” SHA dhe “S. M. A.” gjë e cila do të ndikojë në menaxhimin e borxhit të kontabilizuar dhe detyrimeve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me urdhrin nr. 173, protokolluar me nr.1286, datë 14.07.2023, Drejtori i Përgjithshëm kishte urdhëruar nëpunësit z. E. Sh.dhe z. A. K. për të vazhduar me procedurat ligjore në institucion, si pasojë e vakancës së pozicionit të Përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse në AMLF.

Me shkresat nr. 1830 prot, dhe nr. 1831 prot, datë 11.10.2023, “Kërkesë për ekzekutim”, AMLF i ishte drejtuar për vjeljen e detyrimeve Zyrës Përmbarimore Tiranë dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, për subjektet debitore “M.” SHA, “S.M.AL.” SHPK dhe “A.D-V.” SHPK, duke i bashkëngjitur aktkonstatimin e mbajtur nga grupi i kontrollit i AMLF, proces-verbal gjobe, Vendimin e Komisionit të Apelimit të Gjobave, si dhe shkresë-rikujtese për pagesë gjobe, drejtuar subjekteve debitore.

Statusi: Zbatuar plotësisht

12.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AMLF në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes tyre, për efektshmërinë e procesit të rakordimit tatimor, duke parashikuar formën dhe llojin e informacionit që do të shkëmbehet mes palëve, afatin dhe masat në rastet e mos raportimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 1783 prot, datë 31.10.2022 “Mbi Akt-Marrëveshjen e bashkëpunimit me Administratën Tatimore” të Drejtorit të Përgjithshëm të AMLF, ishte kërkuar një takim i përbashkët dhe përcjellja në DPT e draft-marrëveshjes. Institucioni është në pritje të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. *(Nga ana e AMLF ishte dërguar draft-marrëveshja më datë 31.10.2022, e cila nuk ka marrë përgjigje nga DPT. Për rrjedhojë nuk është proceduar më tej për zbatimin e këtij rekomandimi).*

Statusi: Zbatuar pjesërisht

13.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit të përfshijnë dhe çështjen kur subjektet vijnë të deklarojnë e ushtrojnë aktivitetet pa pasur një licencë aktive, me qëllim disiplinimin ligjor dhe financiar e tatimor të veprimtarisë së lojërave të fatit, si dhe shmangien e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i Institucionit nuk i kishte marrë masat që në draft-marrëveshjen e bashkëpunimit përgatitur nga AMLF, të ishte përfshirë edhe çështja kur subjektet vijnë të deklarojnë dhe ushtrojnë aktivitetet, pa pasur një licencë aktive.

Statusi: Pa zbatuar.

14.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/AMLF që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshëm të Tatimeve të saktësohen elementët që do të rakordohen midis palëve, me qëllim respektimin e kuadrit ligjor për raportimin e detyrimeve dhe të statusit të subjekteve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga AMLF ishin marrë masat që në nenin 5 dhe 6 të draft-marrëveshjes së bashkëpunimit, të ishin përfshirë elementët që do të rakordohen midis dy palëve (AMLF dhe DPT), me qëllim respektimin e kuadrit ligjor për raportimin e detyrimeve dhe të statusit të subjekteve. *(Nga ana e AMLF ishte dërguar draft-marrëveshja e bashkëpunimit me DPT, me shkresën nr. 1783 prot., datë 31.10.2022, e cila nuk ka marrë përgjigje nga DPT. Për rrjedhojë nuk është proceduar më tej për zbatimin e këtij rekomandimi).*

Statusi: Zbatuar pjesërisht

15.1. Rekomandimi: Titullari i AMLF të marrë masa në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, për ngritjen e GMS, me qëllim mirëfunksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i Institucionit nuk kishte marrë masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, pasi AMLF që nga viti 2018 e në vazhdim ishte në proces ristrukturimi dhe rezultoi në vakanca në pozicione drejtues të drejtorive, në nivel të mesëm drejtues.

Statusi: Pa Zbatuar.

16.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit (AMLF) për analizimin e statusit të rekomandimeve të pazbatuara me qëllim përmirësimin e situatës dhe nxjerrjen e planit të masave për ndjekjen dhe zbatimin e atyre rekomandimeve që janë me status të pazbatuar.

Nga auditimi ka rezultuar:

Subjektet e konstatuar debitorë, që nga viti 2018 nuk janë aktivë si pasojë e mbylljes së kategorive “Baste Sportive” dhe “Bingo Tradicionale” për ushtrim aktiviteti lojërë fati, me anë të Ligjit 75/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.155/2015”.

Titullari i Institucionit në bazë të masave shtrënguese të parashikuara në Ligjin 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), kishte marrë masa për analizimin e rekomandimeve të pazbatuara.

Me shkresën nr. 2264 prot, datë 24.05.2018 dhe 1277/3 prot, datë 24.09.2019 “Kërkesë për ekzekutim”, i ishte drejtuar për vjeljen e detyrimeve Zyrës së Përmbarimit Tiranë, për subjektet debitoare “K. T. & T.”, “O.” SHPK, “S. & Co”, “A. Company”.

Me shkresën nr. 171 prot, datë 28.01.2020 “Përcjellje shqetësimi”, AMLF i ishte drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit në lidhje me ekzekutimin e titujve ekzekutiv të subjekteve debitorë, nga ana e Zyrës Përmbarimore Tiranë.

Me shkresën nr. 1478 prot, dhe 1479 prot, datë 15.09.2022 “Kërkesë për informacion”, AMLF i kishte kërkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe DPSHTRR, informacion për 33 subjekte të cilat kanë pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrat publikë, të këtyre institucioneve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4. Mbi zbatimin e rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 2 masa shpërblim dëmi (të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit), për shumën 1,000,000 lekë, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për nxjerrjen e aktit administrativ për gjobitjen e subjektit “Xh.” SHA në masën 500,000 lekë për mbylljen pa miratim të AMLF, të adresës sekondare Pogradec, me qëllim arkëtimin e saj menjëherë me riaktivizimin e subjektit i cili rezultoi i pezulluar, duke komunikuar për këtë qëllim me organet tatimore në mënyrë të vazhdueshme.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i Institucionit kishte marrë masa me nxjerrjen e urdhër-shërbimit nr. 395, datë 20.10.2022, duke ngritur Grupin e punës për shqyrtimin e subjektit “Xh.” SHA, i cili kishte verifikuar se në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), shoqëria “Xh.” SHA, rezultonte me statusin “Pezulluar”, dhe nuk ushtronte aktivitet lojëra fati në Republikën e Shqipërisë. Nga Grupi i punës, ishte mbajtur akt konstatimi nr. 0000263, datë 20.10.2022. Me Raportin nr. 1722/1 prot, datë 21.10.2022, Grupi i punës kishte informuar mbi masat administrative të marra, Drejtorin e Përgjithshëm z. Zh.Ç. dhe Drejtorinë e Certifikimit, në AMLF.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për nxjerrjen e aktit administrativ për gjobitjen (diferencën) e subjektit “T. S.” SHA në vlerën 500,000 lekë, për hapjen e pikës dytësore në Vlorë, por të pa regjistruar pranë QKB-së me qëllim arkëtimin e saj, duke ndjekur në këtë mënyrë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i Institucionit kishte marrë masa me nxjerrjen e urdhër-shërbimit nr. 383, datë 28.09.2022, duke ngritur Grupin e punës për shqyrtimin e subjektit “T. S.” SHA, i cili kishte mbajtur akt konstatimin nr. serial 0000262, datë 28.09.2022, si dhe procesverbal gjobë me nr. serial 0000401, datë 28.09.2022 masën administrative (gjobë), në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për mos regjistrim të pikës dytësore në Vlorë. Me Raportin nr. 1558/1 prot, datë 29.09.2022, Grupi i punës kishte informuar mbi masat administrative të marra, Drejtorin e Përgjithshëm z. Zh. Ç. dhe Përgjegjësin e Sektorit të Kontrollit, z. K. D..

Statusi: Zbatuar plotësisht

5. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 1 masë disiplinore, realizimi i së cilës paraqitet si më poshtë.

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germa (b, c dhe ç) dhe nenit 58 të Ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 për “Përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor”, kreu II, pika 3, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Mbikëqyrjes të Lojërave të Fatit të kërkojë nga Komisioni Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilat kanë shkaktuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “**vërejtje**” deri në “**pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë**”, për punonjësit e cilësuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Titullari i Institucionit nuk ka marrë masa disiplinore për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pasi Institucioni ishte në proces ristrukturimi, nuk ishin plotësuar vendet vakante në nivel “Drejtor Drejtorie”, si dhe një pjesë e nëpunësve për të cilët ishin lënë rekomandimet në auditimin e mëparshëm nuk ishin më pjesë e shërbimit civil dhe pjesë e AMLF.

Statusi: Zbatuar plotësisht

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/25, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

6.4. Rekomandime

Për sa më sipër, ri kërkojmë:

1. Rekomandim: Drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, të marrë masa për:

- a.** zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b.** përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c.** njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 100-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për përditësimin e Rregullores së brendshme, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve ligjore si dhe të strukturës organike me emërtimet përkatëse, të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 61, datë 07.05.2020.

Deri më datë 31.03.2024

3.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF që të bëhen përmirësimet ligjore në Rregulloren e brendshme me qëllim që praktikën e kontrollit të unifikohen duke bashkëlidhur gjurmën (kopje të sistemit të dhënave/print screen) për të siguruar lidhjen/përputhjen e të dhënave të nxjerra nga kontrolli me ato të sistemit qendror të dhënave.

Deri më datë 31.03.2024

4.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF në bashkëpunim me DAP për plotësimin e Komisionit të Ristrukturimit me përfaqësuesin e saj, si dhe të intensifikohet bashkëpunimi me MFE, me qëllim që të vihet në lëvizje dhe përfundojë procesi i restrukturimit të këtij institucioni.

Deri më datë 31.03.2024

6.2. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF, që të bëhen përmirësimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të saj, duke saktësuar dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet në rastet e hapje/mbyllje të pikave të shitjes së biletave të Lotarisë Kombëtare, me qëllim saktësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Deri më datë 31.03.2024

12.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AMLF në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes tyre, për efektshmërinë e procesit të rakordimit tatimor, duke parashikuar formën dhe llojin e informacionit që do të shkëmbehet mes palëve, afatin dhe masat në rastet e mos raportimit.

Deri më datë 31.03.2024

13.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit të përfshijnë dhe çështjen kur subjektet vijnë të deklarojnë e ushtrojnë aktivitet pa pasur një licencë aktive, me qëllim disiplinimin ligjor dhe financiar e tatimor të veprimtarisë së lojërave të fatit, si dhe shmangien e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Deri më datë 31.03.2024

14.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/AMLF që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshëm të Tatimeve të saktësohen elementët që do të rakordohen midis palëve, me qëllim respektimin e kuadrit ligjor për raportimin e detyrimeve dhe të statusit të subjekteve.

Deri më datë 31.03.2024

15.1. Rekomandimi: Titullari i AMLF të marrë masa në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, për ngritjen e GMS, me qëllim mirëfunksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Deri më datë 31.03.2024

6.5. Aneksë

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa përmirësime ligjore	1	-	1	100	1	-	-	-

Masa organizative	18	-	18	100	10	3		5
Masa shpërblim dëmi “Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”	2	-	2	100	1	-	1	-
Masa disiplinore	1	-	1	100	1	-	-	-
Totali	22	0	22	100	13	3	1	5

Burimi i të dhënave AMLF, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

7. INSTITUTI I INTEGRIMIT TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

7.1.Konkluzioni i auditimit:

Në përfundim të auditimit të ushtruar në IIPP, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr.886/9 prot., datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **IIPP, ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje respektimin e afateve të raportimit në KLSH mbi, Plan veprimin dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, statusin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre. Nga IIPP, janë përcjellë në KLSH, dy raportimet, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15 dhe neni 30. Nga 13 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 13 rekomandime, ose 100 % e tyre. Nga 13 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 12 rekomandime, ose 93 % e tyre; është në proces zbatimi 1 rekomandim, ose 7 % e tyre, realizimi i të cilit nuk varet nga IIPP.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 11 rekomandime, janë pranuar 11, ose 100 % e tyre. Nga 11 rekomandimet e pranuar 10 rekomandime, ose 91 % e tyre janë zbatuar plotësisht dhe 1 rekomandim, ose 9 % e tyre, është në proces zbatimi, konkretisht rekomandimi nr. 9.1 realizimi i të cilit varet nga MFE.
- Rekomandimet “Masa për eliminimin e efekteve negative”, është lënë 1 rekomandim i cili është zbatuar plotësisht.
- Masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH, i janë lënë në vlerësim Titullarit të institucionit, i cili pas analizës dhe shqyrtimit Raportit Përfundimtar të Auditimit, gjetjeve dhe rekomandimeve, ka konkluduar në dhënien e 1 mase disiplinore “Vërejtje” për 6 punonjës.

7.2. Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/2, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.886/9 prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politike”, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 1, datë 17.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 647/1, datë 18.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/24 prot., datë 10.11.2023 dhe konfirmuar nga subjekti me shkresën nr. 716/1 prot., datë 24.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 886/33, datë 01.12.2023.

Auditimi u krye nga:

- B. Z.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 10.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 18.10.2023.

7.3.Përshkrimi i auditimit

Nga KLSH me shkresën përcjellëse nr. 811/13 prot., datë 16.01.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Institutin e Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2020-30.06.2022, protokolluar në subjekt me nr. 46 prot., datë 18.01.2023, janë lënë për zbatim, 11 rekomandime “Masa organizative”; 1 rekomandim “Masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet”, si dhe “Masa disiplinore” të lëna në kompetencë për vlerësim titullarit të institucionit.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Grupi i auditimit për auditimin e këtij drejtimi, mori në shqyrtim dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i audituar si më poshtë:

- Shkresa përcjellëse e Raportit dhe zbatimit të rekomandimeve nr. 811/13, datë 16.01.2023, protokolluar në subjekt me nr. 46 prot., datë 18.01.2023;
- Plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve, dërguar në KLSH me shkresën nr. 164 prot., datë 09.02.2023;
- Informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, dërguar në KLSH me shkresën nr. 485 prot., datë 29.06.2023;

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: *“KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”, subjekti i audituar ka kthyer përgjigje* me shkresën nr. 164 prot., datë 09.02.2023 “Kthim përgjigje mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” dhe shkresën nr. 164/1 prot., datë 09.02.2023 “Personat përgjegjës dhe afatet e realizimit të rekomandimeve të KLSH-së, mbi hartimin e Plan veprimit, brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA;
- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”, subjekti i audituar ka kthyer përgjigje* me shkresën nr. 485 prot., datë 29.06.2023 “Njoftim lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit “Auditim përputhshmërie”, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e PRA.

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar 11 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re për funksionimin e institucionit me objektiva konkret e të matshëm sipas pozicioneve dhe ta përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim, së bashku me propozimet për përditësimin e ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 “Për Institutin e Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë”, lidhur me varësinë e institucionit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm i IIPP-së, ka nxjerrë Urdhrin nr. 14, datë 24.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e draft rregullores për organizimin dhe funksionimin e IIPP-së dhe përditësimin e ligjit organik nr. 8246 datë 01.10.1997 të IIPP-së”, brenda afatit të zbatimit datë 15.03.2023. Nga grupi i punës, ishte mbajtur procesverbali nr. 64/1 datë 10.03.2023, në të cilin është pasqyruar puna e realizuar për hartimin e projekt- rregullores, për organizimin e brendshëm të IIPP-së, e cila ishte dërguar për miratim, me shkresën nr. 64/2 prot., datë 10.03.2023 në MSHMS. Gjithashtu, në procesverbal ishte pasqyruar edhe puna e grupit për përditësimin e ligjit organik të IIPP-së (propozimet ligjore për ndryshimin e varësisë institucionale dhe relacioni përkatës), të cilat IIPP i ka dërguar në MSHMS, me anë të shkresës nr. 64/3 prot., datë 10.03.2023.

MSHMS, me shkresën nr. 716/1 prot., datë 24.11.2023 “Kthim përgjigje e shkresës nr. 886/24 prot., KLSH datë 10.11.2023” ka sqaruar se, MSHMS ka miratuar Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e IIPP” me Urdhrin e Ministrit të MSHMS nr. 667, datë 06.11.2023 nr. 4025 prot., datë 06.11.2023 të cilën e ka bashkëngjitur informacionit të dërguar.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë grupin e punës për hartimin e një rregulloreje të re, në plotësim të rregullores nr. 356, datë 12.04.2018 “Për funksionimin e komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike” në të cilën të përcaktohet qartësisht procedura administrative e shqyrtimit, miratimit dhe monitorimit të kërkesave për ndihma dhe financim që duhet të ndjekë komisioni i shpërndarjes dhe komisioni i monitorimit të fondit, dokumentacioni i domosdoshëm dhe ai i nevojshëm në këto procedura, përbërja e komisioneve, duke shmangur konfliktin në vendimmarrje sipas pozicionit, si dhe të miratojë format kërkesat tip për ndihmë ekonomike të hartuara nga sektorët përkatës.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm i IIPP-së kishte nxjerrë Urdhrin nr. 15, datë 24.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së funksionimit të komisionit të administrimit të fondit 1 % dhe komisionit të monitorimit të fondit 1 %”. Në përfundim të punës së realizuar sipas urdhrit, grupi i punës kishte mbajtur procesverbalin nr. 65/1 datë 31.03.2023, në të cilin ishte pasqyruar puna e realizuar për hartimin e rregullores së funksionimit të komisionit të administrimit të fondit 1 % dhe komisionit të monitorimit të fondit 1 %. Kjo rregullore, kishte hyrë në fuqi, pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm.

Gjithashtu, nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 23, datë 06.02.2023 “Për krijimin e formatit standard të kërkesës për ndihmë ekonomike për Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve”, ishte miratuar formati standard i kërkesës për ndihmë ekonomike (tip), e cila ndihmon në standardizimin e procesit, marrjen e një informacioni më të plotë dhe

të strukturuar për trajtimin nga komisioni i administrimit të fondit 1 % të ish të përndjekurve politikë dhe familjarëve të tyre.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizoje dhe të nxjerre përgjegjësinë për letë mangësi, si dhe të kërkojë nga sektorët hartimin e planeve të punës dhe t'i miratojë në vijim, të cilët duhet të përmbajnë objektiva dhe veprimtari konkrete dhe të matshme për secilin pozicion pune, si dhe raportet e veprimtarisë vjetore në zbatim të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga ana e sektorëve përkatës të IIPP-së ishin hartuar planet e punës për vitin 2023 dhe raportet vjetore të punës për vitin 2022. Raportet vjetore të punës ishin miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 134 prot., datë 02.02.2023 "Raport Vjetor i Punës për vitin 2022 të IIPP", si dhe planet e punës për vitin 2023 ishin miratuar me shkresën 134/1 prot., datë 02.02.2023 "Objektivat dhe plani vjetor i punës për vitin 2023".

Gjithashtu, me shkresën nr. 135, prot., datë 02.02.2023 "Raporti vjetor për vitin 2022 dhe objektivat e punës për vitin 2023", IIPP i kishte dërguar në MSHMS.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën në hartimin e dokumenteve administrative dhe së bashku me gjithë strukturat të marrin masa për hartimin dhe përpilimin e urdhrave me përmbajtje të gjithë elementëve identifikues dhe bazës ligjore të akteve mbështetës të urdhrit të plotë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm i IIPP-së kishte nxjerrë Urdhrin nr. 1 prot., datë 04.01.2023 "Për njësimin e dokumentit administrativ", i cili parashikonte rregulla konkrete për përpilimin e dokumenteve administrative sipas normave Tekoniko- Profesionale të RSH. Ky akt ju ishte bërë i njohur të gjithë nëpunësve të IIPP-së, për zbatim në vijimësi.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5.1. Rekomandimi: Sektori i Çështjeve Sociale, Projekteve dhe Koordinimit me Shoqatat të marrë masa për studimin e nevojave imediate dhe të perspektivës, identifikimin e tyre sipas kategorive dhe nën kategorive, trendit ndër vite dhe atij aktual, të dokumentojë këtë veprimtari nëpërmjet hartimit të raportit përkatës, t'ia përcjell për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe ta publikojë në website-n zyrtar për publikun.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm, kishte nxjerrë Urdhrin nr. 26, datë 08.02.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e raportit për nevojat imediate dhe të perspektivës për Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve". Për zbatimin e këtij urdhri, grupi i punës kishte realizuar raportin mbi nevojat imediate të ish të përndjekurve politikë dhe e kishte pasqyruar këtë në procesverbalin nr. 159/1 prot., datë 24.03.2023 "Mbi hartimin e raportit për nevojat imediate dhe të perspektivës për Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve". Ky raport ishte miratuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet shkresës nr. 159/2 prot., datë 24.03.2023.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Zyra e protokoll-arkivës të marrin masa për regjistrimin dhe evidentimin në protokoll të gjitha kërkesave për ndihmë ekonomike, informacionit për personat e zhdukur dhe çfarë do lloj kërkesë tjetër, në bazë të së cilës institucioni nis një procedurë administrative në vijim.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sipas informacionit të marrë në subjekt, duke filluar që nga viti 2023 dhe në vijim, çdo kërkesë në institucion lidhur me kërkesën për ndihmë ekonomike ose informacion për personat e zhdukur është protokolluar. Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 22, datë 06.02.2023 “Për krijimin e formateve standard (kërkesë dhe deklaratë tip) për Sektorin e Gjetjes së të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit”, kishte miratuar formatet standarde që do t’i shërbenin sektorit të Protokoll arkivës, për standardizimin e procesit, marrjen e një informacioni më të plotë dhe të strukturuar për gjetjen e personave të konsideruar të zhdukur nga krimet e komunizmit, si dhe me Urdhrin nr. 23, datë 06.02.2023 “Për krijimin e formatit standard të kërkesës për ndihmë ekonomike për Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve”, IIPP kishte miratuar formatin standard të kërkesës për ndihmë ekonomike (tip).

Statusi: Zbatuar plotësisht

7.1. Rekomandimi: Komisioni i monitorimit të marrë masa për plotësimin e praktikës me dokumente të mjaftueshëm, me qëllim justifikimin e shpenzimit të bërë nga përfituesit e ndihmës ekonomike, si edhe të krijojë një sistem për të menaxhuar informacionin e të dhënave mbi përfituesit e fondeve (databazë).

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm i IIPP kishte nxjerrë Urdhrin nr. 27, datë 08.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e databazës për përfituesit e fondeve nga Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve”. Për zbatimin e këtij urdhri ishte mbajtur nga grupi i punës procesverbali nr. 160/1 prot., datë 10.03.2023 “Mbi hartimin e databazës për përfituesit e fondeve të 1 % nga Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve”, duke krijuar edhe një sistem për të menaxhuar informacionin e të dhënave mbi përfituesit e fondeve (databazë). Ndërsa që prej fillimit të vitit 2023 dhe në vazhdim me miratimin e rregullores “Së funksionimit të komisionit të administrimit të fondit 1 % dhe komisionit të monitorimit të fondit 1 %”, ishin parashikuar rregulla konkrete për funksionimin e komisionit të monitorimit dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për caktimin e personave përgjegjës për prokurimin, hartimin e saktë dhe brenda afateve kohore të regjistrave të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, titullari i Autoritetit Kontraktor në vijimësi të mos caktojë Nëpunësin Zbatues/ Përgjegjës të Financës dhe Shërbimeve në komisionet e prokurimeve, me qëllim uljen e riskut të mungesës së kontrollit mbi transaksionet e institucionit, si dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi kontrollin vertikal.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori i Përgjithshëm i IIPP-së kishte nxjerrë Urdhrin nr. 3, datë 04.01.2023 “Për caktimin e administratorit në sistemin e prokurimit publik” dhe Urdhrin nr. 4, datë 04.01.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël”. Përbërja e anëtarëve të komisionit kishte ndryshuar dy herë gjatë vitit me anë të urdhrit nr. 34, datë 20.02.2023 dhe Urdhrit nr. 104, datë 09.10.2023. Gjithashtu, ishin caktuar dhe personat përgjegjës në institucion me anë të Urdhrit nr. 5, datë 04.01.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për prokurimin”, ndryshuar me anë të urdhrit nr. 35, datë 20.02.2023. Emrat e personave përgjegjës në institucion i ishin dërguar për dijeni APP-së, me anë të shkresës nr. 6 prot., datë 04.01.2023 “Njoftim për caktim e personave përgjegjës për prokurimin publik” dhe shkresës nr. 184 prot., datë 20.02.2023 “Ridërgimi i të dhënave të personave përgjegjës për prokurimin publik në IIPP” sipas ndryshimeve përkatëse.

Lidhur me regjistrin e parashikimeve, ishte miratuar në fund të vitit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm me anë të Urdhrit nr. 77, datë 20.12.2022 “Për miratimin e regjistrit të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik për vitin 2023” dhe ishte përcjellë me anë të shkresës nr. 8 prot., datë 04.01.2023 “Dërgohet regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2023”, MSHMS dhe Degës së Thesarit Tiranë. Ky regjistër i ishte dërguar sërish MSHMS dhe Degës së Thesarit, Tiranë pas një ndryshimi me anë të shkresës nr. 180 prot., datë 16.02.2023 “Ridërgohet regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2023, pas një ndryshimi në fondin limit të procedurës së prokurimit “Blerje kuti dhe dosje me ruajtje të përhershme”.

Ndërkohë, sa më sipër, MSHMS dhe Dega e Thesarit, Tiranë ishin informuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me realizimet e procedurave të prokurimit gjatë vitit, konkretisht anë të shkresës nr. 7 prot., datë 04.01.2023 “Dërgohet regjistrimi i realizimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2022, shkresën nr. 403 prot., datë 08.05.2023 “Informacion mbi procedurat e prokurimit të realizuara deri në muajin maj 2023” dhe shkresën nr. 597 prot., datë 04.09.2023 “Për informacion mbi procedurat e prokurimit të realizuara deri në muajin shtator 2023”. Anëtarët e komisionit ishin trajnuar nga ASPA lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Statusi: Zbatuar plotësisht

9.1. Rekomandimi: Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë të marrë masa për paraqitjen, argumentimin dhe planifikimin në PBA të nevojës për blerjen e një automjeti, me qëllim uljen e shpenzimeve për marrje me qira dhe menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Lidhur me këtë rekomandim, theksojmë se IIPP i ishte drejtuar me kërkesë për blerje automjeti, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, MSHMS nëpërmjet shkresës nr. 56 prot, datë 19.01.2023 “Kërkesë për blerje automjeti për institucionin”. Ndërkohë, nga ana e Ministrisë me anë të shkresës nr. 444/1 prot., datë 17.02.2023 “Kthim përgjigje”, ishte komunikuar se kjo kërkesë do të merret parasysh në një moment të dytë pasi momentalisht nuk ka parashikuar fonde për blerje automjetesh. Gjithashtu, kjo kërkesë ishte paraqitur dhe argumentuar edhe në PBA 2024- 2026 nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve, me anë të shkresës nr. 507 prot., datë 20.07.2023 “Projekt- Buxheti Afatmesëm (PBA) 2024 -2026 për IIPP” dhe do ndiqej në vazhdimësi nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve.

Statusi: Në proces zbatimi

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësi për marrjen e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion, si dhe të shmangë praktikën e financimit të projekteve të investimit pa kaluar fazat e menaxhimit të investimeve publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga titullari ishin marrë masa që në vijim çdo procedurë e prokurimeve publike (edhe e realizuar nga organet qendrore) trajtuar hollësisht nga KLSH edhe në rekomandimin nr. 8 është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm së bashku me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të marrin masat për plotësimin e dosjeve të personelit, duke parandaluar shfaqjen e mangësive të tilla në të ardhmen.

Nga auditimi ka rezultuar:

Për zbatimin e këtij rekomandimi, Drejtori i Përgjithshëm i IIPP-se kishte nxjerrë Urdhrin nr.17 prot, datë 19.01.2023 “Për plotësimin e dosjeve të personelit”. Ky rekomandim ishte zbatuar nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

3. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Nga auditimi i mëparshëm është lënë për zbatim 1 (një) rekomandim “Masë për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike”, realizimi i së cilës paraqitet më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa e nevojshme për eliminimin dhe shmangien në të ardhmen të efekteve negative për buxhetin e shtetit që vijnë si rezultat i largimeve të padrejta nga puna.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga ana e subjektit ky rekomandim është pranuar, është zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet.

Statusi: Zbatuar plotësisht.

4. Masa disiplinore

Nga auditimi i mëparshëm masat disiplinore janë lënë në vlerësim të titullarit të institucionit, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë:

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” pas vlerësimit të përgjegjësisë të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”. Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të IIPP, më datë 19.01.2023 është marrë në analizë Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH, ku të gjithë punonjësit janë njohur me shkeljet dhe mangësitë, për të cilat janë cilësuar përgjegjës në këtë raport. Në varësi me shkeljet nga Drejtori i Përgjithshëm është dhënë “vërejtje verbale”, e cila është dokumentuar në Procesverbalin me nr. 58/1 prot., datë 19.01.2023.

Statusi: Zbatuar plotësisht.

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 886/24, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

7.4. Aneke

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave		Pranuar	Statusi i zbatimit të rekomandimeve
----------------	--	---------	-------------------------------------

	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar		Shkalla e pranimit %	Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	11	-	11	100	10	-	1	-
Masa 3-E	1	-	1	100	1	-	-	-
Masa disiplinore	1	-	1	100	1	-	-	-
Totali	13	0	13	100	12	0	1	0

Burimi i të dhënave IIPP, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

8. INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

8.1.Konkluzioni i auditimit

Në përfundim të auditimit të ushtruar në ISKK, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik”, si dhe Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/10, datë 09.10.2023, KLSH ka arritur në konkluzionin se, **ISKK, përgjithësisht ka reflektuar përgjegjshmëri menaxheriale**, në lidhje me statusin e zbatimit të rekomandimeve dhe koherencën e tyre. Nga ana e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është përcjellë në KLSH raportimi brenda 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, por nuk është përcjellë raportimi mbi zbatimin e rekomandimeve brenda 6 muajve nga marrja e RPA, referuar kërkesave të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15 dhe neni 30.

Nga 9 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 9 rekomandime, ose 100% e tyre. Nga 9 rekomandimet e pranuar, 4 rekomandime janë zbatuar ose ndryshe 45% e tyre, 1 është në proces zbatimi ose 11% e tyre, 2 janë në zbatuar pjesërisht ose 22% e tyre, dhe 2 nuk janë zbatuar ose 22% e tyre.

- Rekomandimet “Masa organizative”, janë lënë 8 rekomandime, janë pranuar 8. Nga këto 4 rekomandime, ose 50 % e tyre janë zbatuar plotësisht; 2 rekomandime, ose 25 % e tyre janë zbatuar pjesërisht, 1 rekomandim është në proces zbatimi dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar;
- Rekomandimi “Masë disiplinore” nga KLSH, nuk është zbatuar pasi nga auditimi ka rezultuar që nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurës mbi vlerësimin e gjetjeve dhe personave përgjegjës.

8.2.Hyrja

Referuar “Njoftimit për fillim auditimi” nr. 886/1, datë 09.10.2023 dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/10 Prot., datë 09.10.2023 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022, në Institutin e Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunizmit” të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, u krye auditimi në terren, ku në përfundim u mbajt Aktkonstatimi nr. 7, datë 30.10.2023, protokolluar në subjekt me nr. 196/1 Prot., datë 30.10.2023, mbi bazën e të cilit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. 886/24 prot., datë 10.11.2023.

Auditimi u krye nga: Xh. N.

Realizimi i auditimit:

- Auditimi ka filluar më datë 11.10.2023
- Auditimi ka përfunduar më datë 30.10.2023.

8.3.Përshkrimi i auditimit

Veprimtaria e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, për periudhën nga 01.01.2018 deri më 30.06.2022, është audituar bazuar në Programin nr. 811/3 Prot., datë 09.09.2022 “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit”. Raporti Përfundimtar i Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të Audituar me shkresën nr. 811/14 Prot., datë 13.01.2023, protokolluar në subjekt me nr. 135/15 Prot., datë 18.01.2023, ku janë rekomanduar për zbatim 8 rekomandime “Masa organizative” dhe 1 rekomandim “Masë disiplinore”.

1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, germa (j) ku cilësohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.
- Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*, subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e RPA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori Ekzekutiv i ISKK, z. Ç. H..

2. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 8 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i ISKK të marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të konstatuara të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë realizimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike dhe pasurisë publike.

Nga auditimi ka rezultuar:

Referuar masave të lëna në vijim të Raportit Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 360/7 Prot., datë 21.08.2019, të cilat janë konsideruar si “në proces zbatimi”, “zbatuar pjesërisht” apo “pa zbatuar” nga Raporti Përfundimtar i Auditimit përcjellë me shkresën nr. 811/14 Prot., datë 13.01.2023, statusi i zbatimit të tyre paraqitet si në vijim:

- **Për Rekomandimin 1.1:** Rezulton se për Planin e Punës për vitin 2023, Drejtoritë kanë planifikuar aktivitetet e nevojshme dhe produktet mbi të cilat këto aktivitete do të ngrihen si në sasi dhe në vlerë. Drejtorët e drejtorive në ISKK kanë monitoruar çdo 4 muaj realizimin e buxhetit nga secila drejtori/sector.

- **Për rekomandimin 3.1:** Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve për Automjetin për vitin 2023 ka përfunduar vlerësimin e tij në datë 01.02.2023, duke e cilësuar si të nevojshëm nxjerrjen jashtë përdorimi të këtij automjeti, referuar procesverbalit të mbajtur. Me qëllim nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit, ISKK ka shlyer detyrimet e prapambetura në DRPSHT Tiranë referuar Urdhrit nr. 5, datë 23.02.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të ISKK (pagesa kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 30, datë 28.02.2023). Me shkresën nr. 53/3 Prot., datë 20.03.2023, ISKK i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për kalimin e automjetit pranë kësaj të fundit.

- **Për Rekomandimin 6.1:** Në procedurat e prokurimit të realizuara në gjysmën e dytë të vitit 2022 dhe vitin 2023, Njësia e Prokurimit ka hartuar, miratuar dhe nënshkruar nga anëtarët e saj Dokumentet e Tenderit në përputhje me Dokumentet Standarde të Tenderit për kontratat e furnizimeve (mallra/shërbim/punë).

- **Për Rekomandimin 8.1:** Njësia e Burimeve Njerëzore në ISKK ka mbledhur të gjitha kërkesat për trajnim të punonjësve dhe ka hartuar një program trajnimesh ku janë specifikuar numri i punonjësve dhe temat kryesore të nevojshme për trajnim dhe e ka dërguar këtë program pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike përmes email të datës 07.11.2022.

Rezulton se është përgatitur Regjistri i Riskut, por nuk është hartuar Strategjia e Riskut. Grupi i Menaxhimit Strategjik ka përgatitur Raportin Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, si dhe Deklaratën e Cilësisë për vitin 2022, të cilat i ka dërguar pranë MFE nëpërmjet shkresës nr. 71 Prot., datë 24.02.2023.

Vlerësimet e punonjësve janë realizuar sipas afateve të përcaktuara në Vendimin Nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, me periodicitet 6 muaj si dhe nga eprorët përkatës.

- **Për Rekomandimin 9.1:** Ndryshimet e Strukturës, Organikës dhe kriteret e miratuara për çdo pozicion pune janë bërë pjesë e Draft-Rregullores së Brendshme të ISKK, e cila është ende e pamiratuar nga Bordi Drejtues.

- **Për Rekomandimin 10.1:** Korrespondencave të protokolluara u është bashkëlidhur kartela shoqëruese përkatëse për dokumentet hyrës/dalës në institucion. Referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 811/14 Prot., datë 13.01.2023, kanë rezultuar 4 masa të zbatuara pjesërisht, 1 në proces zbatimi dhe 1 masë e pazbatuar. Ndërkohë, nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve referuar Programit të Auditimit nr. 886/10, datë 09.10.2023, siç është pasqyruar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga këto masa rezultojnë se janë zbatuar plotësisht 4 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe është në proces zbatimi 1 masë.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.

Nga auditimi ka rezultuar:

Për zbatimin e këtij rekomandimi rezulton se është vënë në dijeni Bordi Drejtues në mbledhjen e datës 20.12.2022, ku referuar Procesverbalit nr. 14/8, datë 20.12.2022 si rend dite përcaktohet diskutimi i rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Gjatë mbledhjes është diskutuar dhe vendosur se në kushtet kur në Shkurt 2023 anëtarëve aktualë të Bordit Drejtues u mbaron mandati, marrja e masave për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë për procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv u lihet si detyrë anëtarëve të rinj që do të mandatohen si pjesë e Bordit Drejtues. Duke qenë se anëtarët e rinj të Bordit Drejtues ende nuk janë zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, rekomandimi nuk ka gjetur zbatim.

Statusi: Pa zbatuar

3.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të marrin masa për standardizimin dhe formalizimin e procesit të botimit, duke paracaktuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve të paraqitura për botim dhe të gjithë procesin që nga shpallja deri në botimin e veprave dhe miratimin e saj nga Bordi Drejtues, si dhe të krijojë dhe administrojë një databazë të plotë në lidhje me botimet, me qëllim dokumentimin e plotë të procesit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Referuar Procesverbalit nr. 67 prot., datë 12.02.2023, Këshilli Shkencor i ISKK është vënë në dijeni dhe ka diskutuar për domosdoshmërinë e formalizimit të procesit të botimit duke përcaktuar metodologjinë për vlerësimin e punimeve të paraqitura për botim në një format tip bashkëlidhur.

Në zbatim të Urdhrit nr. 10, datë 27.01.2023, me shkresën nr. 135/18 prot., datë 11.04.2023, është miratuar Metodologjia për botimet dhe për organizimin e konferencave. Pra, përmes metodologjisë janë vendosur përcaktimet për botimet e veprave të përvitshme nga ISKK. Procedura e përcaktuar në Metodologji është bërë pjesë edhe e Draft-Rregullores së Brendshme në kreun e përcaktuar për botimet. Drejtoria e Arkivës dhe Bibliotekës ka marrë masa për krijimin e një databaze të thjeshtë për të gjitha botimet e bëra përgjatë viteve 2012 e në vazhdimësi, ku librat e botuar nga ISKK ndër vite janë listuar me një përshkrim të shkurtër në faqen zyrtare të ISKK: <https://ëëë.iskk.gov.al/en/kolana-studimore-3/>.

Statusi: Zbatuar plotësisht

4.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që detajon procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtorja e Arkivës dhe Bibliotekës, Drejtoria e Studimeve dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në ISKK, në bashkëpunim me njëra-tjetrën, kanë marrë masa për hartimin e Metodologjisë për botimet dhe për organizimin e konferencave (shkresa nr. 135/18 prot., datë 11.04.2023). Përmes metodologjisë janë vendosur përcaktimet për organizimin e konferencave (në rastet kur i organizon vetë ISKK si dhe në rastet kur ISKK merr pjesë përmes ftesës). Procedura e përcaktuar në Metodologji është bërë pjesë edhe e Draft-Rregullores së Brendshme.

Sa i takon krijimit të databazës lidhur me konferencat, rezulton se nuk janë marrë masa për krijimin e saj në mënyrë që të evidentohen aplikimet së bashku me të dhënat përkatëse.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

5.1. Rekomandimi: Titullari i ISKK të marrë masa mbi ngarkimin e njësisë përgjegjëse për regjistrimin e dokumenteve që formojnë një praktikë duke vijuar me të njëjtin numër rendor progresivisht me fraksion për çdo dokumentacion hyrës në institucion deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare, si dhe përcaktimin e kësaj njësie për sa më sipër në aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat funksionale të punonjësve të ISKK.

Nga auditimi ka rezultuar:

Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga ISKK, rezulton se dokumentet që formojnë një praktikë janë regjistruar duke vijuar me të njëjtin numër rendor progresivisht me fraksion për çdo dokumentacion hyrës në institucion deri në mbylljen e praktikës me vendimmarrjen përfundimtare nga specialisti përkatës i njësisë dhe janë konfirmuar e kontrolluar nga pjesa tjetër e njësisë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat e nevojshme për planifikimin sa më real, duke përfshirë identifikimin dhe argumentimin e nevojave të çdo drejtorie\sektori, si dhe monitorimin e kujdesshëm të buxhetit ndaj realizimit të produkteve në përputhje me planet e parashikuara, me qëllim ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese për alokimin e burimeve financiare.

Nga auditimi ka rezultuar:

Pas miratimit të Planit Vjetor të Punës, drejtoritë/sektorët e ISKK në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, kanë marrë masa për identifikimin dhe argumentimin e nevojave të dala nga Plani Vjetor, si dhe për planifikimin e produkteve në përputhje me parashikimet. Gjithashtu, janë realizuar monitorime 4 mujore të buxhetit ndaj realizimit të planit, për të mundësuar marrjen e masave për ndryshime të mundshme. Referuar Raportit Vjetor të ISKK rezulton se është realizuar 89% e planifikimit, tregues në rritje krahasuar me vitin e mëparshëm.

Statusi: Zbatuar plotësisht

7.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit brenda afateve kohore, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e ISKK, me qëllim parashikimin e saktë të nevojave të institucionit, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të legjislacionit.

Nga auditimi ka rezultuar:

Pas miratimit të Planit Vjetor të Punës nga Bordi Drejtues, rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik të ISKK, Ekipet e Menaxhimit, dhe Personi përgjegjës për prokurimet kanë hartuar regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit brenda afateve kohore, në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e ISKK. Gjithashtu është hartuar regjistri i realizimit të prokurimeve.

Lidhur me trajnimin e zyrtarëve të prokurimit mbi procedurat e prokurimit, rezulton Njësia e Burimeve Njerëzore në ISKK dhe drejtorët e drejtorive kanë marrë masa duke hartuar planet e trajnimit si dhe se nga ana e personave përgjegjës për prokurimet janë ndjekur trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.1. Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masat për rishikimin e rregullores së institucionit, ku të përcaktohen qartë, struktura organizative, funksionet dhe përkrahja e punës për çdo pozicion pune me qëllim rritjen e performancës institucionale, si dhe të merren masa për vlerësimin e rezultateve në punë të të gjithë nëpunësve civil.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtori Ekzekutiv përmes Urdhrit nr. 14, datë 28.02.2023, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Rishikimin e Rregullores së Brendshme të institucionit, duke përcaktuar edhe afatet për përgatitjen e saj hap pas hapi sipas Drejtorive përkatëse të përfshira. Megjithatë, nga auditimi rezulton se është përgatitur një Draft-Rregullore me ndryshimet përkatëse, por ajo ende nuk ka kaluar në hallkat e miratimit të saj, përkatësisht tek Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi Drejtues i ISKK.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë, është konstatuar se nëpunësit e lartë/mesëm dhe të ulët drejtues kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil në vartësi të tyre çdo 6 muaj sipas akteve ligjore në fuqi. Njësia e Burimeve Njerëzore ka ndihmuar në proces si dhe ka monitoruar afatet dhe procesin e vlerësimit të nëpunësve të ISKK.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH ka rekomanduar masë disiplinore si më poshtë:

Drejtori Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” pas vlerësimit të përgjegjësisë të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”.

Nga auditimi ka rezultuar: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk rezulton që të jenë marrë masa për ndjekjen e procedurës mbi vlerësimin e gjetjeve dhe personave përgjegjës, ndaj rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Statusi: Pa zbatuar

Raporti Përfundimtar të Auditimit është mbështetur në Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 886/27, datë 10.11.2023. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

8.4.Rekomandime

Për sa më sipër ri kërkojmë:

1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i dhe Bordi Drejtues i ISKK-së të marrin masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 117-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kriterëve

që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.

Deri më datë 31.03.2024

4.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që detajon procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.

Deri më datë 31.03.2024

Masa disiplinore:

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” pas vlerësimit të përgjegjësisë të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”.

Deri më datë 31.03.2024

8.5.Anekse

Tabela nr. 1 “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	8	-	8	100	4	2	1	1
Masa shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-	-
Masa të tjera (administrative)	-	-	-	-	-	-	-	-
Masa disiplinore	1	-	1	100	-	-	-	1
Totali	9	-	9	100	4	2	1	2

Burimi i të dhënave ISKK, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Për përmirësimin e situatës në të ardhmen, bazuar në rezultatet e auditimit të secilit subjekt, rikërkojmë sa më poshtë.

IV. REKOMANDIME:

1. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TIRANË

1.1. Periudha e audituar në auditimin e mëparshëm (01.01.2018-31-12-2020)

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse nr. 1247/130 prot., datë 20.02.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2018-31.12.2020, protokolluar në subjekt me nr. 6802, datë 22.02.2023, ku janë rekomanduar për zbatim 17 rekomandime “Masa organizative”, 28 rekomandime “Shpërblim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe 1 rekomandim “Masë disiplinore” për 8 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023, ka rezultuar se nga 46 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 42 rekomandime, ose 91 % e tyre, nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, ose 62 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, ose 5 % e tyre dhe janë në proces zbatimi 14 rekomandime, ose 33 % e tyre.

Sa më sipër ri kërkojmë:

1.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 7-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

4.1. Rekomandimi: Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojë dhe miratojë një akt juridik normativ ku të përcaktojnë qartë dhe të saktë llogaritjen e detyrimeve tatimore në rastet e praktikave të kontrolleve tatimore, kur konstatohen klasifikime të gabuara kontabël edhe aplikim të normës së amortizimit nga ana e shoqërive në lidhje me aktivin “HEC” duke harmonizuar legjislacionin fiskal me standardet kontabël në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

12.2. Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë planet e punës vjetore dhe mujore, për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për biznesin e madh dhe të vogël, me detyra dhe afate të mirë përcaktuara sipas funksioneve përkatëse, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Deri më datë 31.03.2024

1.2. Periudha e audituar në auditimin e mëparshëm (01.01.2021-31.12.2021)

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse nr. 1247/58 prot., datë 30.09.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2021-31.12.2021, protokolluar në subjekt me nr. 28311, datë 04.10.2022, ku janë rekomanduar për zbatim 17 rekomandime “Masa organizative”, 4 rekomandime “Shpërblim dëmi ekonomik, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe 1 rekomandim “Masë disiplinore” për 16 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023, ka rezultuar se, nga 22 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 20 rekomandime, ose 91 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, ose 65 % e tyre; është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 5 % e tyre dhe janë në proces zbatimi 6 rekomandime, ose 30 % e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

1.2. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përshejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 28-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

9.2. Rekomandimi: DRT Tiranë të hartojë dhe miratojë çdo fillim viti dhe muaji, planet e punës për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh dhe të Vogël, me detyra të mirë specifikuar sipas funksioneve përkatëse dhe me afate të mirë përcaktuara, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pa ezauruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

Deri më datë 31.03.2024

2. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE ELBASAN

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse nr. 813/11 prot., datë 01.03.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2021-31.12.2021, protokolluar në subjekt me nr. 8366/43, datë 18.01.2023, ku janë rekomanduar për zbatim 10 rekomandime “Masa organizative”, 3 rekomandime “Shpërblim dëmi ekonomik, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, 1 rekomandim “Masë administrative”, si dhe 2 rekomandime “Masë disiplinore” për 16 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/15, datë 09.10.2023 ka rezultuar se, nga 16 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 15 rekomandime, ose 94 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 12 rekomandime, ose 80 % e tyre; janë në proces zbatimi 2 rekomandime, ose 13 % e tyre, rezulton pa zbatuar 1 rekomandim, ose 7 % e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 41-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan t'i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të hartojë një akt administrativ për analizimin e llogarisë së ortakut, në rastet kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Deri më datë 31.03.2024

3. DEGA E DOGANËS DURRES

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 16/29 prot., datë 05.10.2022, "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Degën Doganore Durrës, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2021-31.12.2021", protokolluar në subjekt me nr. 615/50, datë 07.10.2022, ku janë rekomanduar për zbatim 1 rekomandim "Përmirësim ligjor", 11 rekomandime "Masa organizative"; 8 rekomandime "Masa për shpërbllim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit" dhe 1 rekomandim "Masa disiplinore" për 51 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/11, datë 09.10.2023 ka rezultuar se, nga 21 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 15 rekomandime, ose 71 % e tyre, nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 6 rekomandime, ose 40 % e tyre; janë në proces zbatimi 8 rekomandime, ose 53 % e tyre, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim ose 7% e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

3.1. Rekomandim: Kryetari i Degës Doganore Durrës, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 54-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave doganore për arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të duhur, duke vlerësuar metodologjinë aktuale të planit të të ardhurave doganore duke bërë pjesë të këtij procesi edhe degën doganore, si dhe të shmanget praktika e kryerjeve të ndryshimeve të shpeshta në plan duke ndjekur nivelin e realizimit. Në vijim, Dega Doganore Durrës, të ndjekë limitet e përcaktuara në planin mujor duke kryer analiza të mirëfillta sipas llojit të të ardhurave doganore të gjeneruara, për të përcaktuar saktë

faktorët që rezultojnë në mbi realizim apo mos realizim apo kryerjen e analizave krahasimore me vitin paraardhës, duke mos u mjaftuar vetëm në evidenca sintetike statistikore.

Deri më datë 31.03.2024

4. DEGA E DOGANËS TIRANË

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 400/14 prot., datë 07.10.2022, “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Degën Doganore Tiranë, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2021-31.12.2021”, protokolluar në subjekt me nr. 9586 prot., datë 10.10.2022, ku janë rekomanduar për zbatim, 11 rekomandime “Masa organizative”; 6 rekomandime “Masa për shpërbllim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, 1 rekomandim “Masa disiplinore” për 55 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/14, datë 09.10.2023, ka rezultuar se, nga 18 rekomandime të lëna për zbatim, janë pranuar 17 rekomandime, ose 94% e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, ose 29% e tyre; janë në proces zbatimi 7 rekomandime, ose 41% e tyre; dhe janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime ose 24% e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

4.1. Rekomandim: Kryetari i Degës Doganore Tiranë, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 66-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të mundësojë përditësimin e të dhënave të transportit me kontejner të mallrave sipas të dhënave në bursë apo çmimeve të deklaruar të transportit me kontejnerë të cilat janë të publikuara në çdo kohë në faqet zyrtare të kompanive ndërkombëtare të transportit.

Deri më datë 31.03.2024

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën e Doganës Tiranë dhe degët e tjera doganore të hartojë udhëzim për zbatimin praktik për klasifikimin e shkeljeve dhe sanksioneve doganore si dhe të unifikojnë qëndrimin në zbatimin e tyre pa cenuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Deri më datë 31.03.2024

7.2. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të përgatisë dosje të rekomandimeve të shqyrtuara rast pas rasti me dokumentacionin argumentues, persona përgjegjës dhe vendimin e marrë si

dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të rishikojë profilin e riskut për të gjithë artikujt e kreut 0206 për ekzaminim fizik e laboratorik, si në rastin e vajrave lubrifikantë.

Deri më datë 31.03.2024

Masa shpërblim dëmi ekonomik, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit:

3.1. Rekomandimi: Dega e Doganës Tiranë të marrë masat për operatorët ekonomikë artikujt e të cilëve trajtohen me ligjin e akcizës, të kalibrojnë enët mbajtëse të tyre, (depozitat, siloset), pajisin ato me Certifikatat e Kalibrimin si dhe nxjerrë vendimet e arkëtojnë, gjobat për operatorët përkatësisht nga Tabela nr. 1 në Tabelën nr. 3 të detajuara në pjesën V. Aneksë, për Pikën 2.4 të pjesës III “Përshkrimi i auditimit” në Raport në shumën totale 4,891,020 lekë.

Deri më datë 31.03.2024

5. SHOQËRIA “AGROKREDIT” SHA

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse nr. 1259/11 prot., datë 23.06.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Shoqërinë “Agrokredit” SHA, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2019-31.10.2021, protokolluar në subjekt me nr. 5171/17 prot., datë 07.06.2022, ku janë rekomanduar për zbatim 28 rekomandime “Masa organizative”; 3 rekomandime “Masa për shpërblim dëmi”, 3 rekomandime “Masa përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike”, si dhe masa disiplinore lënë në kompetencë të titullarit për 6 punonjës.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/13, datë 09.10.2023 ka rezultuar se, janë pranuar 34 rekomandime nga 35 të lëna për zbatim, ose 97 % e tyre, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 25 rekomandime ose 74 % e tyre, janë në proces zbatimi 6 rekomandime ose 17 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime ose 9 % e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

5.1. Rekomandim: Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Agrokredit” SHA, të marrin masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

1.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës (KM) të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesën e hartimit të planit të veprimit dhe të raportimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, si dhe të marra të gjitha masat nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të papranuara, të pazbatuara apo të zbatuara pjesërisht..

Deri më datë 31.03.2024

2.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të analizuar rregullisht në vijimësi treguesit e shoqërisë mbi baza tremujore dhe vjetore, referuar dhe treguesve financiare të shoqërisë, të miratojnë në afat programet ekonomike, të analizojë

largimet nga puna, me vlerë të shpenzimeve gjyqësore në shumën totale 7,382,788 lekë, duke nxjerrë përgjegjësit konkrete dhe shmangien në të ardhmen të efekteve financiare negative për buxhetin e shoqërisë, të marrë në analizë raportet e KLSH dhe të dalë me vendimmarrjen përkatëse, të shmangë marrjen e vendime qarkulluese për çështje të rëndësishme, të marrë masa të bëjë analizë të thelluar mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të huave mbi të cilin gjenerohet portofoli i huave për klientët, duke dalë në masa konkrete për përmirësimin e sistemit dhe eliminimin e risqeve në të ardhmen.

Deri më datë 31.03.2024

Masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve:

Rekomandimi 3.1. Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë situatën e krijuar si rezultat i largimeve të paligjshme nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, dhe në bashkëpunim me Administratorin e Shoqërisë, Drejtorinë e Burimeve njerëzore, të marrin masa për shmangien e pasojave financiare ndaj buxhetit të Shoqërisë.

Deri më datë 31.03.2024

6. AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse nr. 290/15 prot., datë 09.09.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2017-31.12.2021, protokolluar në subjekt me nr. 442/21 prot., datë 13.09.2022, janë lënë për zbatim 22 rekomandime, nga të cilat 1 rekomandim “Për përmirësim ligjor”, 18 rekomandime “Masa organizative”, 2 rekomandime “Shpërblim dëmi, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit”, si dhe “Masa disiplinore” për punonjës të AMLF.

Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/13, datë 09.10.2023 ka rezultuar se, nga 22 rekomandime të lëna për zbatim, është pranuar 100 % e tyre. Nga 22 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime, ose 59.1 % e tyre; janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime, ose 13.62 % e tyre; është në proces zbatimi 1 rekomandim, ose 4.55 % e tyre, rezultojnë pa zbatuar 5 rekomandime, ose 22.73 % e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, të marrë masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 100-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: AMLF të marrë masa për përditësimin e Rregullores së brendshme, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve ligjore si dhe të strukturës organike me emërtimet përkatëse, të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 61, datë 07.05.2020.

Deri më datë 31.03.2024

3.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF që të bëhen përmirësimet ligjore në Rregulloren e brendshme me qëllim që praktikën e kontrollit të unifikohen duke bashkëlidhur gjurmën (kopje të sistemit të dhënave/print screen) për të siguruar lidhjen/përputhjen e të dhënave të nxjerra nga kontrolli me ato të sistemit qendror të dhënave.

Deri më datë 31.03.2024

4.1. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF në bashkëpunim me DAP për plotësimin e Komisionit të Ristrukturimit me përfaqësuesin e saj, si dhe të intensifikohet bashkëpunimi me MFE, me qëllim që të vihet në lëvizje dhe përfundojë procesi i restrukturimit të këtij institucioni.

Deri më datë 31.03.2024

6.2. Rekomandimi: Të merren masa nga AMLF, që të bëhen përmirësimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të saj, duke saktësuar dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet në rastet e hapje/mbyllje të pikave të shitjes së biletave të Lotarisë Kombëtare, me qëllim saktësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Deri më datë 31.03.2024

12.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AMLF në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes tyre, për efektshmërinë e procesit të rakordimit tatimor, duke parashikuar formën dhe llojin e informacionit që do të shkëmbehet mes palëve, afatin dhe masat në rastet e mos raportimit.

Deri më datë 31.03.2024

13.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit të përfshijnë dhe çështjen kur subjektet vijnë të deklarojnë e ushtrojnë aktivitet pa pasur një licencë aktive, me qëllim disiplinimin ligjor dhe financiar e tatimor të veprimtarisë së lojërave të fatit, si dhe shmangien e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Deri më datë 31.03.2024

14.1. Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/AMLF që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshëm të Tatimeve të saktësohen elementët që do të rakordohen midis palëve, me qëllim respektimin e kuadrit ligjor për raportimin e detyrimeve dhe të statusit të subjekteve.

Deri më datë 31.03.2024

15.1. Rekomandimi: Titullari i AMLF të marrë masa në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, për ngritjen e GMS, me qëllim mirëfunksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Deri më datë 31.03.2024

7. INSTITUTI I STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT
Nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën përcjellëse me shkresën nr. 811/14 prot., datë 13.01.2023, “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në ISKK”, mbi veprimtarinë e subjektit nga 01.01.2018 deri më 30.06.2022, protokolluar në subjekt me nr. 135/15 prot., datë 18.01.2023, janë rekomanduar për zbatim, 8 rekomandime “Masa organizative” dhe 1 rekomandim “Masë disiplinore”. Nga auditimi i tyre, bazuar në Programin e auditimit nr. 886/10, datë 09.10.2023 ka rezultuar se, nga 9 rekomandime të lëna për zbatim, është pranuar 100% e tyre. Nga 9 rekomandimet e pranura, 4 rekomandime janë zbatuar ose

ndryshe 45% e tyre, 1 është në proces zbatimi ose 11% e tyre, 2 janë në zbatuar pjesërisht ose 22% e tyre, dhe 2 nuk janë zbatuar ose 22% e tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë:

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i dhe Bordi Drejtues i ISKK-së të marrin masa për:

- a. zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme, të cilat rezultojnë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht;
- b. përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi;
- c. njoftimin me shkrim, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e zbatimit të tyre, brenda datës 31.03.2024.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 117-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Masa organizative:

2.1. Rekomandimi: Bordi Drejtues të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti të veçantë, duke përcaktuar procedurën e emërimit të Drejtorit Ekzekutiv, përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë aplikantët, procedurën e votimit dhe deri në shpalljen e fituesit, për të garantuar një proces transparent, të barabartë dhe efektiv.

Deri më datë 31.03.2024

4.1. Rekomandimi: Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor që detajon procedurën e organizimit të konferencave, ku të përfshihet procedura e ndjekur për përcaktimin e temave, shpallja, mënyra e aplikimit, metodologjia e vlerësimit, pagesa e pjesëmarrësve, si dhe çdo hallkë tjetër që do ta bënte më transparent procesin, si dhe krijimin dhe administrimin e një databaze të plotë në lidhje me konferencat, ku për secilën thirrje të mëtejshme të evidentohen aplikimet me të dhënat përkatëse të nevojshme.

Deri më datë 31.03.2024

Masa disiplinore:

Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, mbështetur në nenet 57, 58, 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikën 11, kreu II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” pas vlerësimit të përgjegjësive të nëpunësve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”.

Deri më datë 31.03.2024

V. ANEKSE

2. Tabela anekse “Të dhëna përmbledhëse mbi zbatimin e rekomandimeve”

Tabela nr. 1 “Përmbledhëse raportimet në KLSH”

Subjektet	Protokollimi i RPA subjekte Nr. prot./datë	Plan veprimi (Afati 20 ditë)	Mbi nivelin e zbatimit Afati 6 muaj (Raportuar)
DRT Tiranë (2018-2020)	6802, datë 22.02.2023	-	-
DRT Tiranë (2021)	28311, datë 04.10.2022	29896, datë 18.10.2022	-
DRT Elbasan	8366/43, datë 18.01.2023	-	-
DD Durrës	615/50, datë 07.10.2022	615/55, datë 14.10.2023	615/68, datë 29.12.2022
DD Tiranë	9586, datë 10.10.2022	9586/5, datë 25.10.2023	9586/9, datë 07.04.2023
Shoqëria “Agrokredit” SHA	5171/17, datë 07.06.2022	5171/20, datë 28.07.2022	-
AMLF	442/21, datë 13.09.2022	-	-
IIPP	46, datë 18.01.2023	164, datë 09.02.2023	485, datë 29.06.2023
ISKK	135/15, datë 18.01.2023	135/17, datë 03.02.2023	-
Totali		6-Raportime, ose 67 %	3-Raportime, ose 33 %

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 2 “Përmbledhëse e rekomandimeve, përmirësim ligjor”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë (2018-2020)	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Tiranë (2021)	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Elbasan	-	-	-	-	-	-	-	-
DD Durrës	1	-	1	100	1	-	-	-
DD Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-
Agrokredit SHA	-	-	-	-	-	-	-	-
AMLF	1	-	1	100	1	-	-	-
IIPP	-	-	-	-	-	-	-	-
ISKK	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	2	-	2	100	2	-	-	-

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 3 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa organizative”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë (2018-2020)	17	1	16	94	11	2	3	-
DRT Tiranë (2021)	17	1	16	94	12	1	3	-
DRT Elbasan	10	1	9	90	8	-	-	1
DD Durrës	11	1	10	91	4	1	5	-
DD Tiranë	11	-	11	100	3	4	4	-
Agrokredit SHA	28	1	27	96	22	2	3	-
AMLF	18	-	18	100	10	3	-	5
IIPP	11	-	11	100	10	-	1	-
ISKK	8	-	8	100	4	1	2	1
Totali	131	5	126	96	84	14	21	7

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 4 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa shpërblim dëmi”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë (2018-2020)	28	3	25	89	14	-	11	-
DRT Tiranë (2021)	4	1	3	75	-	-	3	-
DRT Elbasan	3	-	3	100	2	-	1	-
DD Durrës	8	5	3	38	1	-	2	-
DD Tiranë	6	1	5	83	2	-	2	1
Agrokredit SHA	3	-	3	100	-	-	3	-
AMLF	2	-	2	100	1	-	1	-
IIPP	-	-	-	-	-	-	-	-
ISKK	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	54	10	44	82	20	0	23	1

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 5 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa shpërblim dëmi në mijë lekë”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Vlere	Pa pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë 2018-2020	28	59,569,725	16,517	99	207,288	-	59,345,920	-
DRT Tiranë -2021	4	69,885,540	654	99	-	-	69,884,886	-
DRT Elbasan	3	162,775	-	100	111,052	-	51,723	-
DD Durrës	8	327,987	56,335	83	762	-	270,890	-
DD Tiranë	6	374,546	6,852	98	1,433	-	361,370	4,891
Agrokredit SHA	3	367	-	100	-	-	367	-
AMLF	2	1,000	-	100	500	-	500	-
Totali	54	130,321,940	80,358	99	321,035	0	129,915,656	4,891

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 6 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa për përdorim me 3-E të fondeve”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë 2018-2020	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Tiranë 2021	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Elbasan	-	-	-	-	-	-	-	-
DD Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-
DD Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-
Agrokredit SHA	3	-	3	100	2	1	-	-
AMLF	-	-	-	-	-	-	-	-
IIPP	1	-	1	100	1	-	-	-
ISKK	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	4	-	4	100	3	1	-	-

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 7 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa administrative”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë 2018-2020	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Tiranë 2021	-	-	-	-	-	-	-	-
DRT Elbasan	1	-	1	100	1	-	-	-
DD Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-
DD Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-
Agrokredit SHA	-	-	-	-	-	-	-	-

AMLF	-	-	-	-	-	-	-	-
IIPP	-	-	-	-	-	-	-	-
ISKK	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	1	0	1	100	1	0	0	0

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 8 “Përmbledhëse e rekomandimeve, masa disiplinore”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
DRT Tiranë (2018-2020)	1 rek. Kompetencë titullarit (8 punonjës)	-	1	100	1	-	-	-
DRT Tiranë (2021)	1 rek. Organi epror (16 punonjës)	-	1	100	1	-	-	-
DRT Elbasan	2 rek. (për 16 punonjës)	-	2	100	1	-	1	-
DD Durrës	1 rek. (për 51 punonjës)	-	1	100	-	-	1	-
DD Tiranë	1 rek. (për 55 punonjës)	-	1	100	-	-	1	-
Agrokredit SHA	1 rek. (për 6 punonjës)	-	1	100	1	-	-	-
AMLF	1 rek. kompetence titullari	-	1	100	1	-	-	-
IIPP	1 rek. (për 6 punonjës)	-	1	100	1	-	-	-
ISKK	1 rek. kompetence titullari	-	1	100	-	-	-	1
Totali	10	-	10		6	-	3	1

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Tabela nr. 9 “Përmbledhëse mbi shkallën e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar”

Subjektet	Rekomandime gjithsej	Pranuar	Pa Pranuar	Shkalla e pranimit në %
DRT Tiranë (2018-2020)	46	42	-4	91
DRT Tiranë -2021	22	20	-2	91
DRT Elbasan	16	15	-1	94
DD Durrës	21	15	-6	71
DD Tiranë	18	17	-1	94
Agrokredit SHA	35	34	-1	97
AMLF	22	22	0	100
IIPP	13	13	0	100
ISKK	9	9	0	100
Totali	202	187	-15	93

Burimi i të dhënave nga subjektet, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

2. Tabela anekse “Zbatimi rekomandimeve Dega Doganore Tiranë dhe Durrës”

Tabela nr. 10: Përlllogaritja dhe pagesa e kamatave për subjektet debitorë në procese gjyqësore (Në lekë)

NIPT	Detyrime	Penalitete	Interesa	Shuma totale	Shuma para llogaritjes së kamatave	Kamata shtesë	Shuma pas llogaritjes së kamatave	Vendim	
								Nr	Datë
1	201,410	400,000	0	601,410	601,410	389,780	991,190	6314	05/07/2014
2	200,000	500,000	0	700,000	700,000	397,249	1,097,249	10522/1	29/11/2014
3	7,400	1,000,000	0	1,007,400	1,007,400	464,232	1,471,632	735	05/01/2015
4	168,114	504,342	0	672,456	672,456	82,107	754,563	960	28/12/2016
5	3,592,174	3,592,174	0	7,184,348	7,184,348	901,456	8,085,804	96	28/03/2017
6	97,748,426	293,245,278	0	390,993,704	390,993,704	33,659,202	424,652,906	300	02/06/2017
7	116,856	350,568	0	467,424	467,424	33,112	500,536	606	30/09/2017
8	29,700	89,100	0	118,800	118,800	8,416	127,216	607	30/09/2017
9	216,168	648,504	0	864,672	864,672	61,253	925,925	608	30/09/2017
10	109,920	329,760	0	439,680	439,680	31,147	470,827	609	30/09/2017
11	316,800	950,400	0	1,267,200	1,267,200	89,768	1,356,968	610	30/09/2017
12	100,476	301,428	0	401,904	401,904	28,471	430,375	611	30/09/2017
13	329,676	989,028	0	1,318,704	1,318,704	93,417	1,412,121	612	30/09/2017
14	309,096	927,288	0	1,236,384	1,236,384	87,585	1,323,969	613	30/09/2017
15	3,751,000		0	3,751,000	3,751,000	408,809	4,159,809	154	27/03/2018
16	421,441	1,264,323	0	1,685,764	1,685,764	67,652	1,753,416	610	29/06/2018
17	478,293	956,586	0	1,434,879	1,434,879	67,448	1,502,327	636	28/06/2018
18	317,510	952,230	0	1,269,740	1,269,740	50,962	1,320,702	637	28/06/2018
19	297,190	891,570	0	1,188,760	1,188,760	47,706	1,236,466	638	28/06/2018
20	408,644	408,644	0	817,288	817,288	43,182	860,470	847	01/08/2018
Totali	109,120,294	308,301,223	0	417,421,517	417,421,517	37,012,954	454,434,471		

Burimi: Dega Doganore Tiranë.

Tabela nr. 11 “Pasqyrimi i rillogaritje pagesash detyrime doganore në import, 2021”

Në lekë

Aneksi sipas RPA	Sipas përlllogaritjeve të KLSH (A)			Sipas DD Durrës (B)			Diferenca B-A
	Detyrimi	Penaliteti	Total	Detyrimi	Penaliteti	Total	
3.1	2 193 483	-	2 193 483				(2 193 483)
3.2	165 520	-	165 520	165 520	-	165 520	-
3.3	10 639 320	-	10 639 320		-	-	(10 639 320)
3.4	1 170 024	-	1 170 024	19 908	-	19 908	(1 150 116)
3.5	13 309	-	13 309		-	-	(13 309)
3.6	448 302	-	448 302	230 546	-	230 546	(217 756)
3.7	31 437	-	31 437	31 437	-	31 437	-
3.8	1 115 466	-	1 115 466				(1 115 466)
3.9	-	-	-	-	-	-	-
3.10	2 242 728	-	2 242 728	862 097	-	862 097	(1 380 631)
3.11	137 572	-	137 572	137 572	-	137 572	-
3.12	2 118 133	-	2 118 133	266 647	-	266 647	(1 851 486)
3.13	540 410	-	540 410	431 807	-	431 807	(108 603)
3.14	1 233 696	-	1 233 696	1 233 696	-	1 233 696	-
3.15	218 103	-	218 103	218 103	-	218 103	-
3.16	1 011 952	-	1 011 952	1 011 952	-	1 011 952	-
3.17	427 812	-	427 812	208 116	-	208 116	(219 696)
3.18	1 500 391	-	1 500 391	36 236	-	36 236	(1 464 155)
3.19	41 667	-	41 667	-	-	-	(41 667)
3.20	2 259 058	-	2 259 058	249 146	-	249 146	(2 009 912)
3.21	1 743 211	1 743 211	3 486 422	-	-	-	(3 486 422)
3.22	181 025	-	181 025	63 249	-	63 249	(117 776)
3.23	5 714 029	-	5 714 029	523 908	-	523 908	(5 190 121)
3.24	-	-	-	-	-	-	-
3.25	62 372	-	62 372	46 469	-	46 469	(15 903)
3.26	-	-	-	-	-	-	-
3.27	756 100	-	756 100	475 838	-	475 838	(280 262)
3.28	920 012	-	920 012	920 012	-	920 012	-
3.29	1 961 977	-	1 961 977	309 006	-	309 006	(1 652 971)
3.30	863 518	-	863 518	186 397	-	186 397	(677 121)
3.31	4 590 199	-	4 590 199	1 056 344	-	1 056 344	(3 533 855)
3.32	310 460	-	310 460	-	-	-	(310 460)
3.33	4 487 084	-	4 487 084	1 326 207	-	1 326 207	(3 160 877)
3.34	4 769 334	-	4 769 334	468 351	-	468 351	(4 300 983)
3.35	2 581 314	-	2 581 314	404 331	-	404 331	(2 176 983)
3.36	226 057	-	226 057	48 550	-	48 550	(177 507)
3.37	6 570 871	-	6 570 871	-	-	-	(6 570 871)
3.38	495 212	-	495 212	39 127	-	39 127	(456 085)
3.39	2 634 567	-	2 634 567	-	-	-	(2 634 567)
3.40	578 779	-	578 779	208 192	-	208 192	(370 587)

3.41	414 116	-	414 116	414 116	-	414 116	-
3.42	1 234 856	-	1 234 856	-	-	-	(1 234 856)
3.43	7 156 836	-	7 156 836	356 473	-	356 473	(6 800 363)
3.47	1 448 155	-	1 448 155	1 373 118	-	1 373 118	(75 037)
3.48	479 463	479 463	958 926	127 361	127 361	254 722	(704 204)
3.49	253 559	253 559	507 118	116 772	116 772	233 544	(273 574)
3.50	18 750	18 750	37 500	18 750	18 750	37 500	-
3.51	26 400	26 400	52 800	26 400	26 400	52 800	-
3.52	238 152	-	238 152	238 152	-	238 152	-
3.53	-	-	-	-	-	-	-
3.54	6 170 291	-	6 170 291	-	-	-	(6 170 291)
3.55	55 559	55 559	111 118	55 559	55 559	111 118	-
3.56	138 072	138 072	276 144				(276 144)
3.57	279 166	-	279 166				(279 166)
3.58	728 233	728 233	1 456 466				(1 456 466)
3.59	252 204	252 204	504 408				(504 408)
3.60	585 086	585 086	1 170 172	98 851	98 851	197 702	(972 470)
3.61		280 000	280 000				(280 000)
3.62	608 842	608 842	1 217 684				(1 217 684)
3.63	419 756	419 756	839 512	100 448	100 448	200 896	(638 616)
3.64	2 665 487	2 665 487	5 330 974	102 309	102 309	204 618	(5 126 356)
3.65	551 610	871 610	1 423 220	45 396	45 396	90 792	(1 332 428)
3.66	7 297 853	7 297 853	14 595 706				(14 595 706)
3.67	2 300 227	2 300 227	4 600 454				(4 600 454)
3.68	182 549	182 549	365 098	162 334	162 334	324 668	(40 430)
3.69	335 173	335 173	670 346	335 173	335 173	670 346	-
3.70	151 939	151 939	303 878	151 939	151 939	303 878	-
3.71	39 007	39 007	78 014	27 389	27 389	54 778	(23 236)
3.72	30 576	425 076	455 652	209 379	219 019	428 398	(27 254)
3.73	-	-	-	-	-	-	-
3.74	197 396	257 396	454 792	197 396	257 396	454 792	-
3.75	9 266 734	9 266 734	18 533 468	1 910 978	1 910 978	3 821 956	(14 711 512)
3.76	1 007 777	1 007 777	2 015 554	352 874	352 874	705 748	(1 309 806)
3.77	266 796	266 796	533 592	266 796	266 796	533 592	-
3.78	-	400 000	400 000				(400 000)
3.79	-	-	-	-	-	-	-
3.80	-	-	-	-	-	-	-
3.81	-	-	-	-	-	-	-
3.82	-	-	-	-	-	-	-
3.83	5 876 975	-	5 876 975				(5 876 975)
3.84	2 847 824	-	2 847 824				(2 847 824)
3.85		-	-	-	-	-	-
3.86		-	-	-	-	-	-
3.87	1 290 417	-	1 290 417	591 540	-	591 540	(698 877)
3.88	866 517	-	866 517	498 889	-	498 889	(367 628)
3.89	223 238	-	223 238				(223 238)
3.90	339 601	-	339 601	149 927	-	149 927	(189 674)
3.91	33 186	-	33 186	33 186	-	33 186	-
3.92	5 931 544	-	5 931 544	485 679	-	485 679	(5 445 865)
Total			160 221 185			24 001 692	(136 219 493)

Burimi: Të dhënat nga Dega Doganore Durrës. Përpunuar nga KLSH.

Tabela nr. 12 “Detyrime doganore të përlogaritura nga KLSH dhe nga DD Tiranë”

Në lekë

Sipas RPA	Detyrim doganor shtesë sipas KLSH	Detyrim shtesë i përlogaritur nga DD Tiranë	Diferenca DD Tiranë - KLSH
Tabela 1	107 000	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(107 000)
Tabela 2	2 362 500	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(2 362 500)
Tabela 3	1 225 000	315 000	(910 000)
Tabela 4	472 000	472 000	-
Tabela 5	5 189 500	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(5 189 500)
Tabela 6	997 500	785 359	(212 141)
Tabela 7	1 870 000	157 980	(1 712 020)
Tabela 8	3 995 106	290 473	(3 704 633)
Tabela 9	1 100 231	948 212	(152 019)
Tabela 10	63 854	40 604	(23 250)
Tabela 11	63 959	47 441	(16 518)
Tabela 12	4 163 154	1 190 985	(2 972 169)
Tabela 13	15 137 976	19 776	(15 118 200)

Tabela 14	1 791 773	21 191	(1 770 582)
Tabela 15	1 508 646	49 604	(1 459 042)
Tabela 16	3 675 896	895 827	(2 780 069)
Tabela 17	4 790 023	548 626	(4 241 397)
Tabela 18	4 421 486	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(4 421 486)
Tabela 19	7 260 337	77 253	(7 183 084)
Tabela 20	3 485 139	Pas verifikimit nuk ka rezultuar detyrim doganor shtesë	(3 485 139)
Tabela 21	171 447	103 934	(67 513)
Tabela 22	4 279 532	445 929	(3 833 603)
Tabela 23	542 351	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(542 351)
Tabela 24	100 990	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(100 990)
Tabela 25	1 515 587	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 515 587)
Tabela 26	102 927	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(102 927)
Tabela 27	12 579 594	837 503	(11 742 091)
Tabela 28	1 990 933	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 990 933)
Tabela 29	925 101	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(925 101)
Tabela 30	2 465 199	563 374	(1 901 825)
Tabela 31	8 580 145	512 052	(8 068 093)
Tabela 32	15 528 571	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(15 528 571)
Tabela 33	2 471 697	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(2 471 697)
Tabela 34	7 497 436	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(7 497 436)
Tabela 35	1 655 810	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 655 810)
Tabela 36	5 504 718	I pamundur shqyrtimi nga ana e DD Tiranë	(5 504 718)
Tabela 37	8 231 899	Vendimmarrje në 24 raste, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rillogaritur	(8 231 899)
Tabela 38	1 763 682	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(1 763 682)
Tabela 39	10 058 155	Vendimmarrje në 7 raste, por pa specifikuar vlerën e detyrimit të rillogaritur	(10 058 155)
Tabela 40	1 776 513	I pamundur shqyrtimi nga ana e DD Tiranë	(1 776 513)
Tabela 41	30 777 780	Dërguar deklaratat për verifikim pranë DOH	(30 777 780)
Tabela 42	4 464 568* ²	242 246*	(4 222 322)
Tabela 43	17 856 716*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(17 856 716)
Tabela 44	12 449 234*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(12 449 234)
Tabela 45	17 699 792*	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(17 699 792)
Tabela 46	8 899 092*	3 647 838*	(5 251 254)
Tabela 47	1 666 488	302 474	(1 364 014)
Tabela 48	126 670 000	Nuk rezulton diferencë detyrimi pas verifikimit	(126 670 000)
Totali	371 750 037	12 515 681	(359 234 356)

Burimi: Dega Doganore Tiranë.

Tabela nr. 13: Përlllogaritja dhe pagesa e kamatave për subjektet debitorë në procese gjyqësore/ në leke

NIPT	Detyrime	Penalitet	Interesa	Shuma totale	Shuma para llogaritjes së kamatave	Kamata shtesë	Shuma pas llogaritjes së kamatave	Vendim	
								Nr	Datë
1	201,410	400,000	0	601,410	601,410	389,780	991,190	6314	05/07/2014
2	200,000	500,000	0	700,000	700,000	397,249	1,097,249	10522/1	29/11/2014
3	7,400	1,000,000	0	1,007,400	1,007,400	464,232	1,471,632	735	05/01/2015
4	168,114	504,342	0	672,456	672,456	82,107	754,563	960	28/12/2016
5	3,592,174	3,592,174	0	7,184,348	7,184,348	901,456	8,085,804	96	28/03/2017
6	97,748,426	293,245,278	0	390,993,704	390,993,704	33,659,202	424,652,906	300	02/06/2017
7	116,856	350,568	0	467,424	467,424	33,112	500,536	606	30/09/2017
8	29,700	89,100	0	118,800	118,800	8,416	127,216	607	30/09/2017
9	216,168	648,504	0	864,672	864,672	61,253	925,925	608	30/09/2017
10	109,920	329,760	0	439,680	439,680	31,147	470,827	609	30/09/2017
11	316,800	950,400	0	1,267,200	1,267,200	89,768	1,356,968	610	30/09/2017
12	100,476	301,428	0	401,904	401,904	28,471	430,375	611	30/09/2017
13	329,676	989,028	0	1,318,704	1,318,704	93,417	1,412,121	612	30/09/2017
14	309,096	927,288	0	1,236,384	1,236,384	87,585	1,323,969	613	30/09/2017

² Shënim: * - Përlllogaritje ku është përfshirë detyrimi doganor shtesë së bashku me penalitetin sa njëfishi i këtij detyrimi.

NIPT	Detyrime	Penalitete	Interesa	Shuma totale	Shuma para llogaritjes së kamatave	Kamata shtesë	Shuma pas llogaritjes së kamatave	Vendim	
								Nr	Datë
15	3,751,000		0	3,751,000	3,751,000	408,809	4,159,809	154	27/03/2018
16	421,441	1,264,323	0	1,685,764	1,685,764	67,652	1,753,416	610	29/06/2018
17	478,293	956,586	0	1,434,879	1,434,879	67,448	1,502,327	636	28/06/2018
18	317,510	952,230	0	1,269,740	1,269,740	50,962	1,320,702	637	28/06/2018
19	297,190	891,570	0	1,188,760	1,188,760	47,706	1,236,466	638	28/06/2018
20	408,644	408,644	0	817,288	817,288	43,182	860,470	847	01/08/2018
Totali	109,120,294	308,301,223	0	417,421,517	417,421,517	37,012,954	454,434,471		

Burimi: Dega Doganore Tiranë, përpunoi Grupi i auditimit

Për sa më sipër, është hartuar ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT